



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 65/2021 regjistër (JR)
Datë 08.11.2021

Nr. 11 i vendimit
Datë 06.02.2025

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Rezarta Schuetz	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Albana Shtylla	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 06.02.2025, ditën e enjte, në orën 10.00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar z. Francesco Ciardi, me sekretare gjyqësore Arjela Vllaçaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Bujar Musta, gjyqtar në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 447, datë 17.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Bujar Musta.

BAZA LIGJORE: Neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut; neni 179/b, pika 5, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni F, pika 2, i Aneksit të Kushtetutës; nenet 63, pika 1, 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”; ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe neni 46 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” [në vijim ligji nr. 84/2016], shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në ankim dhe parashtrimet shtesë të depozituara në Kolegj, sipas të cilave, ai kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit nr. 447, datë 17.09.2021 të Komisionit dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Bujar Musta [në vijim “subjekti i rivlerësimit”], në zbatim të nenit 179/b, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional, në përputhje me nenet 31 pika 1, 35 pika 1 dhe 41 pika 1 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit [në vijim “Komisioni”], bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave [në vijim, “ILDKPKI”]; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar [në vijim, “DSIK”]; dhe ish Këshilli i Lartë i Drejtësisë [në vijim, “KLD”], prej të cilave rezultoi si më poshtë.
 - 2.1. ILDKPKI-ja, në përfundim të procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm¹, sipas së cilit: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.
 - 2.2. DSIK-ja ka dërguar raportin e përditësuar² për *papërshtatshmërinë* e subjektit të rivlerësimit në vazhdimin e detyrës, në konfirmim të konstatimit fillestar sipas raportit të depozituar në fillim të procesit të rivlerësimit në datën 02.11.2017³.
 - 2.3. Ish-Inspektorati i KLD-së⁴ kreu vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, duke analizuar formularin e vetdeklarimit e të dhënat e dokumentet e tjera që shoqërojnë këtë

¹ Raporti nr. {***} prot., datë 27.02.2018.

² Nr. {***} prot., datë 11.02.2021, deklasifikuar pjesërisht me vendimin e KDZh-së, nr. {***} prot., datë 18.03.2021.

³ Raporti nr. {***} prot., datë 02.11.2017.

⁴ Në cilësinë e organit ndihmës të institucioneve të rivlerësimit.

formular: 3 (tre) dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, 5 (pesë) dokumente ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së. Në përfundim të procedurës së kontrollit, i dërgoi Komisionit një raport të hollësishëm për subjektin e rivlerësimit.⁵

3. Në përputhje me nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe me nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit, Komisioni zhvilloi procesin e rivlerësimit kalimtar bazuar në *tria kriteret*, atë të vlerësimit të pasurisë, kontrollin e figurës dhe kriterin e vlerësimit të aftësisë profesionale.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Pasi kreu vlerësimin e tria kriterëve, Komisioni ka vlerësuar që subjekti i rivlerësimit *nuk* arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, është i *papërshtatshëm* në vlerësimin e kontrollit të figurës dhe *ka cenuar besimin e publikut* te sistemi i drejtësisë në kontroll të kriterit të vlerësimit profesional, duke u gjendur për rrjedhojë, në kushtet e parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës e pikat 3 dhe 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Bazuar në këtë kualifikim ligjor, Komisioni me vendimin nr. 447, datë 17.09.2021, objekt shqyrtimi, ka vendosur *shkarkimin nga detyra* të subjektit të rivlerësimit. Kjo vendimmarrje, është bazuar në konkluzionet përfundimtare se:
 - a. Subjekti *nuk* arrin nivel të besueshëm në lidhje me kriterin e *vlerësimit të pasurisë*, pasi ka pasur *mungesë të theksuar* të burimeve financiare të ligjshme, për kryerjen e të gjitha investimeve dhe njëkohësisht, për përballimin e shpenzimeve apo për të realizuar kursimet e deklaruara. Subjekti ka kryer *deklarime të pamjaftueshme* dhe ka *tentuar të fshehtë* pasurinë apartament banimi në Elbasan përgjatë viteve 2004 – 2010, *duke cenuar besimin e publikut* në sistemin e drejtësisë;
 - b. *Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës*, rezultuan përputhje midis informacioneve të klasifikuara dhe qasjeve procedurale të ndërthura me zgjidhjet substanciale të kryera nga subjekti lidhur me disa çështje gjyqësore, të cilat konsiderohen si veprime që *kanë cenuar besimin e publikut*, duke e bërë subjektin të *papërshtatshëm* për vijimin e detyrës.
 - c. Në lidhje me kriterin e *vlerësimit të aftësive profesionale*, shkeljet e konstatuara në konkurrin me ato të evidentuara në dy kriteret e tjera, kanë rikrijuar bindjen se subjekti *ka cenuar besimin e publikut* në sistemin e drejtësisë, me pasojë aplikimin e pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Problematikat e konstatuara u çmuan të panevojshme t'i nënshtroheshin vlerësimit të mëtejshëm edhe në drejtim të nivelit kualifikues të aftësive profesionale në kuptim të nenit 59, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë ky aspekt vlerësimi rezultoi pa influencë mbi vendimmarrjen përfundimtare për vijueshmërinë ose jo të ushtrimit të detyrës.

⁵ Raporti nr. {***} prot., datë 16.05.2018

III. Ankimi i subjektit të rivlerësimit dhe shkaqet e ngritjes së tij

5. Në datën 25.10.2021, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision brenda afatit ligjor, ankim kundër vendimit objekt shqyrtimi, si edhe akte bashkëlidhur ⁶, duke kërkuar administrimin e tyre në cilësinë e provës së re shkresore.

5.1. Në zbatim të së drejtës që parashikon neni 49 i ligjit nr. 49/2012, për parashtrime me shkrim përpara seancës gjyqësore në dhomë këshillimi, subjekti ka paraqitur edhe në Kolegj, parashtrime e akte respektivisht në datat 28.12.2023 ⁷ dhe 20.01.2025 ⁸. Subjekti i konsideron aktet e depozituara si prova shkresore të lidhura me shkaqet e ankimit e që plotësojnë kushtet e nenit 47 të ligjit 49/2012 dhe nenit 65/1 të ligjit nr. 84/2016 për marrjen në rishqyrtim.

5.2. Duke e konsideruar vendimin e Komisionit të padrejtë, të pabazuar në ligj e në prova dhe në shkelje të normave dhe rregullave për një proces të rregullt ligjor, subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, çeljen e shqyrtimit gjyqësor dhe administrimin e provave të reja, në mbështetje të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, dhe shqyrtimin në themel të fakteve dhe provave të çështjes.

5.3. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, në mënyrë të përmbledhur, konsistojnë në shkaqe me natyrë procedurale dhe ato të themelit në kundërshtim të konkluzioneve të Komisionit për deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, vlerësimin të papërshtatshëm për kontrollin e figurës dhe për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë në vlerësimin tërësor të procedurave.

5.4. Në përfundim të ankimit, subjekti i rivlerësimit kërkon ndryshimin e vendimit nr. 447, datë 17.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e tij në detyrën e gjyqtarit.

III/1. Shkaqet e ankimit me natyrë procedurale.

6. Subjekti ka ngritur shkaqe ankimi lidhur me procesin e rregullt ligjor dhe me formën e përmbajtjen e vendimit të Komisionit, si më poshtë përmbledhur:

⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur ankimit 5 akte: (i) deklaratë noteriale datë 21.06.2021 e A. B., me vulë Apostille [2 fletë]; (ii) deklarata e përbashkët noteriale datë 13.09.2021 e A. Q. dhe B. Q., me vulë Apostille [3 fletë]; (iii) tekstin e-mail-it dërguar KPK-së, më datë 14.09.2021 dërgim shpjegimesh shtesë e provash shkresore [3 fletë]; (iv) kërkesat datë 14.09.2021, dërguar Komisionit, me 4 fletë; (v) procesverbalin e plotë të seancës dëgjimore datë 15.09.2021 (ky i fundit është cituar si provë pa e bashkëlidhur, por sidoqoftë administrohet në dosje).

⁷ Përmes postës elektronike të datës 28.12.2023, më datë 11.01.2023, subjekti i rivlerësimit ka dërguar parashtrime dhe 3 akte: (i) pasaportën e bashkëshortes së tij, lëshuar më datë 05.04.2002 për të provuar udhëtimin në Mbretërinë e Bashkuar; (ii) një ekstrakt të llogarisë bankare me titullare B. Q., me datë printimi 16.05.2022 nga "Raiffeisen Bank", për të provuar tërheqjen më datë 24.04.2007 të shumës 20.000 USD dhënë bashkëshortes së subjektit dhe transferimin nga kjo e fundit më datë 07.06.2007, të së njëjtës shumë; (iii) vendimin nr. {***} prot. datë 28.07.2022 të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës së paraqitur nga shtetasi R. R. në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të z. M. D. [origjinal].

⁸ Përmes postës elektronike të datës 20.01.2025 dhe dorazi në datën 21.01.2025, subjekti depozitoi parashtrime dhe 2 aktet vijuese: (i) shkresën nr. {***} prot., datë 22.05.2023, të ILD-së për arkivimin e ankesës së z. E. B.; dhe (ii) ankimin individual të subjektit të rivlerësimit në Gjykatën Kushtetuese, me objekt, shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. {***} datë 07.03.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, me të cilin është vendosur mospranimi i rekursit të ushtruar nga subjekti i rivlerësimit kundër vendimit nr. {***}/2016 të Gjykatës Administrative të Apelit [e cila ka vendosur rrëzimin e padisë së ngritur nga subjekti kundër vendimit të ish KLD-së nr. {***} datë 16.07.2014, për dhënien e masës disiplinore "Vërejtje me paralajmërim"].

6.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka shkelur të drejtat e tij për një *proces të rregullt*, pasi hetimi i kryer nga Komisioni ka qenë i njëanshëm, i realizuar në kundërshtim të plotë me normat procedurale si dhe në zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Procesi dhe vendimi i Komisionit nuk respektojnë parimin e ligjshmërisë, të drejtësisë e paanësisë, barazisë para ligjit, e mbrojtjes juridike dhe të lirive dhe të drejtave kushtetuese apo parimin e proporcionalitetit. Ndërsa në parashtrimet shtesë të datës 20.01.2025, subjekti ngre për herë të parë pretendimin se vendimi i Komisionit ka cenuar të drejtën e subjektit për punë, të garantuar nga neni 49, pika 1 e Kushtetutës, neni 6/1 i KEDNJ dhe neni 6.1 i Paktit Ndërkombëtar “Për të drejtat ekonomike, sociale e kulturore”. Cenimi i kësaj të drejte ka sjellë edhe cenimin e të drejtës për jetë private e familjare, sipas kuptimit të nenit 8 të KEDNj-së.

6.2. Lidhur me *aspektin procedural* të procesit, subjekti i rivlerësimit në mënyrë të përmbledhur pretendon se hetimi ka qenë i paplotë pasi Komisioni: (i) nuk i është referuar provave të paraqitura nga subjekti gjatë hetimit; (ii) nuk ka kryer hetim të pavarur dhe proaktiv për arritjen e një konkluzioni. Komisioni ka vepruar në kundërshtim me ligjin procedural lidhur me provat dhe barrën e provës, pasi:

- nuk është shprehur me vendim të ndërmjetëm për provat e paraqitura prej tij, për çdo çështje për të cilën i ka kaluar barrën e provës. Po ashtu, nuk është shprehur për kërkesat dhe provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit në datën 14.09.2021, një ditë përpara zhvillimit të seancës dëgjimore;
- nuk e ka njoftuar pas kalimit të barrës së provës, mbi provat e shpjegimet që nuk u pranuan dhe as mbi arsyet e mospranimit të tyre;
- ka cenuar parimin e kontradiktoritetit sepse nuk ka bërë rivlerësim të situatës dhe as i ka njoftuar subjektit rezultatin e mundshëm të pritshëm, pas depozitimit të prapësimeve dhe provave, duke mos i kaluar barrë prove për këtë rezultat të ri;
- në lidhje me kriterin e figurës, ka arsyetuar për cenim të besimit tek publiku vetëm në vendimin përfundimtar, duke mos i krijuar mundësinë e mbrojtjes e që të paraqesë argumentet e plota, për të kundërshtuar vlerësimin e kryer nga Komisioni.

6.3. Në lidhje me *aspektet e përmbajtjes dhe të formës së vendimit* të Komisionit:

- vendimi objekt ankimi, bazohet në shkelje të rënda procedurale, në konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe pa marrë në analizë të gjitha provat;
- vendimi nuk është proporcional me rezultatin përfundimtar të procesit dhe me vlerësimin tërësor të procedurave si dhe nuk i është përmbajtur standardeve e parimeve kushtetuese, administrative e ligjore të arsyetimit të vendimit dhe as elementëve të nenit 57 të ligjit nr. 84/2016;
- vendimi nuk është i arsyetuar mjaftueshëm, në mënyrë konkrete, të qartë, të përmbledhur dhe nuk ka bërë vlerësim korrekt ligjor, civil e juridik. Ai thjesht citon dispozitat pa bërë interpretimin dhe analizën ligjore të tyre, mangësi të cilat e bëjnë atë të paarsyetuar në prova dhe ligj. Në lidhje me kriterin e pasurisë, vendimi është i paarsyetuar pasi Komisioni nuk referon dispozitat e kontabilitetit në të cilat është mbështetur për përlllogaritjet dhe as metodat e analizës financiare. Kjo paqartësi i ka shkaktuar subjektit pamundësi për

realizimin e një mbrojtje efektive. Në lidhje me kriterin e figurës, vendimi ka të meta thelbësore që e bëjnë të cenueshëm urdhërimin e tij, pasi nuk përmban të gjithë elementët e një vendimi përfundimtar. Komisioni nuk ka interpretuar dispozitat ligjore as në mënyrë formale, duke i shkaktuar në këtë mënyrë subjektit pamundësi efektive mbrojtje.

III/2. Shkaqet e ankimit lidhur me vlerësimin e pasurisë

7. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimmarrja e Komisionit është *e njëanshme*, e pabazuar në prova dhe i mungon analiza e saktë financiare. Duke mos i njoftuar në rezultatet e hetimit dhe as në seancë dëgjimore se shkeljet për kriterin e pasurisë do të përbënin cenimin e besimit të publikut të sistemi i drejtësisë, Komisioni ka vepruar në shkelje të së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe ka cenuar parimin e kontradiktoritetit, pasi i ka mohuar subjektit të drejtën të mbrohet rregullisht, për kriterin e pasurisë.
8. Subjekti ankimon konkluzionin e Komisionit për *apartamentin e banimit në Elbasan*, me pretendimet e përmbledhura në vijim:
 - 8.1. Subjekti i rivlerësimit ka pasur mjaftueshmëri burimesh financiare të ligjshme, për blerjen e apartamentit në Elbasan.
 - 8.2. Referenca e Komisionit në të dhënat e Entit Kombëtar të Banesave mbi kostot e ndërtimit në vitet 2004 e 2010 është e gabuar. Çmimet e tregut të lirë janë dakordësuar me vullnet të plotë e të pavesuar të palëve.
 - 8.3. Veprimet në kontratat e shitjeve të realizuara gjatë viteve 2006 - 2010 për apartamentin në fjalë, janë cilësuar gabimisht si veprime fiktive, të kryera për fshehjen e pasurisë që dyshohet se i përket subjektit të rivlerësimit.
 - 8.4. Komisioni ka tejkalluar parashikimet ligjore për procesin e rivlerësimit, duke i kualifikuar prindërit e bashkëshortes si “persona të tjerë të lidhur”, për shkak të banimit të përkohshëm të subjektit në banesën e tyre në Tiranë. Këta individë nuk kanë pasur me subjektin marrëdhënie biznesi, huamarrjeje apo dhurimi për pasurinë në Elbasan e për rrjedhojë, nuk ishin persona të tjerë të lidhur me të. Komisioni nuk duhej t’i kërkonte subjektit të rivlerësimit shpjegime për mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme financiare dhe/apo logjikën ekonomike në investimin e prindërve të bashkëshortes së tij në vitet 2002-2004 dhe të E. L. në vitin 2006.
 - 8.5. Komisioni nuk ka analizuar pretendimet e subjektit se vjehri i tij [z. R. F.] dhe z. E. L. kanë pasur likuiditete të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie. Përsa i përket nevojës për të provuar burimin e krijimit të këtyre të ardhurave, subjekti është ndodhur në kushtet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.
9. Për *apartamentin e banimit në rrugën “{***}”, në Tiranë*, në pronësi të vjehrrit dhe në përdorim të subjektit:
 - 9.1. Komisioni nuk duhej t’i kualifikonte prindërit e bashkëshortes si persona të tjerë të lidhur me subjektin. Banimi i subjektit në banesën e tyre ka qenë i përkohshëm, në periudha që datojnë para vitit 2017 të dorëzimit të deklaratës *vetting*.

9.2. Komisioni nuk e ka njoftuar në mënyrë shteruese në rezultatet e hetimit dhe as në seancë dëgjimore, se pamjaftueshmëria e burimeve financiare të vjehrrit për blerjen e apartamentit në Tiranë, do të kishte pasoja ligjore për apartamentin e banimit në Elbasan. Rezultati financiar për blerjen e apartamentit në Tiranë, ndonëse nuk e ka ngarkuar me përgjegjësi subjektin, është mbajtur në vëmendje të Komisionit për një vlerësim të përgjithshëm.

9.3. Subjekti kundërshton rezultatin e hetimit se familja e vjehrrit të subjektit ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën 921.389 lekë për blerjen e pasurisë apartament në Tiranë. Sipas pretendimeve, të ardhurat neto të siguruara nga vjehri i tij prej veprimtarisë private të transportit dhe nga transaksionet e ndryshme, kanë qenë mjaftueshëm të larta. Komisioni nuk ka shpjeguar praktikën mbi të cilën ka bazuar përlllogaritjen e marzhit të fitimit bruto në masën 60% të qarkullimit të realizuar nga aktiviteti privat i vjehrrit, ndërkohë që në parim, ky marzh është më i lartë se 60 % i llogaritur nga Komisioni;

9.4. Gjatë analizimit të pretendimeve të tij, të mbahet parasysh: (i) periudha e largët e krijimit të të ardhurave të vjehrrit, që prej vitit 1993 e deri në kohën që u lidh bashkëjetesa e vajzës së tij me subjektin; (ii) faktin që në atë periudhë kohore, bashkëshortja e subjektit dhe vjehri i tij R. F. nuk ka qenë subjekte deklarues në ILDKPKI; si dhe (iii) provat rrethore të depozituara pranë Komisionit, të cilat provojnë fluksin e të ardhurave në familjen e vjehrrit.

10. Analiza financiare e Komisionit është produkt i një interpretimi të gabuar lidhur me: (i) shpenzimet e jetesës; (ii) mundësinë e subjektit për krijimin e kursimeve; (iii) mospranimin e të ardhurave të dhuruara nga i vëllai H. M.; (iv) vlerësimin e gabuar të veprimeve të kryera në vitin 2007 me objekt fillimisht depozitim e më pas transferimin e një shume 20.000 USD, e cila është cilësuar gabimisht si depozitë dhe si shpenzim i subjektit dhe familjes së tij. Analiza financiare nuk do të rezultonte me bilancin e përgjithshëm negativ në vlerën rreth 3.39 milion lekësh, por në një vlerë më të vogël, e cila nën dritën e parimit të proporcionalitetit, nuk duhet ta penalizojë subjektin në formën e deklarimit të pamjaftueshëm. Këto pretendime do të trajtohen gjerësisht në vijim të vendimit, në shkaqet ankimore respektive.

III/3. Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e kontrollit të figurës

11. Subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i vendimit të Komisionit për cenimin e besimit të publiku është një përfundim me konsiderata të përgjithshme dhe i pabazuar në rrethana e prova konkrete, pasi:

11.1. Është mbështetur në aktet e përcjella nga DSIK-ja, të cilat përmbajnë konsiderata të përgjithshme dhe nuk kanë nivelin e provueshmërisë për të nxjerrë përfundime kundër figurës.

11.2. Komisioni nuk ka analizuar se për cilat fakte e rrethana subjekti ka bërë deklarime të pamjaftueshme për figurën.

11.3. Konkluzioni për cenim të besimit të publikut me pasoja në vijimin e detyrës, duhet të lidhet me sjellje që përbëjnë shkelje të normave ligjore në fuqi. Vendimi objekt ankimi nuk përcakton se në cilat çështje kanë rezultuar të provuara konstatimet e Komisionit për *përputhje midis*

informacioneve të klasifikuara të DSIK dhe qasjeve procedurale të ndërthura me zgjidhjet substanciale të kryera prej subjektit të rivlerësimit.

11.4. Komisioni nuk i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës në lidhje me kriterin e figurës dhe nuk ia ka bërë me dije qartazi, se si këto prova ndikojnë në vlerësimin e kriterit të figurës. Kjo mënyrë të proceduari, duke arsyetuar mbi cenimin e besimit të publiku vetëm në vendimin përfundimtar, përbën shkelje të së drejtës për proces të rregullt ligjor, pasi subjektit i është mohuar e drejta për t'u mbrojtur, sipas parimit të kontradiktoritetit.

III/4. Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

12. Për këtë kriter, subjekti i rivlerësimit kundërshton kufijtë kohorë të shtrirjes së hetimit, kompetencën lëndore apo të standardeve ligjore të vlerësimit të këtij kriteri, si edhe konkluzionin për cenim të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Konkretisht, sipas tij, Komisioni ka kryer shkeljet që vijojnë:

12.1. Nuk ka arsyetuar shkaqet e shtrirjes së kontrollit jashtë periudhës së rivlerësimit të përcaktuar në nenin 41 të ligjit nr. 84/2016 dhe shkaqet e marrjes në shqyrtim të dosjeve të gjykuara prej subjektit jashtë kësaj periudhe rivlerësimi.

12.2. Në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 84/2016, nuk ka mbajtur parasysh faktin se kontrolli i aftësive profesionale bazohet në standarde të tjera e të ndryshme nga kriteri i figurës. Duke përfshirë këto dy kritere për të njëjtin fakt e shkak ligjor në të njëjtën proces, Komisioni ka aplikuar në fakt, një standard të dyfishtë që përbën penalizim të dyfishtë, joobjektiv dhe joproporcional.

12.3. Ka ngarkuar subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi për shkelje të cilat nuk janë evidentuar nga hetimi i drejtpërdrejtë dhe i pavarur i kryer prej tij, por në gjetje të marra të gatshme dhe me të njëjtën mënyrë arsyetimi, nga relacioni i mbajtur nga Ministria e Drejtësisë në vitin 2009, lidhur me një procedim disiplinor të nisur ndaj subjektit në atë kohë. Komisioni nuk duhej t'i jepte peshë konkluzioneve të Ministrisë së Drejtësisë, pasi ky institucion nuk është aktualisht një nga organet ndihmëse të procesit të rivlerësimit, por vetëm një nga burimet e shfrytëzueshme për të kryer vlerësimin e aftësive profesionale.

12.4. Proceset disiplinore të kryera nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë [referuar në vijim KLD] dhe inspektorati i tij nuk duhet të ishin marrë në konsideratë, pasi këto organe kanë ushtruar funksionet deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor [referuar në vijim KLGj]. Veprimtaria e kryer prej ish-KLD-së dhe qëndrimet e këtij institucioni nuk janë objekt verifikimi në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve.

12.5. Ka vepruar në tejkalim të kompetencës së tij lëndore në kundërshtim me nenet 179, pikat 3 e 4 të Kushtetutës, nenin "E", paragrafët 1 e 2 të Aneksit të Kushtetutës dhe në kundërshtim me vendimin nr. 15/2010 të Gjykatës Kushtetuese, pasi ka vlerësuar bindjen e brendshme të vendimmarrjes së magjistratit, që është detyrë e gjykatave më të larta.

12.6. Vendimi i Komisionit është i paarsyetuar, pasi shkeljet e pretenduara janë të lidhura ngushtësisht me bindjen e brendshme të magjistratit dhe nuk mund të jenë gjetje të vlerësimit të figurës dhe të aftësive profesionale për secilën dosje objekt rivlerësimi në veçanti dhe për të gjithë

kriterin e aftësive profesionale. Vendimi është i paqartë, pasi Komisioni nuk analizon se cili ka qenë konkluzioni lidhur me kërkesat e pretendimet që ka dhënë subjekti për çdo gjetje e çështje për të cilën i ka kaluar barrën e provës. Komisioni nuk është shprehur nëse ka pranuar apo refuzuar kërkesat dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit më datë 14.09.2021, të cilat provonin në mënyrë shteruese të kundërtën e rezultateve të hetimit. Vendimi është i paarsyetuar, pasi Komisioni, as në rezultatet e hetimit dhe as në seancë dëgjimore, nuk rezulton të ketë bërë një kualifikim të caktuar e të qartë ligjor, sipas dispozitave konkrete të ligjit nr. 84/2016, ligjit nr. 96/2016 apo ligjeve të tjera, kualifikime të cilat mund të rëndonin subjektin e rivlerësimit me pasoja të caktuara juridike për kriterin e aftësive profesionale, duke e konsideruar si të papërshtatshëm në formën e cenimit të besimit të publikut, në atë nivel që e bën të pamundur vazhdimin e ushtrimit të funksionit.

12.7. Në konkluzione, Komisioni i referohet nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pa analizuar saktë se për cilat çështje konkrete subjekti ka cenuar besimin e publikut. Gjithashtu, Komisioni nuk e ka njoftuar subjektin e rivlerësimit në rezultatet e hetimit apo seancë dëgjimore se shkeljet përkatëse për kriterin e aftësive profesionale do të përbënin cenim të besimit të publikut.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegji

i) Juridiksioni i Kolegjit

13. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja me objekt shqyrtimi kundërshtimin e vendimit të Komisionit, nëpërmjet të cilit është vendosur shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit Bujar Musta, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

ii) Legjitimimi i ankuesit

14. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

iii) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

15. Trupi gjykues i Kolegjit, me përbërjen si në pjesën hyrëse të këtij vendimi, është rezultat i shortit të datës 15.11.2021 dhe i shortit të datës 15.01.2025 për zëvendësimin e dy gjyqtarëve anëtarë, Ardian Hajdari e Natasha Mulaj⁹. Fillimisht, trupi gjykues i Kolegjit mori në shqyrtim kërkesat

⁹ Në datën 15.01.2025, në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit u hodh shorti për zëvendësimin e gjyqtarit Ardian Hajdari, për shkak të pezullimit të tij nga detyra me vendimin nr. {***}, datë 07.02.2022, të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe për zëvendësimin e gjyqtarës Natasha Mulaj pas kërkesës së saj për heqjen dorë nga

procedurale të subjektit të rivlerësimit, që kanë të bëjnë kryesisht me kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore publike, riçeljen e hetimit gjyqësor dhe administrimin e provave që janë pjesë e dosjes së Komisionit e marrjen e provave të reja të paraqitura prej tij.

15.1. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si rregull, shqyrtimi i ankimit të subjektit të rivlerësimit kundër një vendimi përfundimtar të Komisionit kryhet në dhomë këshillimi¹⁰. Trupi gjykues i Kolegjit konkludoi të vijojë shqyrtimin e ankimit mbi bazë aktesh, në dhomë këshillimi, në kushtet që konstatoi se nuk gjen zbatim asnjë nga rrethanat e përcaktuara në ligj¹¹ për kalimin në seancë gjyqësore publike në praninë e subjektit. Ky vlerësim përfshin analizën e kryer për shkaqet procedurale apo edhe të vlerësimit të rrethanave faktike përcaktuar nga neni 51 i ligjit nr. 49/2012, shtjelluar në vijim.

15.2. Kolegji, vlerësoi se: (a) Komisioni ka konstatuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë dhe, për pasojë, nuk nevojitet vërtetimi i fakteve të reja dhe marrja e provave të reja; (b) nuk konstatohen shkelje të rënda procedurale që të kenë ndikuar në vendimmarrje apo gjendje faktike të konstatuara gabim dhe në mënyrë jo të plotë nga Komisioni; si dhe (c) nuk është e nevojshme përsëritja e marrjes së disa apo të gjitha provave të administruara në Komision. Konkretisht, ndër dhjetë aktet e depozituara me ankimin dhe me parashtrimet shtesë, të listuara në poshtëshënimet nr. 6, 7 dhe 8 të këtij vendimi, 6 (gjashtë) prej tyre nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, për rastet përjashtimore që normon ligji për provat e reja që lejohen me ankimin. Ndërsa 4 (katër) akte¹² që datojnë pas dhënies së vendimit objekt shqyrtimi nuk përmbajnë rrethana që do të diktonin nevojën për debat gjyqësor në prani të palëve, sipas kërkesave të nenit 51 të po këtij ligji. *Së fundmi*, në tërësinë e tyre, vlerësuar edhe nën dritën e përcaktimeve të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, aktet e sjella nga subjekti u gjetën jo përcaktuese në zgjidhjen përfundimtare të çështjes.¹³

15.3. Për sa më sipër dhe në kushtet që nga analiza e konkluzioneve të Komisionit në funksion të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit nuk identifikohet asnjë shkelje e rëndë procedurale apo

*gjikimi i çështjes, e cila u pranua me vendimin nr. {***}, datë 15.01.2025, nga trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët: Rezarta Schuetz, Sokol Çomo, Ina Rama, Albana Shrylla dhe Mimoza Tasi.*

¹⁰ Neni 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, parashikon: “Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative. [...]”.

¹¹ Neni 51 i ligjit nr. 49/2012 përcakton: “[...] 1. Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji; b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë. [...]”.

¹² (i) një ekstrakt të llogarisë bankare me titullare B. Q., me datë printimi 16.05.2022 nga “Raiffeisen Bank”; (ii) vendim nr. {***} prot. dt. 28.07.2022 i ILD për arkivimin e ankesës së paraqitur nga shtetasi R. R. në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të z. M. D.; (iii) shkresa nr. {***} prot, datë 22.05.2023 e ILD-së për arkivimin e ankesës së Z. E. B.; (iv) ankimi individual i subjektit të rivlerësimit në Gjykatën Kushtetuese, me objekt, shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. {***} datë 07.03.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

¹³ Neni 49, në pikën 6 parashikon: “[...] Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: (a) janë të panevojshme; [...] d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit. [...]”.

konstatim i gabuar i situatës faktike, në kuptim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, që do të sillte nevojën e debatit gjyqësor në seancë gjyqësore publike në Kolegj, me praninë e subjektit të rivlerësimit, për korrigjimin e tyre, shqyrtimi i çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të subjektit të rivlerësimit ishte i panevojshëm. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit e vlerësoi të pabazuar në ligj kërkimin e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike dhe vijoi me shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Arsyetimi i trupit gjykues të Kolegjit për shkaqet e ankimit

B.1. *Analiza e shkaqeve procedurale të ankimit*

16. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka vepruar në shkelje të parimeve që garantojnë një proces të rregullt ligjor e konkretisht të ligjshmërisë, të barazisë para ligjit, të drejtës së subjektit për t'u dëgjuar, sipas parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve dhe në mosrespektim të parimit të proporcionalitetit. Sipas tij, Komisioni, po ashtu, ka kryer hetim të paplotë, ka luajtur rol pasiv, si dhe nuk ka marrë prova në funksion të konkluzionit apo analizuar provat e paraqitura nga subjekti.

16.1. Pasi analizoi aktet në fashikull, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit për cenim të parimeve të procesit të rregullt ligjor. *Së pari*, në kushtet që subjekti shprehet në mënyrë të përgjithshme për një pjesë të këtyre pretendimeve, pa ilustruar ekzaktësisht në çfarë mënyre e me cilat veprime konkrete Komisioni ka shkelur këto parime, trupi gjykues i Kolegjit e analizoi këtë pretendim në nivel parimor. Nga ky kontroll në tërësi i procesit të hetimit administrativ të zhvilluar për subjektin, rezultoi se Komisioni ka respektuar të gjitha garancitë kushtetuese e konventore për proces të rregullt. Komisioni ka kryer hetimin duke ndjekur një procedurë të miratuar e zbatuar për të gjithë subjektet¹⁴ dhe në përputhje me dispozitat kushtetuese e ligjore që thirren në zbatim në mënyrë direkte e indirekte në rivlerësim. Prosesi i hetimit administrativ të kryer për subjektin ka zgjatur në tërësi 20 muaj, nga data 12.11.2019 dhe përfunduar me seancën gjyqësore të datës 15.09.2021. Gjatë kësaj periudhe, sikurse në proceset e kryera për subjektet e tjerë, Komisioni ka marrë akte nga më shumë se 20 institucione¹⁵, i ka dërguar subjektit pyetësorë, si dhe ka administruar përgjigjet e dhëna prej tij. Korrespondenca e përgjigjeve është cituar në poshtëshënimet e vendimit, në formë shpjegimi për hetimin e kryer për çështjen konkrete së cilës i referohet. Komisioni i ka dërguar subjektit rezultatet e hetimit duke specifikuar aspektet për të cilat i ka kaluar barra e provës. Në vijim, Komisioni i ka dhënë subjektit edhe kohë shtesë, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, nga korriku deri në shtator 2021, për të sjellë dokumentacion dhe prapësime. Subjekti është njohur me çfarë ka rezultuar nga hetimi dhe ka dhënë shpjegime, në respektim të parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit. *Së fundmi*, gjatë procesit të

¹⁴ *Hapat Procedurale të Unifikuar të miratuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, miratuar me vendimin nr. {***}, datë 12.02.2018, të Komisionit. Shih <https://kpk.al/wpcontent/uploads/2019/12/Hapat-Procedurale-te-Unifikuar-2-1.pdf>.*

¹⁵ *Ndër të tjerë, nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, ish Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ish ALUIZNI, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë, Elektrike/Furnizuesi i Shërbimit Universal, Shoqëria e Ujësjellës Kanalizime, institucione bankare etj.*

hetimit administrativ të kryer në Komision, subjekti nuk rezulton të ketë ngritur kundërshtime për mënyrën sesi është kryer procesi, për pamundësi për të ushtruar të drejtat për proces të rregullt apo për pamundësi të ndonjë forme për të kryer veprimet që ka vlerësuar të nevojshme për t'u shpjeguar e mbrojtur.

16.2. Nga sa konstatohet në mënyrë të përmbledhur më sipër, rezulton që Komisioni ka kryer hetimin e tij të pavarur, e proaktiv, ndryshe nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit. Trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë që hetimit të pavarur të Komisionit i korrespondon barra e provës së subjekteve për të provuar atë që deklarojnë dhe çfarë rezulton nga hetimi në procesin e rivlerësimit. Kjo nënkupton që subjektet kanë një rol kyç e të pazëvendësueshëm në procesin e rivlerësimit, në kushtet që kanë edhe barrën e provës, që materializohet në prapësimin me shpjegime e dokumentacion për të provuar faktet që pretendojnë. Subjekti ka sjellë për këtë qëllim akte gjatë gjithë procesit, përfshirë përpara seancës dëgjimore. Për këtë arsye, edhe parimi i kontradiktoritetit, që subjekti potencon në mënyrë të përsëritur të jetë shkelur, rezulton të jetë respektuar në çdo hap të procesit të kryer nga Komisioni.

16.3. Pretendimi për mosanalizimin e provave të paraqitura nga subjekti është gjithashtu i pabazuar. Komisioni rezulton të ketë referuar e analizuar, ndër të tjera, edhe dokumentet e sjella nga subjekti i rivlerësimit, ndër të cilat, mund të përmendim: (i) analizën e aktmarrëveshjes së thjeshtë të datës 24.02.2010, të nënshkruar mes tij dhe huadhënëses E. P.¹⁶; (ii) përgjigjet e dhëna nga subjekti në pyetësin nr. 2; (iii) analizimin e dokumentacionit të sjellë nga subjekti i rivlerësimit së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 1 [në pikën 45 të vendimit]; (iv) deklaratën noteriale nr. {***/{***}, datë 31.08.2020, të nënshkruar prej bashkëshortes së subjektit dhe prindërve të saj¹⁷; (v) dokumente të tjera të analizuara në pikën 56 të vendimit si: librezë energjie elektrike, mandat transfertë bankare nga llogaria e bashkëshortes në favor të motrës së saj, vërtetime për të ardhurat e nënës dhe të bashkëshortes, disa prej të cilave edhe janë pranuar nga Komisioni¹⁸; (vi) shpjegimet e subjektit në seancë dëgjimore lidhur me transfertën e 20.000 USD nga bashkëshortja në favor të motrës së saj apo lidhur me transaksionet e kryera në lidhje me apartamentin e ndodhur në Elbasan.

16.4. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson që edhe kundërshtimet e subjektit për formën dhe arsyetimin e vendimit janë të pabazuara. Vendimi i Komisionit përmban të gjitha pjesët e përcaktuara nga neni 57 i ligjit nr. 84/2016¹⁹ e konkretisht hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese, pjesën urdhëruese/dispozitivin. Vendimi specifikon problematikat e konstatuara për secilin prej

¹⁶ Në pikat 31 e 32 të vendimit.

¹⁷ Në pikën 47 të vendimit.

¹⁸ Ndër të tjerë, në paragrafin 61 dhe 64 të vendimit.

¹⁹ Neni 57 i ligjit nr. 84/2016 parashikon që: “[2.] Vendimi përmban hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe urdhëruese. 3. Hyrja e vendimit përmban: a) emërtimin zyrtar të Komisionit; b) trupin gjykues që ka shqyrtuar çështjen dhe punonjësin administrativ; c) orën dhe vendin e vendimit të dhënë; ç) emrin dhe identitetin e subjektit të rivlerësimit, si dhe përfaqësuesve të tij; d) mendimin e subjektit të rivlerësimit dhe/ose të përfaqësuesit të tij. 4. Pjesa përshkruese-arsyetuese përmban: a) rrethanat e çështjes, siç janë vlerësuar gjatë procesit, dhe përfundimet e nxjerra nga trupi gjykues; b) provat dhe arsyet mbi të cilat mbështeten vendimet; 29 c) raportin dhe rekomandimin e relatorit; ç) dispozitat ligjore në të cilat mbështetet vendimi. 5. Pjesa urdhëruese, ndërmjet të tjerash, përmban: a) alternativën që ka vendosur trupi gjykues; b) nëse trupi gjykues ka vendosur të caktojë një masë disiplinore; c) të drejtën e ankimit dhe afatin për paraqitjen e tij.”

kritereve, aktet e depozituara nga subjekti në cilësinë e provës, dokumentacionin e administruar si pasojë e hetimit të Komisionit dhe burimin e marrjes së tij. Këto akte e burime herë citohen në përmbajtje të vendimit e herë në poshtëshënime. Po ashtu, në kontekstin e arsytimit të vendimit, dhe duke mbajtur në konsideratë që subjekti nuk specifikon kundërshtimin konkret që potencon, nga aktet rezulton se përpos analizës shtruese për kriterin e pasurisë, në vendim Komisioni i është referuar edhe konstatimeve dhe analizës që përfshihet në rezultatet e hetimit – në të cilat kriterit të vlerësimit profesional i dedikohet më shumë së gjysma e materialit. Për rrjedhojë, në kushtet që Komisioni i është referuar në mënyrë të shprehur mospërmbysjes së barrës së provës për çështjet që janë marrë në analizë, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se vendimi i Komisionit është i arsytuar, pavarësisht nga qasja e përmbledhur që është zgjedhur. Duke marrë në konsideratë edhe referencën për aspektet për të cilat subjektit i ka kaluar barra e provës, vendimi paraqitet plotësisht i qartë për arsyet mbi të cilat është bazuar konkluzioni i Komisionit.

16.5. *Së fundmi* dhe përpos sa më sipërkonstatuar, nëpërmjet ankimit të ushtruar, procesi i kryer për subjektin korrektohet edhe nga kontrolli që ushtron Kolegji vendimit të Komisionit, bazuar në shkaqet e ankimit të parashtruara nga subjektit. Fakti që subjektit jo vetëm nuk i është pamundësuar kjo e drejtë për shkak të arsytimit të Komisionit, por ai ka qenë në gjendje të parashtronte kundërshtitë e tij në Kolegj në mbi 588 faqe²⁰, si dhe aktet e përcjella së bashku me to, e bënë këtë pretendim të pakuptimtë edhe në kontekstin e garancive procedurale kushtetuese e konventore për transparencën e vendimmarrjes dhe ushtrimin e të drejtave të palëve në proces.

16.6. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se kundërshtitë e subjektit, më tepër se procesin, kanë për fokus zgjidhjen e çështjes nga Komisioni. Në këtë drejtim, u vlerësua edhe mënyra e përgjithshme e kontestimit të bazuar në pretendime për shkeljen e parimeve të mësipërme, pa u lidhur ato me rrethana konkrete apo me veprime e mosveprime konkrete të Komisionit. Kjo qasje formale e përgjithësuese, thuhet mekanike, e parimeve të pretenduara si të shkelura, duhet të jetë zgjedhur për të krijuar idenë e një procesi rivlerësimi të paligjshëm në tërësi, dhe jo për shkak të një perceptimi të mirëfilltë të tij. Në kushtet që subjekti është shprehur pa detaje, nga kontrolli i vendimit në nivel parimor, trupi gjykues vëren që nuk konstaton asnjë shkelje të parimeve themelore të procesit të rregullt. Për sa më sipër, ndryshe nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se konkluzionet e Komisionit janë rezultat i një hetimi të plotë e të thelluar dhe janë rrjedhojë e situatës faktike ligjore të rezultuar nga analiza e akteve të administruara gjatë procesit të rivlerësimit, përfshirë atyre të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit.

- 17.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka vepruar në kundërshtim me ligjin procedural lidhur me provat dhe barrën e provës, pasi: (i) nuk është shprehur me vendim të ndërmjetëm për pranimin ose jo të provave të depozituara me shpjegimet e dhëna, e konkretisht lidhur me kërkesat dhe provat e depozituara më datë 14.09.2021; (ii) pas kalimit të barrës së provës, Komisioni nuk e ka bërë me dije subjektin se cilat nga provat e shpjegimet u pranuan dhe arsyet e mos pranimit të tyre; (iii) pas depozitimit të prapësimeve dhe provave, Komisioni nuk ka bërë rivlerësim të situatës

²⁰ Ankimi i subjektit është shtjelluar në 62 faqe, ndërsa parashtrimet përpara seancës në Kolegj janë 336 faqe të dorëzuara në datën 11.01.2023 dhe 190 faqe të dorëzuara në datën 20.01.2025. Përpos këtyre argumenteve, subjekti ka sjellë akte shkresore të tjera në cilësinë e provës.

dhe nuk i ka njoftuar subjektit “rezultatit e mundshëm të pritshëm”, duke mos i kaluar barrë prove për këtë rezultat; (iv) Komisioni ka arsyetuar mbi cenimin e besimit të publiku vetëm në vendimin përfundimtar. Në këtë mënyrë, Komisioni i ka mohuar të drejtën për tu mbrojtur sipas parimit të kontradiktoritetit.

17.1. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se edhe ky pretendim është i pabazuar. Nga procesverbali²¹ i seancës dëgjimore rezulton se relatori ka referuar shprehimisht administrimin e akteve të dërguara në rrugë elektronike²² në datën 14.09.2021, një ditë përpara seancës dëgjimore, sikurse edhe ato të depozituara gjatë seancës. Këto akte janë pjesë e fashikullit. Po ashtu, deklarata noteriale e hartuar në shtator 2021 e dy të afërmve të bashkëshortes i është nënshtruar edhe debatit gjyqësor në Komision. Në përgjigje të pyetjeve në seancë lidhur me shumën 20.000 USD, subjekti ka dhënë edhe shpjegime, duke iu referuar pikërisht deklaratës noteriale të depozituar një ditë më parë me e-mail. Nga ana tjetër, në procesin e rivlerësimit, sikurse edhe në procese të tjera gjyqësore, nuk mund të argumentohet se zgjatja e debatit gjyqësor pambarimisht ose e kushtëzuar nga kërkimet e palëve paraqet dobi dhe as përputhet me parimet e dhënies drejtësi në kohë të arsyeshme. Në rrethanat konkrete, me kalimin e barrës së provës, subjekti ka qenë i qartë për aspektet që i duhet të përmbyste, dhe ka marrë edhe kohë shtesë për të përgatitur prapësime, me shpjegime e akte që provojnë pretendimet e tij. Për rrjedhojë, pretendimi se ky hap procedural duhet të përsëritej i kushtëzuar nga prurje dokumentesh e shpjegimesh të tjera, apo duhet të kishte edhe një fazë gjatë së cilës subjekti të njëjhej me “rezultatit e mundshëm”, është jo vetëm i pabazuar në kuadrin ligjor të rivlerësimit, por edhe i pakuptimtë edhe në një proces standard civil e administrativ. Nëse do të gjente zbatim një situatë sikurse ajo që parashtron subjekti, nënkuptohet prodhimi i dokumenteve të reja, shtesë, sipas nevojës së palëve, pa një limit në kohë e pa objektiv zgjidhjen e çështjes, duke ia lënë drejtimin e procesit palëve me kërkesat e kundër-kërkesat përkatëse. Për më tepër, në kushtet që procesi i rivlerësimit kalimtar është një proces administrativ, dhe i nënshtrohet rregullimeve të ndryshme nga ato të procesit civil dhe ka natyrë të përkohshme/kalimtare, objektivi kohor merr rëndësi të veçantë, së bashku me mbajtjen e barrës së provës nga subjektet e rivlerësimit. Pikërisht për të rregulluar nga ana ligjore natyrën dhe qëllimin e procesit që në përputhje me përcaktimin e pikës 3 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikat 2 e 3 të nenit 53 të ligjit nr. 44/2015²³ institucionet e rivlerësimit duhet të vendosin afate të arsyeshme për subjektet, ndërsa në të njëjtën kohë, kryejnë një proces të kufizuar në kohë. Nga ana tjetër, nenet 45 e vijues të ligjit nr. 84/2016, përcaktojnë qartë rregullat e përgjithshme të hetimit të çështjes. Në asnjë dispozitë të këtij ligji nuk parashikohet detyrimi i Komisionit për t’u shprehur me vendim të ndërmjetëm për çdo provë të paraqitur nga subjekti. Në bazë të nenit 52, subjektet njihen me rezultatet e hetimit për secilin kriter të hetuar dhe subjektit të rivlerësimit i kalohet barra e provës

²¹ Shih faqen nr. 21 të procesverbalit të seancës dëgjimore.

²² Evidenca të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan mbi ngarkesën dhe shpërndarjen e çështjeve gjyqësore në këtë gjykatë, si edhe një deklaratë noteriale datë 13.09.2021 të dy individëve, të afërm të bashkëshortes së subjektit.

²³ Neni 53 “Përcaktimi dhe shtyrja e afateve procedurale”, ndër të tjera, parashikon: “[...] 2. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit. 3. Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit”.

për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit. Nëse për çdo akt, pretendim e kërkesë të subjekteve të rivlerësimit do të kishte rezultate paraprake sipas panoramës së potencuar nga subjekti, procesi do të zgjaste sipas nevojave të subjekteve e mund të sfidonte qëllimin për të cilin kryhet rivlerësimi. Në këndvështrimin e procesit të rregullt, subjekti kundërshton edhe konkluzionin e Komisionit për cenim të besimit të publikut, duke potencuar se ky vlerësim ka gjetur pasqyrim vetëm në vendim. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se ky pretendim është i pabazuar. Në kushtet që çështjet dhe problematikat për të cilat Komisioni ka vendosur masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, janë ato të evidentuara në rezultatet paraprake të hetimit, cilësimi përfundimtar i kryer në vendim, duke zgjedhur pikën 5 të nenit 61 – përkundër pikës 4, e cila i dedikohet kriterit të vlerësimit profesional – nuk mund të argumentohet se përbën risi, apo që të ketë një peshë e pamundësojë dhënien e shpjegimeve apo kundërshtimit, në funksion të mbrojtjes dhe kontradiktoritet në proces, sipas garancive kushtetuese e konventore. Në këtë linjë, trupi gjykues vëren edhe që rezultatet e hetimit nuk mund të përmbajnë konkluzionin përfundimtar, përkufizimisht, pasi janë faza në të cilën subjektet kanë mundësinë të përmbysin barrën e provës dhe konstatimet paraprake të Komisionit. Mënyra dhe kategorizimi që Komisioni kryen për konkluzionet tek të cilat arrin, janë diskrecion i Komisionit për sa kohë çështjet dhe problematika e konstatuar paraprakisht i është bërë me dije subjektit. Në rrethanat konkrete, problematikat e përcjella nëpërmjet raportit të rezultateve të hetimit, kanë qenë të qarta dhe lidheshin me veprime apo qasje të subjektit. Kjo lidhje logjike, qoftë edhe e nënkuptuar, duket se ka qenë e qartë edhe për subjektin, i cili në prapësimet e rezultateve të hetimit/të barrës së provës, ka dhënë shpjegime lidhur me cenimin e besimit të publikut. Ky fakt nënkupton që edhe pse fraza nuk është referuar shprehimisht, subjekti ka qenë në gjendje të mbrohet dhe përgatisë kundër-argumentet e tij e sjellë akte për të provuar të kundërtën, edhe në kontekstin e cenimit të besimit të publikut. Edhe pretendimi i subjektit për cenim të së drejtës së tij për punë dhe, për rrjedhojë, edhe të drejtës për jetë private e familjare, sipas kuptimit të nenit 8 të KEDNJ-së, referuar disa të drejtave kushtetuese, konventore e të standardeve ndërkombëtare, është ngritur në terma të përgjithshëm. Subjekti nuk ka dhënë argumente përse punësimi i është mohuar. Për rrjedhojë dhe duke e analizuar atë në nivel parimor dhe pa përsëritur sa është elaboruar gjerësisht në shumë vendime të mëparshme të Kolegjit nga shumë subjekte, trupi gjykues i Kolegjit e gjen këtë pretendim të pabazuar dhe çmon të rikonfirmojë jurisprudencën e GjEDNJ-së në çështjen kyç *Xhoxhaj* kundër Shqipërisë, për përputhshmërinë e procesit me garancitë konventore apo edhe në çështjen *Sevdari* kundër Shqipërisë.²⁴ Në këto dy vendime, GjEDNJ-ja ka konstatuar edhe që procesi i rivlerësimit nuk pas-sjell ndalimin e ushtrimit të profesionit në çdo kapacitet për magjistratët që nuk arrijnë ta kalojnë me sukses, dhe që pretendimi për cenim të jetës private, bazuar në frikë për të ardhmen për ushtrimin e profesionit, pa pasur një akt konkret që e pengonte në ushtrimin e kësaj të drejte, është vlerësuar i pabazuar.

17.2. Së fundmi, edhe pretendimi i subjektit se vendimi i Komisionit nuk është proporcional në raport me rezultatin përfundimtar të procesit dhe me vlerësimin tërësor të procedurave është i

²⁴ Paragrafi 66: “[...] Frika se ajo mund të bëhet viktimë e një shkeljeje të Konventës duke u përjashtuar në të ardhmen nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, nuk është e mjaftueshme që subjekti të pretendojë se rrezikon të prekej drejtpërdrejt nga neni 13(2) i Ligjit për Avokatët dhe se në këtë mënyrë ishte viktimë e shkeljes së të drejtave të saj të Konventës në këtë drejtim[...].”

pambështetur në akte. Sikurse do të shtjellohet gjerësisht në shkaqet ankimore respektive, në kushtet që Komisioni ka konstatuar problematika në të tri kriteret e rivlerësimit, dhe që secili prej aspekteve veçmas është shoqëruar me moskalim të kriterit përkatës, pretendimi i subjektit për vendim disproporcional është i pakuptimtë. Ky pretendim do të bënte kuptim teorikisht në një situatë në të cilën një subjekt do të rezultonte me probleme, pavarësisht nga nëse në një apo disa kriteret – që në tërësi do të ishin të pamjaftueshme për masën disiplinore ose masa disiplinore do të ishte e padrejtë. Në kushtet që Komisioni ka gjetur mungesë të *theksuar* të burimeve të ligjshme, edhe duke abstraguuar problemet e tjera në kriterin e pasurisë [fshehje pasurie] apo ato të figurës e vlerësimit profesional [vlerësuar bashkërisht], masa disiplinore e shkarkimit nga detyra është në proporcion me shkeljet e konstatuara.

B.2. Analiza e shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e pasurisë

B.2.1. Apartament banimi me sipërfaqe 121,09 m², ndodhur në Elbasan

18. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *vetting* këtë pasuri të blerë në shkurt 2010 kundrejt çmimit 3.000.000 lekë dhe burime të ardhurat nga pagat, dhurimet, shitja e një shtëpie tjetër dhe huamarrje²⁵. Në deklaratën për vitin 2010, subjekti nuk ka qenë specifik duke deklaruar pakësimin e kursimeve dhe deklaruar një hua 1.000.000 lekë në rubrikën e detyrimeve. Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka qenë që prej vitit 2004, pronari *de facto* i këtij apartamenti. Të gjitha veprimet juridike lidhur me këtë pasuri kanë qenë fiktive e të kryera me porosi, për llogari dhe në favor të subjektit të rivlerësimit, për t'i mundësuar atij: (a) blerjen e apartamentit me një çmim shumë më të lirë se ai i tregut, madje edhe më të lirë se vetë kostoja e ndërtimit; (b) përdorimin e apartamentit pakundërshtëpërblim për një periudhë rreth 3-vjeçare [2007-2010]; (c) fshehjen e investimit të tij për këtë pasuri prej vitit 2004 deri në vitin 2010, vit në të cilin janë kryer pagesat dhe është formalizuar tjetërsimi i apartamentit në fjalë në emër të subjektit. Këto veprime të subjektit të rivlerësimit u konsideruan nga Komisioni si cenim i besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, duke e vendosur atë në kushtet e aplikimit të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

18.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton këtë konkluzion në tërësi, duke pretenduar se ka deklaruar saktë dhe nuk gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë. Pretendimet konkrete të përmbledhura në pikën 8 të këtij vendimi të Kolegjit shtjellohen në vijim të analizimit të kësaj pasurie.

18.2. Nga kontrolli i vendimit dhe nga aktet e administruara në fashikull, analizuar nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se arsyetimi i Komisionit është i bazuar. Edhe në vlerësimin e Kolegjit, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të përmbysë barrën e provës që ai ka qenë pronari i vërtetë i këtij apartamenti edhe për tetë (8) vite përpara se të formalizonte blerjen e kësaj pasurie e konkretisht, që prej vitit 2002, kur janë kryer pagesat për

²⁵ *Deklaruar me detajet si vijon: “Apartament në lagjen “{***}” të qytetit të Elbasanit, të blerë në datën 26.02.2010, në vlerën 3.000.000 lekë. Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar: (i) të ardhurat e krijuara ndër vite nga pagat e tij dhe të bashkëshortes; (ii) kursimet familjare në vite; (iii) shumën 500.000 lekë të dhuruar nga i vëllai; (iv) të ardhurat e përfituara nga shitja e një apartamenti në qytetin e Burrelit; dhe (v) shumën 1.000.000 lekë marrë hua në vitin 2010, nga znj. E. P.”.*

këtë pasuri nga vjehri i tij. Nga ana tjetër, në kushtet që kjo pasuri është formalizuar si pronë e subjektit dhe e personit të lidhur dhe është deklaruar si e tillë në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, ndryshe nga Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e *deklarimit të rremë* për momentin e krijimit të kësaj pasurie, në kuptim të gërmës “ç”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Veprimet e përsëritura të kryera nga subjekti i rivlerësimit, duke e formalizuar marrëdhënien e pronësisë me pasurinë pas disa vitesh që gëzonte frytet e saj dhe vetëm pas disa transaksioneve të mëparshme formale në emër të familjarëve të bashkëshortes, trupi gjykues i vlerësoi në dritën e cenimit të besimit të publikut, parashikuar nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

18.3. Nga analiza integrale e akteve në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti nuk arriti të bindë që apartamenti ishte pronë e palëve të treta përpara kontratës së vitit 2010, nëpërmjet të cilës ai e personi i lidhur/bashkëshortja u bënë pronarë të kësaj pasurie. Pronarët e mëparshëm *de jure*, respektivisht i ati/prindërit e bashkëshortes në vitet 2002/2004 e më pas një i afërm i saj në vitin 2006, rezultuan jo vetëm pa arsye jetësore për të kryer këtë investim, por edhe në mungesë logjike financiare për kryerjen e këtij investimi në qytetin e Elbasanit, ku asnjëri prej tyre nuk rezultoi të ketë pasur interesa pasurore apo profesionale. Ndërsa asnjë prej këtyre dy individëve, sikurse edhe në Komision, nuk u analizua nga Kolegji si person *tjetër* i lidhur, ata rezultuan me mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e apartamentit objekt vlerësimi. Analiza mbi të cilën bazohet ky konkluzion mbështetet në një sërë rrethanash që rezultojnë nga aktet në fashikull dhe në arsyetimin që shtjellohet në vijim.

18.4. Subjekti e ka deklaruar apartamentin objekt analize si adresën e tij të banimit, duke nisur nga vitet 2007, 2008 dhe 2009 në deklaratat periodike vjetore. Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka sjellë një deklaratë noteriale të shitësit të apartamentit, kushëri i bashkëshortes së tij, për të provuar banimin e tij në të pa kundërshtëpërbllim duke nisur nga viti 2007 e deri në kohën e shitjes, në mars 2010. Sikurse edhe Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit vëren se ka një sërë aktesh që provojnë se ka qenë subjekti që ka poseduar këtë apartament që në vitin 2003 e jo nga viti 2007, sikurse ai pretendon.

18.5. Nga aktet e përcjella në Komision²⁶ rezulton se pasuria fillimisht ka kaluar në pronësi të vjehrit të subjektit, më 22.11.2004, nga shoqëria ndërtuese. Në datën 05.04.2008, vjehri ia ka shitur një afërm tjetër [kushëri i bashkëshortes së subjektit] dhe ky i fundit, i cili ka dhënë edhe deklaratën noteriale në hetimin administrativ në Komision, ia ka shitur apartamentin subjektit në datën 09.03.2010. Po nga aktet ka rezultuar edhe se disa nga kontratat e shërbimeve utilitare për këtë apartament janë lidhur në emër të subjektit që më 31.03.2004²⁷. Këto fakte, së bashku me deklaratat periodike vjetore të dorëzuara nga subjekti, u vlerësuan me peshë të posaçme nga trupi gjykues i Kolegjit, sikurse edhe nga Komisioni, pasi tregojnë një lidhje të qenësishme të tij me apartamentin edhe *përpara* datës kur formalisht ai iu shit vjehrit të subjektit [nëntor 2004], më së paku prej datës së lidhjes së kontratës së energjisë elektrike në mars të të njëjtit vit. Po ashtu, në

²⁶ Kartela e pasurisë, dërguar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

²⁷ Furnizuesi i Shërbimit Universal, në datën 20.11.2020, ka konfirmuar kontratë energjie elektrike të lidhur në datën 31.03.2004 për pasurinë objekt analize me abonent Bujar Musta. Kjo kontratë ndër të tjera mban edhe shënimin për ndryshim emri nga E. L. në Bujar Musta.

deklaratat periodike vjetore, duke filluar nga 2003, subjekti ka deklaruar, ndër të tjera, edhe të ardhurat e nënës së tij nga pensioni i përfutur pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Elbasan [në vijim “ISSh Elbasan”] dhe gjatë hetimit administrativ ka depozituar edhe dokumentacion që tregon që nëna e subjektit ka jetuar me subjektin në qytetin e Elbasanit, më së paku prej vitit 2003²⁸.

18.6. Nga ana tjetër, aktet e sjella nga subjekti²⁹ në prapësim të barrës së provës, për shërbimet utilitare të lidhura për llogari e në emër të pronarit formal të mëparshëm [z. E. L.], nuk provojnë të kundërtën e sa ka konkluduar Komisioni e Kolegji për posedimin e apartamentit në mënyrë të vazhdueshme nga subjekti. Ajo që është më e rëndësishme, aktet e sjella nga subjekti gjatë hetimit dokumentojnë ngjarje pjesërisht kontradiktore me ato të administruara nga Komisioni nëpërmjet korrespondencës me FShU-në. Subjekti ka sjellë dy kontrata energjie me të njëjtin numër, njëra prej të cilave është pa datë ndërsa tjetra, nis nga prilli 2006, me emrin e pronarit de jure [E. L.]. Shkresa e FShU-së, që konfirmon si palë kontraktore subjektin, mban datën 31.03.2004, ndërsa ajo e sjellë nga subjekti me palë shitësin/pronarin e ndërmjetëm është e prillit 2006. Për sa më sipër, në kushtet që subjekti nuk ka sjellë dokumentacionin që ka shërbyer për lidhjen e kontratës fillestare të energjisë elektrike, nëpërmjet të cilit do të deduktohej pronësia³⁰, shkresat e sjella nga subjekti që datojnë duke nisur nga viti 2006, provojnë vetëm fakte të konfirmuara për pronësinë nga viti 2006 nga korrespondenca e Komisionit me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

18.7. Edhe shkresa tjetër, me shkrim dore, që pretendohet të jetë hartuar në datën 10.05.2004, në emër të një shoqërisë ndërtuese të apartamentit, nënshkruar nga z. M. L., nëpërmjet të cilës pretendohet se vjehri i subjektit ka banuar në këtë apartament përpara lidhjes së kontratës së shitblerjes [22.07.2004] u vlerësua pa peshë provuese. Ky akt, jo vetëm që nuk përmbush as kërkesat e shkresës së thjeshtë private në kuptim të neneve 258 - 263 të Kodit të Procedurës Civile, por është kontradiktor në përmbajtje me deklaratimet e subjektit në pyetësorë për vendbanimin e vjehrit. Konkretisht, subjekti ka pretenduar se së bashku me familjen e tij, gjatë harkut kohor qershor 2000 – gusht 2007, ka jetuar te prindërit e bashkëshortes, në banesën e këtyre të fundit, në Tiranë. Si e tillë, nën dritën e përcaktimit të pikës 4 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016³¹, kjo shkresë është në tërësi e papranueshme si provë.

18.8. Përpos sa më sipër, njësoj si Komisioni, edhe trupi gjykues i Kolegjit e gjen jobindëse situatën faktike të pretenduar nga subjekti, parë në kontekstin e arsyeve financiare/ekonomike që kanë shtyrë babanë e bashkëshortes e në vijim një kushëri të saj, të investojnë në krijimin e kësaj pasurie. Në këtë aspekt, trupi gjykues analizoi edhe mundësitë financiare të këtyre dy personave,

²⁸ Nga vërtetimet e ISSh-së konfirmuar në vërtetimin datë 19.02.2004 të DRSSH Elbasan, në datat 19.02.2004, 15.03.2006 dhe 21.02.2007, nëna e subjektit të rivlerësimit ka përfutur pension pleqërie administruar nga kjo drejtori.

²⁹ Librezë e energjisë elektrike pa datë dhe kontratë furnizimi me energji elektrike në emër të shitësit, z. E. L., me datë çeljeje 28.04.2006, si edhe një kontratë të lidhur më datë 20.04.2006 ndërmjet E. L., shitësit dhe kompanisë {***} ShPK, për furnizimin me ujë të pijshëm të objektit.

³⁰ Shih linkun: <https://oshee.al/wp-content/uploads/2014/12/Ndryshim-i-perdoruesit-te-prones.pdf>, sipas të cilit ky shërbim furnizimi mundësohet vetëm në bazë të paraqitjes së dokumentacionit që përfshin edhe një kopje të dokumentit të pronësisë apo sipërmarrjes.

³¹ Pika 4, e nenit 49, të ligjit nr. 84/2016 parashikon: “Komisioni dhe Kolegji i Apelitimit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes”.

si pjesë e analizës shteruese të çdo aspekti kontrollues në situatën faktike të pretenduar. Konkretisht, familja e prindërve të bashkëshortes, ose edhe babai i saj veçmas, nuk rezulton të kenë pasur *asnjë* lidhje me qytetin e Elbasanit, gjë që përjashton edhe nevojën e tij të ngutshme apo afatgjatë për të jetuar vetëm apo me bashkëshorten në Elbasan, pasi kishte blerë apartamentin në Tiranë dhe shitur atë në Lushnjë. Kjo analizë përforcohet nëse mbahet në konsideratë edhe pretendimi se ai ka jetuar përpara edhe pagesës së gjithë çmimit ndërtuesit, sikurse pretendohet, dhe/ose përpara se të lidhej kontrata përkatëse.

18.9. Në të njëjtën linjë, edhe pronari tjetër, kushëri i bashkëshortes së subjektit ka rezultuar të mos ketë asnjë lloj lidhjeje interesi, sociale apo ekonomike me Elbasanin. Ai rezulton të ketë ushtruar aktivitet në mënyrë të vazhdueshme vetëm në qytetin e Kavajës, si person fizik, në harkun kohor 2004-2014³². Ky person, për më tepër, nuk e ka konsideruar të nevojshme të jetë i pranishëm as në nënshkrimin e kontratës së shitjes së kësaj pasurie [më 26.02.2010] subjektit, duke zgjedhur të përfaqësohet me prokurë të posaçme nga një individ tjetër, znj. E. P., e cila shfaqet në cilësinë e huadhënëses së subjektit për këtë pasuri dhe analizohet në vijim. Mbi të gjitha, mungesa e plotë e ndonjë interesi pasuror/personal të këtij individit në këtë pasuri, dëshmohet qartë nga prokura e përgjithshme e lëshuar prej tij në emër të huadhënëses së subjektit. Konkretisht, në prokurë rezulton i qartë vetëm qëllimi i shitësit për kalimin e pronësisë të pasurisë apartament te persona të tretë ose sikundër ai shprehet në prokurë *për humbjen e pronësisë*. Sipas këtij akti, kalimi i pronësisë/*humbja e pronësisë* jo domosdoshmërisht do të bëhej me shitblerje, por mund të bëhej edhe me forma të tjera si *dhurim, këmbim, apo kontrata të tjera të çdo lloji*. Këto përcaktime kontraktuale natyrshëm nuk mund të mos passjellin pyetjen nëse qëllimi ka qenë vërtet shitja tipike në kushtet që nga përmbajtja e prokurës fokusi rezulton tjetërsimin/humbjen e pronësisë, pavarësisht nga mënyra sesi ky veprim do të kryhej.

18.10. Veprimet e njëpasnjëshme lidhur me blerjen e kësaj pasurie, kryer në emër të babait të bashkëshortes dhe kushëririt të saj, paraqesin disa aspekte që mund të kenë të vetmin shpjegim linear qëllimin për të fshehur lidhjen e vërtetë të subjektit të rivlerësimit me këtë pasuri. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se subjekti i vlerësimit e ka blerë pasurinë objekt vlerësimi në datën 26.02.2010, në vlerën 3.000.000 lekë [24.775 lekë/m²], nga kushëri i bashkëshortes, i cili ka shpenzuar 3.500.000 lekë për ta blerë atë nga vjehri i subjektit. Ky i fundit e ka blerë apartamentin në vitin 2002 – sipas mandatarkëtimit – dhe finalizuar kontratën më 22.07.2004.

18.11. Me fjalë të tjera, apartamenti është blerë nga dy blerësit formalë në vlera më të larta sesa i është shitur subjektit, vite më pas. Ndërkohë, në këtë situatë financiare të pabalancuar, çmojmë të theksojmë që subjekti edhe jetoi pa shpenzime në këtë apartament pakundërshpërblim³³, ndërkohë që bleu apartamentin nën çmimin e paguar nga secili blerësve.

³² Referuar paragrafit 39 të vendimit ku Komisioni citon të dhënat e përftuara nga faqja zyrtare e Qendrës Kombëtare të Biznesit për aktivitetin privat të z. E. L..

³³ Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.12.2019; deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.6.2021 dhe në deklaratat periodike vjetore për vitet 2007, 2008 e 2009, si dhe në pyetësin nr. 1 e nr. 2.

18.12. Edhe blerja e apartamenteve në të tri transaksionet e marra në analizë ishte nën vlerën e tregut të lirë dhe nën koston e ndërtimit, sipas akteve të kohës. Konkretisht, sipas çmimeve që referojnë aktet nënligjore të kohës: (i) për vitin 2004, kur apartamentin e ka blerë vjehri i subjektit, çmimi i shitjes së apartamentit do të ishte 5.401.945 lekë [44.611 lekë/m²], ndërsa edhe kostoja mesatare e ndërtimit do të ishte 3.303.819 lekë [121.09 m² x 27.284 lekë], dukshëm më e lartë se kontrata e shitjes prej 3.100.000 lekësh³⁴; (ii) për vitin 2006, kur apartamentin e ka blerë kushëriri i bashkëshortes së subjektit, çmimi i shitjes së apartamentit do të ishte 5.066.163 lekë [121.09 m² x 41.838 lekë/m²], ndërsa kostoja mesatare e ndërtimit do të ishte e përafërt me vitin 2004, në vlerën 3.303.819 lekë³⁵. Çmimi me të cilin apartamentin e ka blerë kushëriri i bashkëshortes së subjektit, prej 3.500.000 lekësh, është dukshëm më i ulët në raport me vlerën e tregut të lirë; së fundmi; (iii) për vitin 2010, kur apartamentin e ka blerë subjekti, çmimi i shitjes i përcaktuar në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 03.02.2010, do të ishte 5.931.473 lekë ndërsa kostoja e ndërtimit ishte 3.942.206 lekë [121.09 m² x 32.556 lekë/m²]. Subjekti e ka blerë apartamentin për 3.000.000 lekë, dukshëm çmim më i ulët, jo vetëm në raport me vlerën e tregut të lirë, por më i ulët edhe se vetë kostoja e ndërtimit.

18.13. Pretendimi në ankim e parashtrime se në çmimet e shitblerjes kanë ndikuar lidhjet gjinore, mund të merrte kuptim deri diku, në shitjen e një pasurie pa fitim. Në rastin konkret, shitja e pasurisë nën kosto dhe me humbje nga ndërtuesi e në vijim nga shitësi i dytë, kushëriri i bashkëshortes së subjektit, vjen në kundërshtim me çdo logjikë ekonomike, edhe pa marrë në konsideratë faktin që ai pretendohet të ketë marrë hua për ta blerë apartamentin, sikurse arsyetohet në vijim. Po ashtu, nuk ekziston asnjë lidhje e pretenduar apo dokumentuar gjinore mes vjehrit të subjektit dhe shoqërisë ndërtuese, e cila pretendohet ta ketë shitur apartamentin edhe nën koston e ndërtimit, me humbje. Lidhjet gjinore ndërmjet të shitësit/kushëririt të bashkëshortes dhe subjektit do të përbënin një shpjegim alogjik në rrethanat konkrete, kur jo vetëm shitësi rezulton me humbje, ka marrë hua për ta blerë apartamentin, por edhe ia lë subjektit ta përdorë atë për kohë të gjatë pa asnjë përfitim, ndërsa i duhej të shlyente huan e marrë.

18.14. Në këtë aspekt, edhe pretendimi i subjektit se çmimi i shitblerjes është kushtëzuar nga amortizimi i banesës është alogjik, jo vetëm për faktin se pasuria e paluajtshme nuk mund të pësojë amortizime në një hark të shkurtër kohor prej 6 vitesh [2004-2010], por edhe sepse çdo rrethanë e lidhur me këtë apartament duket se ka përfitues vetëm subjektin, i cili e përdor apartamentin dhe përfundimisht e blen më pak sesa ka shpenzuar blerësi, dhe në vlera të konsiderueshme nën vlerën e tregut, i cili, nga sa është referuar më sipër, ka pësuar rritje në periudhën kohore 2004-2010. Për sa më sipër, edhe pretendimet e subjektit, për të mos iu referuar çmimeve e kostove të referencës së Entit Kombëtar të Banesave, u vlerësuan të pabazuara e alogjike.

18.15. Së fundmi, edhe analiza financiare e kryer në Kolegj, për të verifikuar mundësinë e blerësve për të krijuar këtë pasuri, konfirmon konkluzionin e Komisionit. Qoftë vjehri i subjektit, ashtu edhe shitësi i dytë, kushëriri i bashkëshortes së subjektit, z. L., janë në pamundësi financiare për

³⁴ Në bazë të Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 04.03.2004.

³⁵ Në bazë të Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 07.09.2006, 27.548 lekë/m², për sipërfaqe shfrytëzimi dhe 24.113 lekë/m², për sipërfaqe ndërtimi.

të përballuar këtë investim, edhe duke përlllogaritur vlerën sipas kontratave të shitblerjes. Sikurse është theksuar më sipër, kjo analizë nuk u krye për shkak se këta dy individë u cilësuan persona të tjerë të lidhur³⁶. Komisioni nuk ka lënë asnjë vend në arsyetim dhe asnjë ekuivok për këtë arsye. Ky konstatim nënvizohet për t'i dhënë përgjigje pretendimit të subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka vepruar në tejkalim të parashikimeve ligjore për procesin e rivlerësimit, duke i kualifikuar prindërit e bashkëshortes si persona të tjerë të lidhur. Ashtu siç del qartë, ndër të tjerë, nga paragrafi 69 i vendimit të Komisionit, analiza financiare e kryer për vjehrrin dhe kushëririn e bashkëshortes së subjektit, është vetëm një *ndër disa* elemente të cilët janë marrë në konsideratë e që kanë passjellë konkluzionin se veprimet e kryera përpara vitit 2010 për apartamentin objekt analize ishin fiktive.

18.16. Nga analiza e kryer në vijim të qëndrimit të mësipërm, trupi gjykues i Kolegjit thekson se në kushtet që vjehri i subjektit ka rezultuar me pamundësi financiare për blerjen e apartamentit në Tiranë në datën 17.09.1999 [trajtuar në vijim], shtrirja e kontrollit financiar për periudhën pararendëse do të ishte pa relevancë. Në Kolegj u konfirmua konkluzioni i Komisionit se vjehri i subjektit ishte në pamundësi për të krijuar pasurinë objekt analize me burime të ligjshme në vitin 2002³⁷ për shkak të një balance negative prej thujse gjithë vlerën e apartamentit. Trupi gjykues i Kolegjit e gjen të bazuar konkluzionin e Komisionit për të mos përfshirë të ardhura hipotetike të vjehrrit, nga ushtrimi i aktivitetit privat në transportin e mallrave, për periudhën për të cilën ai nuk ka paraqitur dokumentacion provues. Aktet e administruara nuk ofrojnë mundësi përlllogaritjesh përtej atyre që ka përfshirë Komisioni. Konkretisht, për llogaritjen e të ardhurave hipotetike të vjehrrit për periudhën 1993 – 1996, për aq sa ishte e mundur, Komisioni është bazuar në mandate të pagesave e fletë njoftime të detyrimeve tatimore, depozituar nga subjekti. Në kushtet që edhe vetë subjekti nuk deklaroi nivelin [qoftë të përafërt] të të ardhurave që mund të ketë realizuar vjehri nga aktiviteti privat, përjashtohet edhe teorikisht që këto të ardhura të përmbushin kriterin e ligjshmërisë, kërkuar nga pika 3 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Edhe kërkesa e subjektit për të llogaritur shpenzimet e jetesës së familjes së vjehrrit në masën 30% të të ardhurave është e pakuptimtë, pasi ky standard është përdorur nga Kolegji vetëm për pagat e gjyqtarëve e prokurorëve dhe, gjithsesi, nuk do të përmbyste rezultatin.

18.17. Subjekti ka pretenduar se kushëririn e bashkëshortes ka marrë hua të gjithë vlerën për të blerë apartamentin, nga një person i tretë³⁸, dhe e ka shitur me ngut në vitin 2010 për të shlyer huan. Veprimet pretendohet të jenë kryer në *cash* e, si pasojë, nuk kanë lënë asnjë gjurmë. Mbi bazën e këtyre fakteve, Komisioni e ka parë të panevojshme të kryente një analizë financiare dhe i ka vlerësuar rrethanat e pretenduara si një ndër aspektet që *nënvizojnë* natyrën fiktive të veprimeve të kryera. Trupi gjykues i Kolegjit e gjen të bazuar konkluzionin e Komisionit. Skenari i pretenduar të ketë ndodhur është alogjik nga këndvështrimi i thjeshtë, sikurse edhe ai financiar. Sikurse përmendur edhe më sipër në këtë vendim, jo vetëm që subjekti nuk provoi asnjë arsye jetësore që

³⁶ Shih vendimet: nr. 33/2023, pikat 20-24; nr. 4/2021, pikat 146-147; nr. 21/2020 pikat 74-75, etj.

³⁷ Paga e plotë sipas mandatarkëtimit të datës 22.11.2002, lëshuar nga shoqëria “{***}” ShPK, është kryer në 22.11.2002. Sipas analizës së kryer nga Komisioni, balanca negative e burimeve të ligjshme të disponuara nga vjehri i subjektit në nëntor 2002, kur është paguar apartamenti, rezulton në vlerën (-) 2.926.824 lekë.

³⁸ Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka sjellë deklaratat noteriale të z. E. L. dhe huadhënësit të tij, Th. V., datë 15.06.2021, që konfirmojnë marrjen e huas në vitin 2006. Z. L. ka dhënë të njëjtën deklaratë edhe në dhjetor 2019.

do të detyronte kushëririn e bashkëshortes së tij për të kryer këtë investim, por argumentohet se ai mori edhe hua, me humbje, për të blerë një pasuri të cilën ia la në përdorim subjektit, pa asnjë përfitim financiar, për më së paku tre nga katër vitet që ajo ishte në pronësi të tij. Këto elemente të transaksionit të përshkruar, së bashku me mungesën e interesit të tij – referuar më sipër – për fatin e apartamentit, analizuar në kontekstin e prokurës së përfaqësimit që ka për fokus humbjen e pronësisë dhe jo shitjen me më së paku një çmim që do të mundësonte kthimin e vlerës së plotë të huas – janë një sërë aspektesh që qartazi dëshmojnë për fiktivitetin e veprimeve të analizuara, në favor të subjektit.

18.18. Së fundmi, pas kontrollit të ushtruar në Kolegj, mbi analizën financiare të Komisionit, në funksion të shkaqeve të ankimit, subjekti i rivlerësimit rezultoi me *mundësi* të burimeve financiare të ligjshme për kryerjen e pagesës prej 2.000.000 lekësh³⁹ në datën 26.02.2010, për blerjen e apartamentit objekt vlerësimi. Ndryshe nga Komisioni, në analizën e kryer në Kolegj, shuma prej rreth 20.000 USD, e dërguar nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit së motrës në qershor 2007, nuk u përllogarit në ngarkim të ekonomisë familjare të subjektit e personit të lidhur për shkak të disa rrethanave faktike që rezultojnë nga aktet. Konkretisht, nga analiza kronologjike e veprimeve që rezultuan të besueshme nga aktet, u vlerësuan bindëse pretendimet e subjektit se ato përbëjnë fonde të cilat nuk i përkasin atij dhe personit të lidhur/bashkëshortes.

18.19. Në analizën e burimeve të deklaruara për krijimin e pasurisë, trupi gjykues nuk përfshiu dhurimin nga vëllai i subjektit, të ardhurat e të cilit mbetën në nivel deklarativ, pasi nuk u provuan me dokumentacion. Pretendimet për pamundësi objektive, sipas përcaktimeve të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, u vlerësuan të pabazuara në ligj e në fakte në kushtet që dokumentacioni për punësimin e vëllait jashtë Shqipërisë nuk ka ekzistuar ndonjëherë⁴⁰ dhe subjekti nuk provoi as dërgesat e vlerave monetare për periudhën 1991-1999, gjatë së cilës pretendohet të jenë dhuruar shumat e ndryshme. Përpos sa sipër, subjekti ka deklaruar gjatë hetimit administrativ⁴¹ se shpenzimet e jetesës familjare janë përballuar, ndër të tjera, edhe nga ndihma financiare nga i vëllai gjatë viteve 1991-1997. Me fjalë të tjera, edhe nëse do të pranohej ky kontribut nga i vëllai, subjekti e ka deklaruar atë si ndihmesë për shpenzimet e jetesës dhe jo si kursim për të blerë apartamentin.

18.20. Në sintezë të sa më lartarsyetuar dhe në kushtet që kjo pasuri ishte formalizuar si pronë e subjektit dhe personit të lidhur e është deklaruar si e tillë në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, trupi gjykues i Kolegjit, ndryshe nga Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të rremë për këtë pasuri, lidhur me *momentin e krijimit*, në kuptim të gërmës “ç” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Veprimet e përsëritura të kryera nga subjekti i rivlerësimit, duke e formalizuar marrëdhënien e pronësisë me pasurinë, pas disa

³⁹ Diferenca prej 1 milion lekësh, ishte me burim huan e marrë nga E. P..

⁴⁰ Në deklaratën noteriale datë 20.11.2016, personi tjetër i lidhur me subjektin/dhuruari H. M. [vëllai i subjektit] pranon se të ardhurat e dhuruara janë të pa dokumentuara e të padeklaruara, për shkak se për një periudhë kohe ka qenë emigrant pa dokumentacion punësimi e leje qëndrimi deri në vitin 1996 në Itali. Për të provuar punësimin e të vëllait, subjekti ka depozituar vetëm një deklaratë të datës 14.01.2020, nga një individ në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të kompanisë {***} SPA. Sipas kësaj deklarate, vëllai i subjektit është punësuar nga kjo kompani prej datës 25.10.2004, pas periudhës 1991-1999, në të cilën daton shuma e deklaruar dhurim.

⁴¹ Përgjigjet e pyetësorit nr. 1.

vitesh që gëzonte frytet e saj dhe vetëm pas disa transaksioneve të mëparshme formale në emër të familjarëve të bashkëshortes, trupi gjykues i vlerësoi në dritën e cenimit të besimit të publikut, parashikuar nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

*B.2.2. Apartament banimi në pronësi të vjehrrit të subjektit, në rrugën “{***}”, Tiranë*

19. Në vendimin objekt shqyrtimi është arsyetuar se familja e vjehrrit të subjektit të rivlerësimit ka pasur pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare në shumën (-) 921.389 lekë, për blerjen e pasurisë në fjalë. Ky konkluzion, ndonëse nuk e ngarkon me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit, është mbajtur në vëmendje nga Komisioni për një vlerësim të përgjithshëm, në vazhden e elementëve të konstatuar për apartamentin në Elbasan, meqenëse vjehrrin e subjektit ka rezultuar me mungesë të mjeteve monetare me burim të ligjshëm dhe më herët kishte blerë apartamentin në Tiranë ku ka jetuar edhe subjekti i rivlerësimit.

19.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton këtë konkluzion, sipas pretendimeve të përmbledhura në pikën 9 të këtij vendimi.

19.2. Nga kontrolli i vendimit dhe nga aktet e administruara në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit fillimisht sjell në vëmendje faktin që vjehrrin e subjektit nuk është kualifikuar si person tjetër i lidhur me subjektin dhe as hetuar si i tillë. Sikurse arsyetuar më lart, shtrirja e hetimit administrativ edhe mbi këtë pasuri e mjaftueshmërinë e burimeve financiare të vjehrrit të subjektit, është kryer në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit, në funksion të identifikimit të pasurive të fshehura ose përjashtimit të çdo dyshimi në rast të kundërt, në përputhje me qëllimin e shprehur në pikën 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. *Së dyti*, edhe në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, mungesa e burimeve të ligjshme financiare të familjes së vjehrrit për blerjen e apartamentit në Elbasan në vitin 2002 është rrjedhojë logjike dhe ekonomike në kushtet që e njëjta familje tre vite më herët/në vitin 1999, rezultoi me mungesë burimesh edhe për blerjen e apartamentit në Tiranë.

19.3. Për sa më sipër dhe përkundër sa pretendon subjekti në ankim, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se konkluzioni për mungesën e burimeve të vjehrrit për këtë pasuri ka qenë një ndër aspektet e marra në konsideratë nga Komisioni, si pjesë dhe në funksion të analizës shteruese të rrethanave faktike të pretenduara nga subjekti. Me fjalë të tjera, mungesa e burimeve të ligjshme të konstatuara për vjehrrin e subjektit për krijimin e kësaj pasurie është pjesë e panoramës së aspekteve që kanë bindur Komisionin për mungesë besueshmërie të dinamikës së krijimit të pasurisë në Elbasan. Ky konstatim rezultoi i qartë nga përmbajtja e paragrafit 116 të vendimit të Komisionit, i cili shprehet se pamjaftueshmëria e burimeve të ligjshme financiare për krijimin e apartamentit në Tiranë nga vjehrrin është vlerësuar e pamjaftueshme për të ngritur dyshime mbi pasurinë në fjalë dhe si i tillë nuk ka sjellë pasojë për subjektin. Për sa më sipër argumentuar, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimet e subjektit në ankim, në drejtim të konstatimeve për këtë pasuri, janë pa peshë përcaktuese e nuk iu nënshtruan analizës në Kolegji.

B.2.3. Analiza financiare

20. Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të mjaftueshme, sipas përcaktimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për të kryer të gjitha

investimet e konstatuara dhe për të përballuar njëkohësisht, shpenzimet dhe realizuar kursimet e deklaruara. Për periudhën 2003-2016, ka rezultuar përfundimisht një bilanc i përgjithshëm negativ në masën (-) 3.396.728 lekë, i cili u çmua nga Komisioni si shkak për aplikimin e pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

20.1. Subjekti i rivlerësimit konteston metodologjinë dhe rezultatin e analizës financiare të Komisionit, duke potencuar në mënyrë të përmbledhur se ajo (analiza financiare) është produkt i vlerësimit të gabuar në lidhje me disa çështje. Konkretisht, subjekti konteston përlllogaritjen e: (i) likuiditeteve gjendje *cash*; (ii) të ardhurave familjare; (iii) shpenzimeve të jetesës; (iv) mundësisë së krijimit të kursimeve; (v) të ardhurave të dhuruara nga i vëllai; (vi) veprimet financiare të kryera në vitin 2007 lidhur me shumën 20.000 USD (analizuar më sipër). Subjekti argumenton se analiza financiare do të rezultonte me bilancin e përgjithshëm negativ në një vlerë më të vogël, e cila nën dritën e parimit të proporcionalitetit, nuk duhet ta penalizojë subjektin në formën e deklarimit të pamjaftueshëm.

20.2. Nga korrektimi i analizës financiare të Komisionit, kryer në Kolegj në funksion të shkaqeve të ankimit, subjekti i rivlerësimit rezultoi me një balancë negative të burimeve të ligjshme prej (-) 2.207.908 lekësh. Kjo balancë, e cila mban në konsideratë disa nga pretendimet e subjektit, ndonëse është më e ulët, nuk përmbys rezultatin e mbërritur nga Komisioni, pasi edhe e vetme nuk mund të konsiderohet në kufijtë e proporcionalitetit. Për rrjedhojë, subjekti gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Po ashtu, duke mbajtur në konsideratë edhe arsyetimin e mësipërm për deklarimin e rremë për mënyrën e momentin e krijimit të apartamentit në Elbasan, subjekti rezultoi i pabesueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë. Ky vlerësim u bazua në konkluzionet e mbërritura pas shqyrtimit të pretendimeve lidhur me analizën financiare të ngritura në ankim e parashtrime, shtjelluar në vijim.

20.3. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ndryshimet në gjendjen e likuiditeteve *cash* të pasqyruara nga Komisioni në analizë, nuk janë në përputhje me deklaratimet e tij në deklaratat periodike për periudhën 2006-2015. Nga kontrolli në Kolegj, u konstatua se diferencat e pretenduara në ndryshimet e kursimeve *cash* rezultojnë për shkak të përfshirjes në llogaritje nga subjekti edhe të balancave të llogarive bankare në fund të çdo viti paraardhës. Me fjalë të tjera, ndonëse subjekti nuk i ka deklaruar/konsideruar si shtesa këto balanca, ai i ka përfshirë ato në llogaritjen e gjendjeve *cash* në fund të çdo viti. Trupi gjykues konstaton se Komisioni ka llogaritur saktë ndryshimet në likuiditetet *cash*, referuar gjendjeve *cash* të deklaruara nga subjekti për çdo vit në deklaratat periodike. Për rrjedhojë, ky pretendim është i pabazuar.

20.4. Për sa i përket të ardhurave familjare, subjekti kërkon të përfshihen në mesin e burimeve të ligjshme të ardhurat nga pensioni i nënës për vitet 2006, 2008 e 2009, të ardhurat nga mësimdhënia prej tij në një institucion arsimor privat në vitin 2011 dhe për vitin 2016, të ardhurat e bashkëshortes nga aktiviteti privat si avokate. Të ardhurat nga pensioni i nënës, si ato të bashkëshortes nga avokatia rezultojnë të jenë përfshirë në analizën e Komisionit. Madje, për pensionin e nënës, Komisioni ka përlllogaritur vlerat që referohen në shkresën zyrtare të ISSh-së, që mban datën 10.11.2016, dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI, bashkëlidhur deklaratës së pasurisë

vetting. Këto të ardhura janë më të larta⁴² se ato të pretenduara nga subjekti, çka përmirëson situatën e tij financiare. Për këtë arsye, edhe ky zë i analizës financiare nuk iu nënshtrua korrektimit pasi pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar. Pretendimi tjetër për analizën financiare të vitit 2016, është po ashtu i pabazuar. Komisioni i ka përfshirë në analizë të ardhurat e bashkëshortes nga pagat nga avokatia në vlerën 548.048 lekë. Në këto kushte, pretendimi për këto dy zëra rezulton i ngritur pa shkak.

20.5. Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se është i drejtë qëndrimi i Komisionit për të mos përfshirë në mesin e të ardhurave të ligjshme shumë në vlerën 155.250 lekë të deklaruar prej tij në deklaratën e vitit 2011 nga mësimdhënia si pedagog i jashtëm pranë Universitetit Amerikan të Tiranës, filiali Elbasan. Në kushtet që aktet e sjella prej tij⁴³ janë deklarative në çdo këndvështrim të mundshëm, pasi përpos deklaratës periodike vjetore mungon çdo kryqëzim i tyre në një akt tjetër zyrtar të kohës, përfitimi i kësaj shume nuk është provuar as në nivelin sasior të ekzistencës. Ky fakt, përjashton edhe diskutimin për ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

20.6. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit për shpenzimet e jetesës fokusohen në kërkesën për zbritjen e disa zërave nga standardi i përvitshëm sipas INSTAT, me argumentin se disa prej tyre janë përllogaritur në një formë tjetër, duke i pakësuar me vlerën respektive që ato zënë në shportën e shpenzimeve të jetesës, si pjesë e buxhetit familjar. Konkretisht, subjekti kërkon të mos përfshihen në analizën e tij financiare: (i) shpenzimet e jetesës për nënën për ato periudha kohore që ka jetuar me vëllanë e subjektit; (ii) shpenzimet për fëmijët, të cilat mbuloheshin nga shkollat përkatëse; (iii) shpenzimet e transportit të subjektit për periudhën kur ai mbante funksionin si Kryetar i Gjykatës Elbasan; (iv) shpenzime telefonie; dhe (v) shpenzimet e jetesës për periudhat kur ai dhe pjesëtarët e tjerë të familjes kanë qenë jashtë Shqipërisë.

20.7. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimi se shpenzimet për shërbimet televizive janë llogaritur dy herë si shpenzim, është i pabazuar. Në strukturën e buxhetit të familjes referuar nga INSTAT, shpenzimi për këtë shërbim nuk është grup më vete. Për më tepër, konsideruar vlerën 100 lekë në muaj për abonent, përfshirë në faturën për furnizimin me energji elektrike, ky zë do të ishte pa efekt në rezultatin financiar. Në lidhje me pretendimin e subjektit se shpenzimet për furnizimin me energji elektrike dhe ujë të pijshëm duheshin llogaritur sipas situatës faktike, trupi gjykues sjell në vëmendje se të dhënat e INSTAT-it të përdorura nga Komisioni për shpenzimet jetike, referojnë vlera minimale. Në rastin e subjektit, jo gjithmonë këto shpenzime mund të llogariteshin sipas situatës faktike duke qenë se për periudha të caktuara, sipas deklarimeve, nëna

⁴² Përkatësisht, në vlerat 104.300 lekë, 130.110 lekë dhe 142.908 lekë, llogaritur sipas vërtetimit të ISSh-së nr. {***} prot., datë 10.11.2016.

⁴³ Subjekti ka paraqitur në ILDKPKI dhe Komision një kërkesë të tij (datë 21.10.2016), drejtuar këtij institucioni arsimor, për informacion për të ardhurat neto të përfutuara prej tij për periudhën dhjetor 2010 - gusht 2011, si pedagog i jashtëm, ekstraktin në të cilën kjo shoqëri rezulton me status "aktiv", vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 539/2014, për heqjen e licencës së këtij universiteti së bashku me disa institucioneve të tjera private të arsimit të lartë, si dhe deklaratën personale të koordinatores së degës juridike në këtë universitet, datë 20.01.2020, e cila konfirmon deklarinimin e subjektit dhe që pagesa është kryer në cash nga zyra e financës në vlerat 96.750 lekë dhe 58.500 lekë (total 155.250 lekë).

e subjektit ka jetuar në banesën e vëllait të tij, ndërsa ai vetë dhe familja kanë jetuar në banesën e vjehrrit.

20.8. Trupi gjykues i Kolegjit, po ashtu, e gjen të drejtë qëndrimin e Komisionit, që në mungesë të dokumentacionit i është referuar të dhënave të INSTAT-it, që referojnë një nivel minimal në kufirin e mbijetesës. Për këtë arsye, vlerësohet e pakuptimtë përpos edhe e pabazuar kërkesa e subjektit për llogaritjen e shpenzimeve për konsum në masën 30 % të të ardhurave familjare edhe për vitet për të cilat INSTAT ka të dhëna referuese për shpenzime jetese të cilat, sikurse është elaboruar gjerësisht në vendime të mëparshme të Kolegjit, janë emëruesi i përbashkët i gjithë fashave demografike që jetojnë në Shqipëri, pavarësisht nga niveli i pagave, aftësia për punë, mosha e tregues të tjerë me impakt social ekonomik. Ky ka qenë edhe qëndrimi orientues i Kolegjit⁴⁴ për periudhën kohore përpara vitit 1999 për të përlllogaritur shpenzimet në 30% të të ardhurave për gjyqtarët e prokurorët për shkak të pagave të tyre, në mungesën e një standardi të përpiluar nga INSTAT për atë periudhë. Pretendimi se gjatë plotësimit të deklaratave periodike vjetore, subjekti nuk ka pasur mundësi objektive për t'iu referuar të dhënave të INSTAT-it, lidhur me shpenzimet për konsum për vitin paraardhës, të cilat publikoheshin pas mbarimit të afatit të deklaratimit, vlerësohet i pabazuar në ligjin nr. 9049/2003, i cili i ngarkon subjektet për të deklaruar shpenzimet mbi kufirin e përcaktuar në ligj, sipas gjendjes faktike të kryerjes së tyre dhe jo në vlera hipotetike të bazuara në të dhëna statistikore të publikuara nga institucionet. Këtyre të fundit u referohen vetëm organet e rivlerësimit në rastet e mungesës të dokumentacionit ligjor.

20.9. Nga kontrolli i analizës financiare, vërehet se në analizën e kryer për mundësinë e krijimit të kursimeve të familjes së subjektit për periudhën maj 1998 – korrik 2000, Komisioni ka llogaritur shpenzimet jetike me 5.000 lekë/person në muaj për periudhën maj 1998 – dhjetor 1999. Nëse shpenzimet për konsum për këtë periudhë do të ishin llogaritur në masën 30 % të të ardhurave të subjektit dhe 66 % të të ardhurave të nënës, atëherë ato do të rezultonin vetëm 4.585 lekë më të ulëta krahasuar me vlerën e Komisionit. Por duke mbajtur në konsideratë faktin se sipas kësaj analize subjekti ka rezultuar me mundësi financiare me burime të ligjshme, kjo diferencë nuk ka asnjë efekt në rezultat. Nga ana tjetër, kërkesa e subjektit për të zbritur shpenzime jetike për nënën për disa periudha kohore të caktuara me pretendimin se ajo ka jetuar me njërin prej vëllezërve, rezulton e pabazuar. Ky kërkim bie ndesh me argumentet e parashtruara nga subjekti për përfshirjen e të ardhurave të nënës nga pensioni në mesin e të ardhurave familjare, referuar pretendimit të tij në vazhdimësi⁴⁵ që nëna ka jetuar me të, por edhe sipas deklaratës noteriale të vëllait të subjektit, sjellë gjatë hetimit administrativ⁴⁶ në të cilën ai (z. A. M.) shprehet se shpenzimet e jetesës për nënën janë mbuluar nga të ardhurat që ajo kishte me subjektin e rivlerësimit. Për këto arsye, kërkesa e subjektit për të ulur shpenzimet jetike për një person për periudhat dhjetor 1997 – gusht 2007 dhe 01.10.2013 - 01.10.2014, duke zgjedhur harqe kohore të caktuara, nuk u mor në konsideratë.

⁴⁴ Vendimi (JR) nr. 15, datë 18.06.2021, pika nr. 21.39 - 21.42.

⁴⁵ Me përgjigjen e pyetjes nr. 2, të pyetësorit nr. 1, ku subjekti ka deklaruar se shpenzimet e jetesës janë përballuar nga të ardhurat e tij dhe të nënës, me shkaqet e ankimit subjekti ka kërkuar që në mesin e të ardhurave të familjes së tij të përfshihet pensioni i nënës, dhe së fundmi, me deklaratën vetting ku ai përfshin në mesin e të ardhurave edhe pensionin e nënës.

⁴⁶ Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.03.2020.

20.10. Edhe kërkesa për reduktimin e shpenzimeve të jetesës për periudhat gjatë të cilave fëmijët kanë ndjekur shkollën në institucione arsimore private, ka mbetur në nivel deklarativ për periudhën shtator 2007 – qershor 2014. Subjekti nuk depozitoi kontrata dhe akte të tjera dokumentare mbështetëse nëpërmjet të cilave të provohej lloji i shërbimeve të mbuluara dhe vlerat përkatëse të tyre. Për periudhën shtator 2014 – qershor 2018, referuar kontratave që i përkasin periudhës së rivlerësimit deri në dhjetor 2016⁴⁷ rezultoi se në tarifë përfshihet arsimimi i fëmijëve dhe dy vakte ushqimore por jo uniforma shkollore. Nga ana tjetër, anketa e buxhetit të familjes së INSTAT nuk specifikon përqindjen që i takon shpenzimeve për ushqim, kundrejt ndarjes në vakte apo pijet alkoolike. Mbi të gjitha, në kushtet që të dhënat e INSTAT-it të përdorura në analizë, referojnë shpenzime minimale në kufijtë e mbijetesës, ky pretendim nuk mund të merret në konsideratë.

20.11. Nga korrektimi i kryer në Kolegj mbi analizën e Komisionit për shpenzimet e transportit për periudhën 2001-2006, efekti financiar zbutet krahasimisht me rezultatin e Komisionit duke filluar nga viti 2003⁴⁸. Ndërsa trupi gjykues vëren se subjekti nuk ka sjellë akte ligjore e nënligjore të kohës për të ilustruar cilat shpenzime transporti mbuloheshin nga buxheti i shtetit gjatë kohës që ai kryente funksionin e Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, efekti financiar është *pa peshë* në kushtet që subjekti nuk rezultoi të ketë mungesë burimesh për këtë periudhë. Për sa i përket viteve 2013 e 2014, trupi gjykues e gjen të saktë analizën financiare të kryer nga Komisioni për periudhën kur subjekti ka pretenduar se ka lënë shtëpinë e tij me qira dhe jetonte tek vjehri në Tiranë. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit për të zbritur shpenzimet e transportit me argumentin se ato janë përfshirë në anketën e buxhetit të familjes, sipas INSTAT apo që janë brenda limitit të shpenzimeve për transport familjar, është i pabazuar. Komisioni ka përfshirë edhe zërin “Shpenzime transporti”, duke nënkuptuar shpenzimet që mund të ketë pasur subjekti për transportin e nevojshëm nga Tirana në Elbasan dhe anasjelltas sipas metodologjisë së Kolegjit⁴⁹ për udhëtimet bazuar në çmimin mesatar mujor të naftës për litër (në euro)⁵⁰. Nga ana tjetër, Komisioni nuk rezultoi të ketë përfshirë shpenzime transporti për fëmijët e subjektit për periudhën kur kanë jetuar në Elbasan dhe ndjekur shkollën në Tiranë. Së fundmi, edhe pretendimi për zbritje shpenzimesh telefonie është pa shkak, pasi ky zë nuk rezultoi të jetë pjesë e analizës financiare të Komisionit.

20.12. Komisioni ka përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme të disponuara nga subjekti në vitin 2011, ndër të tjera, edhe dëmshpërblimin e përfituar nga shoqëria e sigurimit “{***}”, sipas çekut të paraqitur nga subjekti. Ai kërkon që shuma 160.000 lekë e përfituar nga shoqëria e sigurimit “{***}” të përlogaritet vetëm si e ardhur dhe jo si shpenzim. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se dëmshpërblimi për kompensimin e dëmit të shkaktuar automjetit nga aksidenti si rregull,

⁴⁷ Me përgjigjet e pyetësorit nr. 1, subjekti ka depozituar tri marrëveshje për shkollimin e secilit prej djemve, nga të cilat dy i përkasin periudhës deri në fund të vitit 2016. Prej tyre, rezultoi se tarifa arsimore përfshin fillimisht edhe një vakt e më pas dy vakte.

⁴⁸ Sipas llogaritjes në Kolegj, shpenzimet për transport për periudhën 2003 – 2006, rezultojnë 84.000 lekë në vit, kundrejt vlerës 96.000 lekë në vit të llogaritura nga Komisioni.

⁴⁹ Referuar transportit me automjet personal ose në përdorim, për distancën Tiranë – Elbasan prej 39.8 km, duke konsideruar konsumin për karburant 7 litra/100 km, sipas çmimit mesatar, për periudhën tetor – dhjetor 2013 referuar çmimit mesatar për këto muaj dhe për periudhën janar – shtator 2014 referuar mesatares së çmimeve të këtyre muajve.

⁵⁰ Burimi: <https://ec.europa.eu/energy/en/data-analysis/weekly-oil-bulletin>.

shoqërohet me shpenzime për riparimin e dëmit të shkaktuar. Në kushtet që subjekti nuk rezultoi ta ketë nxjerrë mjetin nga qarkullimi, ky pretendim gjendet i pabazuar edhe për faktin se subjekti nuk ka deklaruar atë si burim për krijimin e kursimeve *cash*. Pavarësisht nga ky konstatim, nën dritën e garancive procedurale me ankimin, trupi gjykues çmon të mos ndalet më tej në këtë zë financiar të vitit 2011.

20.13. Pretendimi i subjektit se Komisioni nuk ka sqaruar metodologjinë e përdorur për llogaritjen e shpenzimeve të udhëtimeve jashtë vendit, është i pabazuar. Në rezultatet e hetimit vërehet se, Komisioni ka sqaruar se shpenzimet e udhëtimit të subjektit të rivlerësimit dhe anëtarëve të familjes, janë përllogaritur duke u bazuar në raportin e hyrje-daljeve sipas bazës elektronike të të dhënave të Policisë Kufitare (*TIMS*), në standardin e Kolegjit⁵¹ dhe në deklaratimet e vetë subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorëve. Subjekti i rivlerësimit pretendon se, Komisioni nuk duhet t'i referohej jurisprudencës së Kolegjit lidhur me llogaritjen e shpenzimeve të udhëtimeve, në kushtet që ai ka paraqitur bileta të cilat pasqyrojnë vlerën e saktë të transportit ose paketës turistike të disa prej udhëtimeve. Nga analizimi i dokumentacionit të administruar, vërehet se pjesa më e madhe e tij janë karta imbarkimi (*bording pass*) dhe rezervime, të cilat nuk përmbajnë të dhëna për çmimet e biletave të transportit, si disa fatura për pagesën e komisioneve shtesë për ndryshime në rezervimet e udhëtimeve. Nga kontrolli i kryer në Kolegj, rezultoi se Komisioni ka llogaritur saktë shpenzimet e transportit për udhëtimet e pretenduara nga subjekti⁵².

20.14. Pretendimi i subjektit lidhur me llogaritjen e ditëve të qëndrimit jashtë vendit, u vlerësua nga trupi gjykues i Kolegjit si i bazuar. Pas korrektimit të këtij shpenzimi në analizë, efekti financiar për udhëtimet e tetorit 2005 dhe shtatorit 2010 ishte pa peshë, pasi këto vite kanë rezultuar me bilanc pozitiv ndërsa korrigjimi i muajve maj dhe nëntor 2007 çoi në zvogëlimin e shpenzimeve me 12.091 lekë. Pretendimi i subjektit që shpenzimet për udhëtimet ditore të llogariten në raport me orët e qëndrimit jashtë vendit, u vlerësua i pabazuar pasi për këtë aspekt tashmë Kolegji ka jurisprudencë të elaboruar e konsoliduar ndër vite. Në një qëndrim garantist, ato mund të llogariten 25 euro/dita. Për sa i përket udhëtimeve të nënës së subjektit në Itali, Komisioni i ka ngarkuar vitit 2011, shpenzimet e udhëtimit prej 275 eurosh në total për të gjithë periudhën e qëndrimit, duke mos i shpërndarë ato sipas ditëve që i përkasin secilit vit (14 ditë në 2011 dhe 21 në 2012). Edhe në rastin kur këto shpenzime nuk do t'i ngarkoheshin familjes së subjektit, bilanci negativ për vitin 2011 megjithëse zvogëlohet, përsëri nuk shërohet, duke pasur kështu efekt minimal mbi zbutjen e rezultatit negativ për periudhën e rivlerësimit. Në lidhje me udhëtimin e bashkëshortes dhe djalit në Greqi, gjatë periudhës 23.08.2013-01.09.2013, pavarësisht

⁵¹ Në vendimin (JR) nr. 11/2019 (JR), datë 22.05.2019, pika 27.7.

⁵² Aktet e administruara janë si vijon: bileta avioni, Tiranë - Athinë, datë 13.09.2006, me pasagjerë subjekti dhe i biri përkatësisht në çmimet 132 euro dhe 117 euro. Në llogaritjen e shpenzimeve të këtij udhëtimi, Komisioni ka llogaritur si shpenzime transporti vlerën 90 euro/person, e cila rezultoi më e ulët se vlerat reale të biletave; faturë për biletë avioni, me destinacion Rusinë, 14.09.2007-25.09.2007, pasagjere bashkëshortja e subjektit. Asnjë shpenzim i ngarkuar subjektit pasi është mbuluar nga të tretë (organizatorët dhe Bashkia Elbasan); biletë avioni, Tiranë - Athinë dhe kthim, 23.08.2013 - 01.09.2013, me pasagjerë bashkëshortja dhe djali, me çmimin në total 427.62 euro. Komisioni ka përfshirë këtë vlerë si shpenzim transporti në llogaritjen e shpenzimeve të këtij udhëtimi; biletë avioni, Tiranë - Mynih - New York dhe kthim, periudha 19.01.2015 - 11.08.2015, me pasagjere bashkëshortja e subjektit, me çmim 630.84 euro. Komisioni ka llogaritur në total për të gjithë familjen, vlerën e transportit drejt ShBA-ve (300.000 lekë) dhe vlerën e transportit e qëndrimit në Republikën Domenikane (300.000 lekë), sipas deklaratimeve të subjektit.

destinacionit të përcaktuar në tabelën e llogaritjes së shpenzimeve të udhëtimeve, Komisioni ka llogaritur shpenzimet e qëndrimit për këtë periudhë 5 euro dita/person, duke pranuar kështu pretendimet e subjektit se bashkëshortja dhe djali i tyre kanë qëndruar te të afërm. Për këtë arsye, ky pretendim i subjektit është i pabazuar. Ndërsa për vitin 2016, i cili rezultoi me bilanc pozitiv, trupi gjykues e vlerësoi pa efekt financiar vlerën e pretenduar nga subjekti e si të tillë nuk e mori në analizë.

20.15. Pretendimi për të mos përfshirë në llogaritjen e shpenzimeve të jetesës së familjes së tij, periudhat kur ai vetë apo pjesëtarët e tjerë të familje kanë qenë jashtë Shqipërisë, u vlerësua i pabazuar pasi: (i) shpenzimet e jetesës sipas shkresës së ILDKPKI-së, referojnë vlera minimale; dhe (ii) nga shqyrtimi i akteve që administrohen në fashikullin e Komisionit, vërehet se periudhat e qëndrimit jashtë Shqipërisë variojnë nga disa orë në disa ditë. Edhe nëse hipotetikisht do të zbriteshin shpenzimet e jetesës për kohën që nëna e subjektit ka qëndruar për pesë javë në Itali (17.12.2011 – 21.1.2012) efekti do të ishte gjithsesi i papërfillshëm për të përmbysur balancën negative të rishikuar në Kolegj, referuar më sipër në paragrafin 20.2.

- 21.** *Së fundmi*, trupi gjykues i Kolegjit konstaton që është i drejtë konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për krijimin e kursimeve të deklaruar në deklaratën *vetting* në shumën 1.300.000 lekë. Edhe nëse në analizën e kryer nga Komisioni përmirësohen ata tregues për të cilët pretendimet e subjektit gjenden të bazuara, si dhe nëse korrigjohen shpenzimet e jetesës për periudhën 2009 – 2011, sipas periudhave të qëndrimit në ShBA të bashkëshortes dhe djalit, mundësia e subjektit për krijimin e likuiditeteve *cash* në vlerën 1.300.000 lekë, sërisht do të rezultonte me balancë negative. Po kështu, edhe vlerësimi i arsyetuar më lart, për të mos e konsideruar si shpenzim të familjes së subjektit, transfertën prej 20.024 USD të kryer në datën 07.06.2007 nga bashkëshortja e subjektit në favor të motrës së saj, rezultati për pamundësi financiare me burime të ligjshme për krijimin e kursimeve *cash* nuk do të ndryshonte. Përfshirja ose jo e kësaj vlere do të ndikonte në: (i) mundësinë e krijimit të likuiditeteve deri në fund të vitit 2014; (ii) mundësinë për krijimin e apartamentit në Elbasan; si dhe (iii) rezultatin e analizës së përgjithshme financiare 2003 – 2016.
- 22.** Në konkluzion të vlerësimit të kriterit të pasurisë, trupi gjykues i Kolegjit çmon se subjekti është i pabesueshëm. Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme, për të justifikuar kryerjen e investimeve, realizimin e kursimeve të deklaruar dhe njëkohësisht kryerjen e shpenzimeve ndër vite, është rrjedhojë e një konstatimi të drejtë të situatës faktike dhe në zbatim të ligjit. Këto rrethana e vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, me pasojë aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas parashikimeve në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. Ndërsa veprimet e kryera në lidhje me pasurinë apartament banimi të ndodhur në qytetin e Elbasanit, vlerësohet se nuk duhet të kualifikohen si fshehje e pasurisë, për sa kohë është formalizuar si pronë e subjektit dhe e personit të lidhur dhe është deklaruar si e tillë, në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting*. Ndryshe nga Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit, vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të rremë për këtë

pasuri, lidhur me momentin e krijimit, në kuptim të germës “ç”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

23. Në vlerësimin tërësor të procedurave, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues mbajti në konsideratë veprimet e përsëritura të kryera nga subjekti i rivlerësimit me apartamentin e banimit të ndodhur në qytetin e Elbasanit, të cilat i vlerësoi nën dritën e cenimit të besimit të publikut, sipas parashikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion mbajti në konsideratë sa është elaboruar gjerësisht më sipër, për veprime të kryera në mënyrë të përsëritur nga subjekti, me persona të rrethit familjar të bashkëshortes por jo vetëm, nëpërmjet të cilave ai ka arritur të fshehtë të vërtetën për një interes pasuror të krijuar prej tij vite përpara formalizimit të marrëdhënies së pronësisë. Këto veprime, të kryera në qytetin ku subjekti ushtronte detyrën e gjyqtarit dhe funksionin e Kryetarit të Gjykatës, u panë të ndërthurura me perceptimin e publikut për sistemin e drejtësisë, në aspektet që shtjellohen në vijim të këtij kriteri të rivlerësimit.

C. Lidhur me vlerësimin profesional dhe atë tërësor

24. Komisioni ka konkluduar se gjatë kontrollit të kriterit të figurës rezultuan përputhje midis informacioneve të klasifikuara dhe qasjeve procedurale të ndërthura me zgjidhjet substanciale të kryera nga subjekti në disa çështje gjyqësore. Bazuar në këto aspekte, Komisioni konkludoi se subjekti ka kryer veprime që kanë cenuar besimin e publikut, duke e bërë atë të papërshtatshëm për vijimin e detyrës. Në vlerësimin e kriterit profesional, Komisioni ka konkluduar për disa shkelje të cilat në konkurrencë me ato të evidentuara gjatë kontrollit të dy kriterëve të tjera, po ashtu shkojnë në drejtim të cenimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, me pasojë aplikimin e pikës 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Problematikat e konstatuara u çmuan të panevojshme t'i nënshtroheshin vlerësimit të mëtejshëm edhe në drejtim të nivelit kualifikues të aftësive profesionale në kuptim të nenit 59, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë ky aspekt vlerësimi rezultoi pa influencë mbi vendimmarrjen përfundimtare për vijueshmërinë ose jo të ushtrimit të detyrës.

24.1. Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar shkaqe ankimi që janë kontestim në tërësi i këtyre konkluzioneve të Komisionit duke potencuar në thelb se Komisioni ka kryer kualifikim të gabuar dhe me konsiderata të përgjithshme dhe se nuk rezulton që ai të ketë kryer deklaram të pasaktë për figurën. Ai pretendon se vendimi objekt ankimi nuk përcakton çështjet konkrete në të cilat kanë rezultuar të provuara konstatimet e Komisionit për përputhje midis informacioneve të klasifikuara të DSIK-së dhe vendimeve të marra prej tij. Ai argumenton se Komisioni ka vepruar në shkelje të parimeve për proces të rregullt pasi nuk i ka kaluar barrën e provës për kriterin e figurës dhe nuk e ka bërë me dije subjektin në mënyrë të qartë, se si informacioni i klasifikuar do të ndikonte në vlerësimin e kriterit të figurës. Sikurse referuar gjerësisht edhe në pjesën e këtij arsyetimi për qëndrimin e trupit gjykues për shkaqet e ankimit me natyrë procedurale, subjekti pretendon se cenimi i besimit tek publiku ka ardhur vetëm në vendimin përfundimtar, e përbën shkelje të së drejtës për proces të rregullt ligjor.

24.2. Për sa i përket vlerësimit profesional, subjekti shprehet se Komisioni, nuk ka arsyetuar shkaqet e shtrirjes së kontrollit jashtë periudhës së rivlerësimit me kufi vitin 2006, në kushtet që

janë marrë në shqyrtim dosje të gjykuara jashtë kësaj periudhe. Kontrolli i aftësive profesionale, bazohet në standarde të tjera e të ndryshme nga kriteri i figurës, argumenton ai. Duke përfshirë këto dy kriteret për të njëjtin fakt e shkak ligjor në të njëjtin proces, Komisioni ka aplikuar në fakt, një standard të dyfishtë që përbën penalizim të dyfishtë, joobjektiv dhe joproporcional.

24.3. Në shpjegimet e dhëna thuajse për të gjitha dosjet e ankimuar, subjekti pretendon në mënyrë të përsëritur se, Komisioni ka vlerësuar bindjen e brendshme të vendimmarrjes së magjistratit, që është detyrë e gjykatave më të larta, dhe përbën tejkalim të kompetencës së tij lëndore, në kundërshtim me nenin 179, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, nenin E, paragrafët 1 e 2 të Aneksit të Kushtetutës dhe në kundërshtim me vendimin nr. 15/2010 të Gjykatës Kushtetuese.

24.4. Vendimi i Komisionit është i paarsyetuar, sipas subjektit, pasi shkeljet e pretenduara janë të lidhura ngushtësisht me bindjen e brendshme të magjistratit dhe si të tilla nuk mund të shërbejnë si gjetje në këndvështrim të vlerësimit të figurës dhe të aftësive profesionale për secilën dosje objekt rivlerësimi në veçanti dhe për të gjithë kriterin e aftësive profesionale. Komisioni e ka ngarkuar me përgjegjësi për gjetje të marra nga relacioni i mbajtur nga Ministria e Drejtësisë në vitin 2009, në kuadër të procedimit disiplinor nisur ndaj subjektit në atë kohë, të gatshme dhe me të njëjtin mënyrë arsytimi. Këto gjetje nuk duhet të merrnin peshë në procesin e rivlerësimit, pasi Ministria e Drejtësisë nuk është një nga organet ndihmëse të procesit të rivlerësimit.

24.5. Pasi mori në analizë aktet në fashikull dhe pretendimet e subjektit nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit vëren se konkluzioni i Komisionit për kriterin e aftësive profesionale, është i bazuar. Subjekti i rivlerësimit me veprimet e tij ka cenuar besimin e publikut në një mënyrë që është i papërshtatshëm për të vijuar me ushtrimin e detyrës. Nga ana tjetër, mangësitë e vërejtura, tregojnë se subjekti paraqet problematika të cilat nuk mund të korrigjohen nëpërmjet trajnimit në Shkollën e Magjistraturës. Ky konkluzion mbështetet në konstatimet e shtjelluara në vijim.

C.1. Pretendimet për zbatimin e ligjit nga Komisioni

25. *Së pari*, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë që Komisioni nuk ka konkluduar se subjekti ka kryer deklaram të pamjaftueshëm të figurës, dhe as e ka ngarkuar atë me pasojë ligjore për këtë kriter vlerësimi sipas nenit 61, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Sikurse qartazi rezulton në vendim (paragrafi 120), në datën 11.02.2021, DSIK-ja ka konfirmuar konstatimin fillestar për *papërshtatshmëri*, në vijim të një raporti dhe informacioni shtesë, i cili referon implikim të subjektit të rivlerësimit në veprimtari korruptive të shfaqura edhe në formën e shpërdorimit të detyrës, në kohështrirje para dhe gjatë periudhës së rivlerësimit. Me këtë pikënisje si indicie, Komisioni ka analizuar tetë (8) dosje çështjesh gjyqësore dhe akte⁵³, në funksion të vlerësimit

⁵³ (i) dosja gjyqësore me nr. vendimi {***}, e vitit 2005, ndaj A. C.; (ii) dosja gjyqësore me nr. vendimi {***}, e vitit 2006 ndaj A. (T.) Q.; (iii) dosja gjyqësore me nr. vendimi {***}, datë 22.01.2008 ndaj S. Ç.; (iv) dosja gjyqësore me nr. vendimi {***}, datë 26.05.2004, ndaj D. T.; (v) dosja gjyqësore me nr. vendimi {***}, datë 13.05.2008, ndaj Zh. I.; (vi) dosje gjyqësore me të pandehur G. K. të vitit 2014, për të cilin rezultoi se nuk ka gjykim; (vii) çështja gjyqësore në ngarkim të E. M. dhe G. M., është në gjykim në Gjykatën e Apelit Durrës; (viii) çështja gjyqësore në ngarkim të L. H. dhe A. E. është në gjykim në Gjykatën e Apelit Durrës.

profesional të subjektit dhe ka arsyetuar se në tre⁵⁴ prej dosjeve të shqyrtuara për këtë qëllim, janë konstatuar veprime apo mosveprime të subjektit, të cilat kanë pasur për qëllim favorizimin e individëve të caktuar, të cilët kanë përfituar vendime më të buta se të tjerë subjekte të ligjit, që janë gjendur në të njëjtat kushte apo në rrethana të ngjashme.

25.1. Me raportin e Rezultateve të Hetimit, subjekti është bërë me dije mbi çështjet konkrete të hetuara në funksion të indicieve të DSIK-së dhe rrethanat e konstatuara. Për gjithë këto arsye, dhe përkundër pretendimit të subjektit, konkluzioni i Komisionit për cenim të besimit të publikut nga subjekti, është rrjedhojë e hetimit administrativ të kryer pas njohjes dhe si nevojë e verifikimit të indicieve të organeve ligjzbatuese për problematikat që referojnë ato. Me fjalë të tjera, ndryshe nga sa pretendon subjekti, konkluzioni i Komisionit nuk është i përgjithshëm por pasojë e vlerësimit të secilës çështje për të cilën është hetuar. Për më tepër, Komisioni ka konkluduar edhe që shpjegimet e dhëna nga subjekti, pasi i ka kaluar barra e provës, janë jobindëse dhe pasojë e një interpretimi alternativ, i bazuar në bindjen e tij të brendshme, por që nuk përmbysin barrën e provës.

25.2. Në vlerësimin përfundimtar lidhur me kriterin e aftësive profesionale, në paragrafin 197 të vendimit, Komisioni shprehet se problematikat e konstatuara i kanë krijuar bindjen se subjekti ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë dhe se janë të mjaftueshme për aplikimin e pikës 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pa qenë nevoja për të vijuar me vlerësimin e tyre edhe në planin e aftësive profesionale. Askund në vendim nuk rezulton që Komisioni të ketë artikulluar aplikimin e njëkohshëm të pikës 4 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 paralel me pikën 5 të së njëjtës dispozitë për vlerësimin profesional. Për rrjedhojë, pretendimi për penalizim të dyfishtë të subjektit të rivlerësimit, rezulton i pabazuar në ligj, prova dhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit⁵⁵.

25.3. Sikurse analizuar gjerësisht më sipër në pjesën e pretendimeve të procesit të rregullt, subjekti ka qenë në dijeni të problematikave të konstatuara në çështjet e nënshtruara analizës, është njohur me konstatimin e DSIK-së për papërshtatshmërinë e tij në vazhdimin e detyrës, hetimin e kryer nga Komisioni për analizimin e dosjeve që janë sjellë në pah nga të dhënat e referuara në raportin e DSIK-së. Ai ka qenë në dijeni të çështjeve gjyqësore konkrete në të cilat janë konstatuar veprime ose mosveprime që, sipas Komisionit, kanë favorizuar disa prej palëve në gjykim. Problematikat e konstatuara kanë qenë të qarta dhe në prapësimet e dërguara, me fokus faqet 11 dhe 98, subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me cenimin e besimit të publikut. Ky fakt tregon që subjekti ka qenë i qartë që konstatimet në atë fazë, kanë qenë të tilla që mund të çonin në vlerësimin për cenim të besimit të publikut. Së dyti, mënyra sesi Komisioni vlerëson të cilësojë konkluzionet, është diskrecion i tij për sa kohë është një ndër parashikimet/alternativat e ligjit dhe është arsyetuar.

⁵⁴ Konkretisht në dosjen nr. {***}, kundër E. M. etj.; në dosjen nr. {***}, që i përket çështjes civile me palë G. M. dhe N. M.; në dosjen nr. {***}, që i përket çështjes penale me të pandehur D.T..

⁵⁵ Shih vendimet nr. 31 (JR)/2020, paragrafi 50 (SR E. G.); nr. 16 (JR)/2021, pika 97 (JR A. N.); nr. 21 (JR)/2021, pika 101 (SR H. V.) etj.

25.4. Për sa i përket shtrirjes në kohë të çështjeve të analizuara, në përputhje me përcaktimin e pikës 4, të nenit 41 të ligjit nr. 84/2016, me afat fundor në 1 janar 2006⁵⁶, ajo është bërë në funksion të verifikimit të indicieve nga burimet e tjera të rivlerësimit, nga DSIK-ja dhe KLGj-ja në rastin konkret. Konkretisht, me raportin e përditësuar, DSIK-ja ka dërguar në Komisionin informacion shtesë që referojnë përfshirje të subjektit në korrupsion pasiv dhe në veprimtari të kundërligjshme, në kohështrirje *para dhe gjatë* periudhës së rivlerësimit. Nga korrespondenca me KLGj-në⁵⁷, Komisioni është vënë në dijeni për një procedim disiplinor që mund të ketë nisur për subjektin, lidhur me një çështje gjyqësore⁵⁸. Këto rrethana janë arsyetuar në rezultatet e hetimit dhe në vendim. Sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit për mungesë arsyetimi për shkaqet e shtrirjes së kontrollit jashtë periudhës së rivlerësimit.

25.5. Nën dritën e neneve 45 e 49 të ligjit nr. 84/2016, pjesë e hetimit që kryen Komisioni është edhe kërkimi i informacionit dhe dokumentacionit për indicie të ardhura nga burime të tjera (institucione, denoncime qytetarësh etj.). Në këtë linjë, sikurse referuar më sipër, Komisioni ka marrë dokumentacion nga KLGj-ja për vlerësimin profesional të subjektit, që ka përfshirë edhe të dhëna për procedimin e mëparshëm disiplinor dhe të shkeljeve të evidentuara në ngarkim të subjektit në periudhën kohore 2009-2011. Kjo mënyrë procedimi është në përputhje me kuadrin ligjor të zbatueshëm⁵⁹. Subjektit i është kërkuar edhe të japë shpjegime për problematikat referuar atyre të përmbledhura në raportin e KLD-së. Edhe në seancën dëgjimore, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime lidhur edhe me gjetjet e KLD-së e KLGj-së. Këto fakte dëshmojnë më së paku që Komisioni ka kryer hetimin e tij të pavarur për sa rezulton nga aktet e përcjella nga KLGj-ja për procedimin e mëparshëm disiplinor në ngarkim të subjektit. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se shkeljet nuk janë pasojë e hetimit të Komisionit, është i pabazuar.

25.6. Nga ana tjetër, trupi gjykues e gjen të pabazuar kërkimin e subjektit për të mos i dhënë peshë gjetjeve të Ministrisë së Drejtësisë në procedimin disiplinor të vitit 2009, meqenëse ai organ, sipas subjektit, nuk është një nga organet ndihmëse të procesit të rivlerësimit. Së pari, nuk rezulton që Komisioni ta ketë bazuar vlerësimin për subjektin në procedimin disiplinor të kërkuar nga Ministria e Drejtësisë, apo t'u ketë dhënë peshën e akteve që kryejnë institucionet ndihmëse në procesin e rivlerësimit, raportit të atij hetimi. Raporti i ish-KLD-së ka pasqyruar rrethana të cilat duken në të njëjtën linjë me informacionin e referuar nga organet ligjzbatuese, përfshirë edhe

⁵⁶ Neni 41/4 parashikon që: “Vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale. Komisioni ose Kolegji i Apelimeve merr parasysh këto informacione nëse relatori i çështjes ose vëzhguesi ndërkombëtar i çmon si të domosdoshme për procesin e rivlerësimit. [...]”.

⁵⁷ Shkresa e Komisionit nr. {***} prot., datë 08.10.2020, drejtuar KLGj-së, për informacion dhe dokumentacion që i përket njëres prej çështjeve penale të analizuara.

⁵⁸ Çështja penale me të pandehur S. Ç. etj.

⁵⁹ Neni 43: “[4.] Nëse relatori vihet në dijeni nga shtetasit/publiku ose burime të tjera në përputhje me nenin 49, të këtij ligji, mbi fakte të besueshme për punën e subjektit të rivlerësimit, ai mund të vazhdojë procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale [...]” dhe neni 75/4 i ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”: “[4] Paanësia e magjistratit, në lidhje me kujdesin e tij ndaj konfliktit të interesit dhe respektimin e çështjeve të grupeve në nevojë, duke përfshirë edhe çështjet e barazisë gjinore dhe të pakicave, matet duke u bazuar në tregues të tillë si përdorimi i gjuhës diskriminuese, numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e magjistratit, si dhe tregues të tjerë që dalin nga burime të tjera vlerësimi . [...]”.

indicie për shpërdorim të detyrës “në kohështrirje para dhe gjatë periudhës së rivlerësimit”⁶⁰. Së dyti, dhe duke abstraguar nga sa ka ndodhur në rrethanat konkrete, në nivel parimor, ndërsa tre kriteret e vlerësimit kanë pikënisje raportet e organeve ndihmëse – ILDKPKI, KLGj dhe Grupin e Punës së DSIK-së – vlerësimi i subjekteve/magjistratëve qoftë në procesin e rivlerësimit apo në atë të zakonshëm nga organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, bazohet edhe në tregues që dalin nga burime të tjera vlerësimi. Në një lexim harmonik të gjithë dispozitave që rregullojnë vlerësimin kalimtar apo atë të zakonshëm, “burime të tjera vlerësimi”, do të konsiderohen edhe denoncimet e publikut apo edhe informacione të institucioneve të tjera, për të cilat Komisioni ose Kolegji çmojnë nëse ka shkaqe të mjaftueshme për fillimin e hetimit kryesisht. Konkretisht, nën dritën e neneve 42, 49 dhe 53 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 75, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, burimet e tjera të vlerësimit kanë parasysh një gamë të gjerë, dhe përfshijnë edhe publikun, përpos institucioneve. Për këtë arsye, verifikimi i këtyre rrethanave në drejtim të kontrollit të besueshmërisë së subjektit, me të drejtë është konsideruar me rëndësi e kërkuar shpjegime nga Komisioni.

25.7. I pabazuar është edhe pretendimi se Komisioni ka vlerësuar vendimmarrjet e subjektit për zgjidhjen e çështjeve në themel. Së pari, neni E i Aneksit të Kushtetutës dhe pika 4, e nenit 72 e ligjit nr. 96/2016, nuk i referohen literalisht si koncept bindjes së brendshme të magjistratit. Ato përcaktojnë se vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar *korrektësinë* e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet. Së dyti, trupi gjykues vëren se problematikat për të cilat subjektit i ka kaluar barra e provës për të dhënë shpjegime, lidhen kryesisht me mosrespektim të normave *procedurale*⁶¹ dhe të afateve ligjore për shqyrtim, sipas sistemit të vlerësimit të përcaktuar në vendimin nr. 261/2, datë 14.04.2010, të KLD-së dhe Aneksin 1 të tij⁶². Mosrespektimi i afateve nga subjekti, duke shkaktuar zvarritje të

⁶⁰ Në relacionin e Drejtorisë së Inspektimit Gjyqësor, datë 24.04.2009, dërguar KLD-së, me kërkesë për procedim disiplinor të subjektit, dhe shkarkimin e tij nga detyra, referuar në paragrafin 134/135 të vendimit të Komisionit, raportohet, ndër të tjera, se: “Moszbatimi nga ana e gjyqtarit i urdhërimeve të neneve [...] të Kodit të Procedurës Penale në gjykimin e të pandehurve është kryer me dashje, pasi në tërësinë e provave shkresore të administruara në dosjet gjyqësore vërtetohet ekzistenca e rrethanave të cilat kanë qenë evidente dhe shumë të qarta për gjykatësin, por qëllimisht nuk janë analizuar nga ana e gjyqtarit Bujar Musta. Qëndrimi i mbajtur tregon për një pamjaftueshmëri profesionale të gjyqtarit, si dhe përbën një diskreditim të rëndë të pozitës dhe figurës së gjyqtari”.

⁶¹ Komisioni ka konstatuar raste në të cilat subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar normat ligjore procedurale të detyrueshme në një proces gjyqësor. Ndër to, në: (i) dosjen nr. {***}, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur pengesë ligjore për marrjen pjesë në gjykim (vendimi nr. {***}/2005, ndaj A. C.). Për objektin e procedimit, subjekti ka shfaqur mendim më herët në vendimin nr. {***}, datë 25.05.2004, shkelje e evidentuar edhe nga Gjykata e Apelit e cila, ka vendosur: “Prishjen e vendimit nr. {***}, datë 08.07.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, dërgimin e saj për gjykim me një tjetër trup gjykues”; (ii) shkeljet procedurale në gjykimin e çështjes gjyqësore (paditës R. K. dhe të paditur A. Xh.) në kushtet që disponimi me kthimin e padisë ishte i gabuar. Subjekti ka vendosur kthimin e padisë për të plotësuar të metat e padisë ndërkohë që nga aktet e dosjes ka rezultuar se plotësimi i të metave të padisë është kryer e dërguar nga avokati i palës brenda afatit 5-ditor, i komunikuar dhe sigluar për veprim subjektit, dhe i pa marrë në konsideratë; (iii) shkelje të dispozitave procedurale në çështjen gjyqësore që i përket A. Ç. (trajtuar në pikën 170/c të vendimit) duke vendosur lënien për rritje dhe edukim të fëmijës së mitur, pa dëgjuar këtë të fundit dhe pa marrë mendim nga psikologu, në shkelje të neneve 6, paragrafi 4; 155; 267 e 273 të Kodit të Familjes; (iv) shkelje të dispozitave procedurale në dosjen nr. {***}, në çështjen penale nr. {***} regj. them., datë 27.10.2014, që i përket G. C., që konsistojnë në zhvillimin e seancës së vleftësimit dhe caktimit të masës së sigurimit pa praninë e mbrojtësit, në kundërshtim me nenin 259, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale.

⁶² Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore. Ndër çështjet e referuara, mund të përmendim çështjet e përzgjedhura sipas një sistemi rastësor dhe objektiv, madje edhe çështjet të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, pasqyruar në kreun nr. I dhe II të rezultateve të hetimit: Dokumenti nr. {***}, që i përket paditësit P. P., kundër të paditurve,

gjykimit, është konstatuar edhe në kontrollet e kryera nga KLD-ja, që në vitin 2014 ka dhënë masën disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” për shkelje të disiplinës në veprimtarinë e gjyqtarit⁶³. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit.

25.8. Fakti që Komisioni ka qenë i ndërgjegjshëm për kufijtë e kontrollit që përcakton neni E i Aneksit të Kushtetutës, rezulton qartë në disponimin për të mos hetuar në më së paku dy raste ku është në diskutim themeli i çështjes⁶⁴. Subjekti nuk ka parashtruar asnjë argument për tejkalimin e afateve përveç ngarkesës në punë. Në ankim e parashtrime, subjekti e konsideron “bindjen e brendshme” si një “mjet vlerësimi personal/individual” që legjitimon vendimmarrjen e tij. Në faqet nr. 38-39 të ankimit, në pretendimet e ngritura për çështjen penale me të pandehur D. T., subjekti shprehet si vijon: “[...] *Dispozitat procedurale penale qëndrojnë të lidhura ngushtë me bindjen e brendshme të gjyqtarit të krijuar nga provat e administruara dhe me logjikën e interpretimit/analizimit të rrethanave e fakteve përkatëse. [...]*” Nga këto argumente, sikurse edhe të tjerë përgjatë ankimit e parashtrimeve shtesë, rezulton që subjekti e percepton atë që sipas tij përbën “bindje të brendshme” si mungesë llogaridhënieje, disponim që nuk mund të bëhet objekt kontrolli, ndonëse në rrethanat konkrete janë në diskutim dispozita procedurale, të drejta të palëve për proces të rregull e gjykim të drejtë apo norma të vendosura për qëllim të interesit publik, të cilat për nga natyra, përkufizimisht e parimisht janë taksative dhe nuk mund të përbëjnë diskrecion apo kushtëzohen nga ajo që sipas subjektit përbën ‘bindje të brendshme’ të tij. Në ankim e parashtrime⁶⁵, subjekti konsideron të lidhura me bindjen e brendshme të tij, jo vetëm vendimet që lidhen me themelin e çështjes, por edhe vendimet e ndërmjetme që lidhen me aspektin procedural të gjykimit. Trupi gjykues i Kolegjit nënvizon se në nivel parimor, normat procedurale të gjykimit janë të detyrueshme dhe nuk lënë hapësira për interpretim sipas bindjes së brendshme të

*përmbartuesi privat H. C. dhe shtetasve F. M. etj., me vendim gjyqësor nr. {***}, datë 21.11.2001, sipas të cilit ka rezultuar se vendimi është dhënë pas 1 viti, pra jashtë afatit standard 6-mujor, të parashikuar nga pika 5, shkronja “b” e Aneksit I të Sistemit të Vlerësimit; Dosja {***}, që i përket paditësit Drejtoria e Shërbimit Pyjor Elbasan kundër të paditurit K. M. Kohëzgjatja e gjykimit të çështjes nga subjekti i rivlerësimit është 8 muaj, në shkelje të afatit standard 6-mujor, të përcaktuar nga pika 5 shkronja “e” të Aneksit I të Sistemit të Vlerësimit; Dosja 4, që i përket paditësit P. P. kundër të paditurit OShEE, me objekt “Shpërblim dëmi nga mosfurnizimi me energji elektrike, në shumën 400.000 lekë. Kohëzgjatja e çështjes nga subjekti i rivlerësimit është në tejkalim të afatit standard 6-mujor, të përcaktuar nga pika 5, shkronja “e” të Aneksit I të Sistemit të Vlerësimit.*

⁶³ Referuar poshtëshënimit nr. 32 të vendimit të Komisionit dhe vendimit nr. {***}, datë 15.03.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit, KLD-ja ka nisur procedim disiplinor në ngarkim të subjektit në datën 12.02.2014, në lidhje me tre ankesa të tjera të lidhura me tejkalime afatesh. Në vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit citohet: “Në të tre relacionet, konkludohet se gjyqtari ka lejuar zvarritje të përsëritur e të pajustificuar të veprimeve procedurale me pasojë për të drejtat kushtetuese të palëve dhe imazhin e drejtësisë” dhe “shkeljet e konstatuara në veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarit Bujar Musta, vlerësohen se kanë shkaktuar shqetësim në një masë të madhe të njerëzve të interesuar, duke dëmtuar besimin e publikut në dhënien dhe administrimin e drejtësisë, duke ulur imazhin e sistemit gjyqësor”.

⁶⁴ Referuar, ndër të tjerë, në paragrafin 156 për dosjen nr. {***}, si dhe në paragrafin 172, nën-pika 8 e vendimit, që i përket denoncimit, datë 07.03.2018, nga z. L. H..

⁶⁵ Konkretisht, ndër të tjera, në shpjegimet e dhëna në pikën 33, shkronja “a”, të ankimit, por në tërësi në gjithë përmbajtjen, dispozitat procedurale janë të lidhura ngushtë me bindjen e brendshme të gjyqtarit. Në faqen 223 të parashtrimeve shtesë subjekti shprehet ekzaktësisht si vijon: “[...] nëse këto vendime të miat (për këto palë), prishen nga Gjykata e Apelit, provohet qartazi se ato nuk janë rrjedhojë e moszbatimit/mosaplikimit të drejtpërdrejtë e dispozitave procedurale civile, sepse rezulton se unë i kam marrë vendimet bazuar në bindjen time të brendshme, sipas rrethanave/fakteve e provave të administruara gjatë gjykimit. [...]. Në faqen 269 të parashtrimeve shtesë të datës 23.12.2022, subjekti shprehet: “[...] e) Edhe nëse interpretimi i dispozitave procedurale civile “për dorëheqjen” është i gabuar, kjo është pasojë e bindjes time, në mirëbesim dhe jo për shkak të keqbesimit tim apo qëllimeve të posaçme, të paligjshme [...].”

magjistratit. Në kushtet që mosrespektimi i tyre mund të passjellë pavlefshmërinë e veprimeve të caktuara me rëndësi në aspektin e zgjidhjes së themelit të çështjes, gjyqtari nuk mund të kontestojë mënyrën e zbatimit, mbështetur në bindjen e tij të brendshme.

25.9. Subjekti argumenton që edhe nëse gjykata më e lartë prish vendimet e tij për shkaqe procedurale, nuk përbën tregues të moszbatimit të këtyre dispozitave prej tij. Kjo qasje e subjektit dhe interpretim i asaj që ai shtrin të jetë bindje e brendshme, dhe për aq sa është pjesë e shkaqeve të ankimit, vlerësohet të jetë në mospërputhje me normat procedurale sipas të cilave vendimi mbështetet vetëm mbi ligj e prova. Me fjalë të tjera, bindja e brendshme, sipas parashikimeve ligjore në nenet 29 e 309 të Kodit të Procedurës Civile, nuk mund të ekzistojë pa prova e pa qenë e bazuar në dispozita ligjore. Këto të fundit, gjyqtari i argumenton në bazë të bindjes së brendshme, së bashku me rrethanat e çështjes, në tërësinë e tyre. E thënë ndryshe, bindja e brendshme që nuk ka për bazë fakte, prova e ligj, është arbitraret. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se shpjegimet e subjektit, përkundër sa nënkupton procesi i rivlerësimit dhe fazat e ndryshme që ai përfshin, nuk kanë konsistuar në analizën e provave konkrete mbi të cilat ai ka mbërritur në konkluzione të caktuara apo bindjen për mënyrën e disponimit në vendimet për të cilat është pyetur në vlerësimin profesional. Kjo qasje nuk është ajo që pritet nga një magjistrat karriere, sikurse subjekti i rivlerësimit, e si e tillë u mbajt në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes, si një sjellje që nuk garanton besueshmërinë e publikut të drejtësia.

25.10. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit, vlerëson se ndryshe nga sa pretendohet, Komisioni nuk ka vepruar në tejkallim të kompetencës së tij lëndore në vlerësimin e dosjeve të gjykuara nga ana e subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, gjatë verifikimit të pretendimeve trupi gjykues i Kolegjit konstatoi edhe qasje të gabuara të subjektit në raport me zbatimin e dispozitave procedurale, të cilat ndryshe nga mënyra sesi i karakterizon subjekti janë detyrim dhe nuk përbëjnë zgjedhje, të kushtëzuara nga koncepti i përdorur prej subjektit për atë që përbën bindja e brendshme e tij. Për këto arsye, edhe ky pretendim i subjektit, në tërësi është i pabazuar.

25.11. Pretendimet e tjera me objekt arsyetimin e vendimit dhe shkaqet për të cilat subjekti pretendon se ka qenë i paqartë për mënyrën e vlerësimit të kërkesave të tij për aspektet e ndryshme të barrës së provës janë analizuar në detaj në krye të këtij vendimi, në rubrikën që i dedikohet shkaqeve të ankimit me fokus procesin e rregullt. Pa përsëritur sa më sipër, Komisioni i ka dhënë mundësi subjektit të japë shpjegime, me shkrim dhe me gojë, dhe ka analizuar gjerësisht në vendim, edhe duke riprodhuar verbatim sa ka shpjeguar subjekti – sikurse rezulton qartë nga faqet 57-62 apo 63-73 të vendimit, ndër të tjera. Për pasojë, ky shkak ankimi është i pabazuar dhe vlerësohet i shteruar në analizën e përfshirë në këtë vendim. Në të njëjtën linjë, edhe pretendimet e përgjithshme se konkluzionet e Komisionit kanë qenë tendencioze, janë njësoj të pabazuara dhe sikurse arsyetohet në vijim, në kushtet ku shkeljet e konstatuara kanë objekt e rrethana konkrete, janë të pambështetura e paraqiten si qëllim më vetë për të zhvlerësuar vendimin, pa ilustrime me shembuj specifikë.

25.12. Përpos shpjegimeve në prapësimet kundër rezultateve të hetimit, Komisioni i ka dhënë subjektit mundësinë e paraqitjes së provave shtesë, për problematikat e konstatuara për kriterin e figurës dhe të aftësive profesionale. Subjekti i rivlerësimit është shprehur se “*i qëndron të njëjtave*

parashtrime, e të njëjtën vendimmarrje do të merrte edhe sot, në qoftë se do të kishte të njëjtat dosje". Pasi i ka mundësuar subjektit dy herë dhënien e prapësimeve, Komisioni përfundimisht është shprehur (në paragrafin 196 të vendimit) që "nuk i ka gjetur shpjegimet e dhëna, bindëse që përmbysin apo ndryshojnë totalisht rezultatet e njoftuara" dhe që shpjegimet e subjektit në thelb kanë pretendimin që qëndrimet e tij bazohen "në bindjen e tij." Në seancë dëgjimore, relatori i çështjes ka referuar se në rezultatet e hetimit janë përfshirë edhe gjetjet e organit kompetent,⁶⁶ për të cilat Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime në mënyrë specifike ose i ka kaluar barrë prove për problematikat e konstatuara, pa shprehur kualifikim ligjor paraprak (shih edhe arsyetimin në paragrafin 17.1. e 17.2., ndër të tjerë). Pjesë e rezultateve të hetimit është edhe relacioni i Ministrisë së Drejtësisë, në aktet e të cilit ka arsyetim për kualifikime ligjore për pamjaftueshmëri të dukshme profesionale në zbatim të ligjit procedural, me pasojë dhënien e vendimeve në kundërshtim me ligjin shoqëror, duke cenuar besueshmërinë e publikut në pavarësinë dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor dhe që veprimet dhe mosveprimet e gjyqtarit cenojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, në kuptim të nenit 147, pika 6 e Kushtetutës.

25.13. Për rrjedhojë, dhe sikurse arsyetuar më sipër, pretendimi se subjekti ishte në padijeni për pritshmëritë në drejtim të cenimit të besimit të publikut me pasoja për subjektin, është i pabazuar edhe në një analizë të rrethanave konkrete ligjore e faktike. Problematikat e prezantuara, kanë qenë ndërtuar e referuar në drejtim të besimit të publikut, përfshirë edhe për shkak se ndër problematikat e njoftuara, gjenden edhe ato të pasqyruara në raportin e KLD-së në vitin 2009, apo procedimin disiplinor i datës 12.02.2014, ku shprehimisht shkeljet e evidentuara referohen si cenim i besueshmërisë së publikut në pavarësinë dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor. Kjo lidhje është perceptuar qartë edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit në prapësimet kundër rezultateve të hetimit, sikurse arsyetohet edhe më sipër. Bazuar në sa më lart arsyetuar, trupi gjykues i Kolegjit e gjen edhe këtë pretendim të pambështetur në prova.

C.2. Pretendimet për çështjet e analizuar

- 26.** Subjekti pretendon se në vendimin objekt ankimi, janë përfshirë dosje të cilat nuk i ka gjykuar ai. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se në rezultatet e hetimit dhe në vendim⁶⁷, Komisioni ka pasqyruar të gjitha hetimet që ka kryer për vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, përfshirë edhe çështje për të cilat nuk i ka kaluar barrë prove. Nga ana tjetër, subjekti ka zgjedhur të japë shpjegime për të gjitha çështjet e hetuara, pavarësisht nga barra e provës e pakaluar për to. Këtë

⁶⁶ Përfshirë raportin profesional të Inspektoratit të KLD-së, përcjellë Komisionit me shkresën nr. {***} prot., datë 16.05.2018.

⁶⁷ Ndër të tjerë, denoncimi i z. L. H. ose dosja nr. {***} që i përket çështjes civile me palë M. M. dhe E. M. e cila është marrë në shqyrtim nisur nga informacioni i referuar nga DSIK-ja. Në rezultatet e hetimit, Komisioni ka përmbledhur kronologjinë e gjykimit të çështjes, sipas të cilës, subjekti i është kaluar për gjykim çështja gjyqësore me objekt zgjidhje martesë, lënie fëmije për rritje dhe edukim. Një nga palët ka kërkuar përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjes. Kjo kërkesë është deklaruar e papranueshme nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, në datën 19.06.2020. Komisioni ka prezantuar si rrethanë edhe një tjetër kërkesëpadi me objekt "Shkaktim dëmi nga subjekti i rivlerësimit Bujar Musta për dëmin e shkaktuar nga përgatitja e dokumentacionit dhe ankimi", të depozituar nga E. M., për të cilën Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin, datë 09.01.2020, ka vendosur "Kthimin e padisë dhe akteve, palës paditëse". Nga mënyra se si është formuluar ky fragment i rezultateve të hetimit, duket se Komisioni ka prezantuar gjithë çfarë ka konstatuar gjatë shqyrtimit të kësaj dosje, por nuk duket që të ketë veçuar problematika për të cilat t'i ketë ngarkuar subjektin barrë prove, fakt i cili pranohet edhe nga vetë subjekti në pikën 24, faqe 112 të parashtrimeve të depozituara në Kolegjin në datën 20.01.2025.

aspekt e ka theksuar edhe relatori gjatë seancës dëgjimore në Komision, duke kërkuar shpjegime vetëm për çështjet e konstatuara me problematika. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se në kushtet që shumica e këtyre dosjeve ishin denoncime nga publiku, Komisioni ka zgjedhur t'i pasqyrojë në vendim për transparencë të publikut, por kjo rrethanë nuk e bën të cënueshëm vendimin objekt ankimi, për sa kohë Komisioni ka evidentuar qartë se disa prej tyre nuk iu nënshtruan hetimit administrativ e për disa të tjera nuk u konstatuan parregullsi e gjetje për t'i kaluar subjektit barrën e provës. Sa sipër argumentuar, trupi gjykues çmon të mos ndalet në pretendimet e subjektit për çështjet gjyqësore për të cilat nuk i është kaluar barrë prove pasi janë pa asnjë efekt në vendimmarrje.

C.2.I. Analiza e shkaqeve të ankimit në lidhje me 3 (tri) çështjet gjyqësore të përzgjedhura prej subjektit dhe 5 (pesë) dosjet e përzgjedhura me short.

26.1. Subjekti i rivlerësimit i ka bërë këto dosje shkak ankimor, me të njëjtat pretendime të ngritura në prapësimet e rezultateve të hetimit, duke potencuar bindjen e tij të brendshme si argument kryesor. Subjekti po ashtu pretendon se shkeljet nuk janë serioze e as të shtrira në kohë. Si të tilla, ato nuk mund të shërbejnë si gjetje që duhet të analizohen në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit. Subjekti ka potencuar konkluzionet e Komisionit në lidhje me dosjet gjyqësore të përzgjedhura prej tij dhe ato të përzgjedhura me short, e konkretisht për:

- *dokumentin nr. {***}, që i përket vendimit nr. {***}, datë 25.05.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me palë paditësit P. P. kundër të paditurve, përmbaruesi privat H. C. dhe shtetasve F. M. etj., me objekt “Pavlefshmëri titulli ekzekutiv (vendimi gjyqësor nr. {***}, datë 21.11.2001, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan), si dhe sigurimin e padisë nëpërmjet pezullimit të ekzekutimit”. Subjektit i është kaluar barra e provës në lidhje me rezultatin e hetimit se gjykimi ka zgjatur 1 vit, pra jashtë afatit standard 6-mujor të parashikuar nga pika 5, shkronja “b”, e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit;*
- *dokumentin nr. {***}, që i përket vendimit nr. {***}, datë 23.09.2015, dhënë për çështjen gjyqësore me palë paditëse A. D. kundër të paditurve AKKP Tiranë dhe T. K., si dhe personit të tretë Bashkia Gramsh, me objekt “Pavlefshmëri absolute e vendimit nr. {***}, datë 26.03.2013, të AKKP dhe shfuqizimin pjesërisht të tij”. Subjektit i është kaluar barra e provës në lidhje me rezultatin e hetimit se vendimi paraqet vështirësi në kuptimin dhe argumentimin e tij, pasi pjesa përshkruese arsyetuese ka përsëritje duke rritur volumin e vendimit;*
- *dosjen {***}, që i përket çështjes civile me palë paditëse Drejtoria e Shërbimit Pyjor Elbasan kundër të paditurit K. M., me objekt: “Shpërblim dëmit të shkaktuar fondit pyjor në shumën 170.026 lekë”, e përfunduar me vendimin nr. {***}, datë 11.03.2014. Për këtë dosje subjektit i është kaluar barra e provës në lidhje me gjetjen se gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur gjithsej 8 muaj, jashtë afatit standard 6-mujor të përcaktuar nga pika 5, shkronja “e”, e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit;*
- *dosjen {***}, që i përket çështjes civile me palë, paditëse Byroja Shqiptare e Sigurimeve, kundër të paditurit P. C., me objekt “Kthimin e shumës 15.270.029 lekë”, e përfunduar me vendimin nr. {***}, datë 01.04.2014. Subjekti e ka bërë shkak ankimi, ndonëse për këtë dosje nuk i është kaluar barrë prove;*

- *dosjen {***}* që i përket çështjes penale me palë Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan kundër të pandehurit G. C., i akuzuar për veprën penale të “*Drejtimin të automjetit në mënyrë të parregullt*”, të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. {***}, datë 31.10.2014. Për këtë dosje, subjektit i është kaluar barrë prove në lidhje me konstatimin se seancat gjyqësore nuk dokumentohet të jenë zhvilluar në sallë gjykimi dhe nuk janë regjistruar audio. Po ashtu, seanca e “*Vleftësimit të arrestit në flagrancë*” është zhvilluar pa pjesëmarrjen e mbrojtësit, e cila është e domosdoshme, sipas nenit 259, pika 1 të Kodit të Procedurës Penale;
- *dosjen {***}* që i përket çështjes civile me palë, paditësi P. P. kundër të paditurit OShEE, me objekt “*Shpërblim dëmi nga mosfurnizimi me energji elektrike në shumën 400.000 lekë*”, e përfunduar me vendimin nr. {***}, datë 16.02.2016. Për këtë dosje, subjektit i ka kaluar barra e provës për të dhënë shpjegime në lidhje me rezultatin e hetimit se kohëzgjatja e shqyrtimit të çështjes nga subjekti i rivlerësimit është në tejkallim të afatit standard 6-mujor të përcaktuar nga pika 5, shkronja “e”, e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

26.2. Nga analiza e raportit të rezultateve të hetimit dhe e vendimit objekt ankimi, trupi gjykues i Kolegjit, vëren se shqyrtimi i këtyre dokumenteve nuk lidhet me të dhënat që rezultojnë si indicie nga raporti i DSIK-së. Po ashtu, gjetjet në këto procedime nuk përbëjnë në thelb vlerësim të Komisionit, por një pasqyrim të gjetjeve në raportin e rivlerësimit profesional të kryer nga ana e KLD-së. Sikurse vihet re, problematikat e konstatuara më lart, lidhen kryesisht me mosrespektimin e afateve të standardizuara të gjykimit. Ky konstatim i Komisionit potencohet nga subjekti, me pretendimin se zgjatja e gjykimit përtej afateve të lejuara, ka qenë e justifikuar, ai ka pasur si qëllim moscenimin e procesit gjyqësor dhe se zgjatja e afateve të gjykimit e cila nuk përbën sjelljen e tij të zakonshme, është pa relevancë në drejtim të aftësive të tij organizative.

26.3. Nga raporti i vlerësimit profesional të hartuar për rivlerësimin⁶⁸, trupi gjykues vëren se aftësia e subjektit për një gjykim të shpejtë dhe efikas, është bërë shpesh objekt *ankesash* dhe *procedimesh* disiplinore ndaj tij. Me fjalë të tjera, zvarritja e proceseve gjyqësore ka përbërë vazhde të sjelljes së tij të zakonshme, në kundërshtim me sa pretendon subjekti. Qasjet procedurale të subjektit të shprehura në formën e mosrespektimit të afateve dhe për pasojë, zvarritje të gjykimit, janë shkak për të cilin KLD-ja ka marrë masën disiplinore në vitin 2014, më së fundmi. Kjo masë është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit.

26.4. Subjekti i rivlerësimit ankimon konstatimin e Komisionit (për dosjen nr. {***}) se në çështjen penale me të pandehur G. C., në kundërshtim me ligjin, subjekti ka zhvilluar seancën e caktimit të masës së sigurimit pa praninë e mbrojtësit. Sipas subjektit, seanca gjyqësore është zhvilluar në përputhje me dispozitat procedurale penale. Pjesëmarrja e mbrojtësit në këto seanca është e detyrueshme nëse personi nën hetim ka zgjedhur një mbrojtës, ose nuk e ka zgjedhur por kërkon të mbrohet si edhe në rastet e mbrojtjes së detyrueshme. Në këtë çështje, personi nën hetim ka qenë madhor dhe nuk ka kërkuar mbrojtje. Trupi gjykues i Kolegjit, e konsideron këtë pretendim të pambështetur në ligj e konkretisht në pikën 1 të nenit 259 të Kodit të Procedurës Penale, i cili përcakton në mënyrë taksative që: “*Seanca e vleftësimit zhvillohet me pjesëmarrjen*

⁶⁸ *Shih faqen nr. 30 të raportit të vlerësimit të KLD-së.*

e domosdoshme të prokurorit dhe të mbrojtësit. Kur mbrojtësi i zgjedhur ose i caktuar kryesisht nuk është gjetur ose nuk është paraqitur, gjykata cakton si zëvendësues një mbrojtës tjetër”. Kjo dispozitë është detyruese dhe nuk lë asnjë hapësirë për vlerësim apo interpretim alternativ nga gjyqtari. Për rrjedhojë, interpretimi që subjekti i bën këtij detyrimi ligjor, është i pakuptimtë. Pa përsëritur sa është arsyetuar gjerësisht më sipër, qasja fakultative që i vesh subjekti dispozitave që rregullojnë të drejta themelore të palëve në proces është arbitrare dhe dëmton interesat e tyre. Në këtë kuptim, këto problematika nuk mund të mos kenë efekt negativ në besueshmërinë e publikut tek figura e magjistratit.

26.5. Pretendimet e ngritura në ankim, përveçse përsëritje e atyre të ngritura në shpjegimet kundër rezultateve të hetimit, vlerësohen nga trupi gjykues edhe pa peshë përcaktuese në vlerësimin e subjektit, për sa kohë nga aktet e sipërcituara rezultoi se gjetjet e pasqyruara për këto dokumente, i përkasin në thelb vlerësimin profesional, i cili referuar vendimit objekt ankimi, nuk u çmua i nevojshëm të kryhet për sa kohë problematikat e konstatuara në këtë kriter kanë kontribuar në krijimin e bindjes mbi cenimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë nga ana e subjektit, duke e bërë këtë aspekt vlerësimi joinfluent mbi vendimmarrjen përfundimtare lidhur me vijueshmërinë ose jo, të ushtrimit të detyrës.

C.2.II. Analiza e shkaqeve të ankimit në lidhje me gjetjet referuar të dhënave të nxjerra nga burimet e informacionit.

27. Subjekti i rivlerësimit ka fokusuar një pjesë të ankimit në çështjen gjyqësore administrative iniciuar prej tij, me palë të paditur ish-KLD, dhe objekt anulimin/shfuqizimin e vendimit nr. {***}, datë 16.07.2014, të ish-KLD-së, për masën disiplinore “*Vërejtje me paralajmërim*”, në ngarkim të tij. Subjekti pretendon se vendimi i Komisionit është i pa arsyetuar, pasi Komisioni qartazi është mbështetur në këtë akt të KLD-së, të kundërshtuar prej tij në rrugë gjyqësore. Për rrjedhojë vendimi i Komisionit potencohet si i pa arsyetuar dhe i marrë në shkelje të parimit të kontradiktoritetit. Në verifikim të këtyre pretendimeve, pasi shqyrtoi vendimin objekt ankimi, rezultatet e hetimit dhe aktet e administruara në Komision e në Kolegj, trupi gjykues konstaton si vijon:

27.1. Referuar rezultateve të hetimit dhe paragrafit 129 të vendimit, Komisioni ka evidentuar edhe procedimin disiplinor në fjalë dhe faktin që përfundimisht, masa disiplinore është lënë në fuqi nga gjykatat⁶⁹. Nga kontrolli i kryer në faqen zyrtare të gjykatës në internet, Komisionit i ka rezultuar se kjo çështje ndodhet për gjykim në Gjykatën e Lartë, mbi bazën e rekursit të ushtruar nga subjekti i rivlerësimit. Me parashtrimet shtesë, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Kolegj në datën 20.01.2025, ankimin e tij *individual* të depozituar në *Gjykatën Kushtetuese* nëpërmjet të cilit ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, që ka rrëzuar kërkesën e tij në datën 07.03.2023. Sipas subjektit, Gjykata e Lartë nuk kishte kompetencë lëndore

⁶⁹ *Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë të subjektit të rivlerësimit. Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar në datën 15.03.2016 se: “Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij gjyqësore në tri rastet e verifikuara, është kryer shkelja e rëndë disiplinore zvarritje e pajustificuar dhe e përsëritur e veprimeve procedurale gjatë ushtrimit të funksionit, kur zvarritja ka passjellë ose mund të sillte pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim apo për dhënien e drejtësisë [...]”. Bazuar në këtë arsyetim, gjykata ka konkluduar se nuk ka vend për shfuqizimin e vendimit të KLD-së për dhënien ndaj paditësit të masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim”.*

për shqyrtimin e rekursit, pasi kjo kompetencë i përket vetëm Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Gjykata Kushtetuese, më datë 04.04.2024, ka vendosur *rrëzimin* e kërkesës së subjektit të rivlerësimit⁷⁰.

27.2. Trupi gjykues çmon të theksojë se me parashtrimet shtesë në Kolegj, subjekti ka depozituar vetëm ankimin e tij individual në Gjykatën Kushtetuese, por jo vendimin e kësaj të fundit që ishte marrë nëntë (9) muaj përpara parashtrimeve shtesë, ndonëse në të arsyetohej pikërisht pretendimi i subjektit në parashtrimet shtesë mbi kompetencat lëndore të Gjykatës së Lartë dhe Kolegjit në raport me vendimet e KLGj-së. Ky vendim i Gjykatës Kushtetuese është i botuar në faqen zyrtare, përbën burim të hapur dhe u aksesua nga trupi gjykues kryesisht në kuadër të shqyrtimit të çështjes së subjektit, pasqyruar në këtë vendim.

27.3. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të pabazuar këtë pretendim të subjektit. Nga ana tjetër, depozitimi i pjesshëm i akteve në Kolegj, duke anashkaluar qëllimisht vendimin e Gjykatës Kushtetuese, u mbajt në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes, si një përpjekje për të mënjanuar transparencën, që ndonëse e pasuksesshme, dëshmon se ai është i ndërgjegjshëm për zvarritjet e pajustificuara, të përsëritura dhe të konfirmuara nga institucionet për mënyrën sesi ka ushtruar funksionin, apo pasojat për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim apo për dhënien e drejtësisë.

27.4. Duke iu rikthyer ankimit, pretendimet e subjektit se aktet e sipërcituara të KLD-së, janë mbajtur në konsideratë nga Komisioni për kriterin e aftësive profesionale, përpos faktit që janë të përsëritura dhe të njëjta me ato të prapësuar me rezultatet e hetimit, duke qenë se lidhen me aspektin e vlerësimit profesional, nuk janë bërë pjesë e vlerësimit profesional të subjektit pasi sikurse sipër referuar, Komisioni e ka parë të panevojshme të marrë në vlerësim në drejtim të nivelit kualifikues, këtë kriter. Ndryshe nga sa pretendohet, këto akte e për rrjedhojë, këto pretendime nuk paraqesin relevancë për kriterin e vlerësimit profesional, për sa kohë subjekti nuk është vlerësuar e as është ngarkuar me përgjegjësi për këtë kriter vlerësimi. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon të panevojshme të ndalet më tej në këto pretendime.

*C.2.III. Analiza e shkaqeve të ankimit, në lidhje me dosjen gjyqësore me nr. vendimi {***}, datë 26.5.2004, me të pandehur D. T.*

- 28.** Kjo çështje është shqyrtuar nga një trup gjykues i kryesuar nga subjekti i rivlerësimit. Nga aktet e përcjella, Komisioni ka konstatuar se përpara depozitimit të konkluzioneve përfundimtare,

⁷⁰ Në pikat 24 – 27 të vendimit nr. 23/2023, Gjykata Kushtetuese i ka dhënë përgjigje shteruese edhe pretendimit të subjektit mbi mungesën e kompetencës lëndore të Gjykatës së Lartë, për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të KLGj-së. Sipas arsytimit të saj: [...] 25. Me ndryshimet kushtetuese dhe ligjore të vitit 2016, Gjykatës së Lartë i është hequr e drejta për të shqyrtuar dhe zgjidhur mosmarrëveshjet e ngritura mbi ankimet kundër vendimeve të shkarkimit të gjyqtarëve, duke rënë për pasojë edhe kompetenca e saj lëndore për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve të kësaj natyre [...]. 27. [...] Edhe ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 nuk kanë prekur apo ndryshuar juridiksionin rishikues të Gjykatës së Lartë për shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të dhëna nga gjykatat më të ulëta, në lidhje me kuptimin dhe zbatimin e ligjit prej tyre. Në këtë kuptim, ushtrimi i këtij juridiksioni nga një gjykatë tjetër, përfshi Gjykatën Kushtetuese apo KPA-në, do të binte ndesh me nenin 141 të Kushtetutës ashtu edhe parimet e shtetit të së drejtës dhe të ndarjes e balancimit të pushteteve, sipas neneve 4 dhe 7 të Kushtetutës [...].”

prokurori i çështjes ka kërkuar ndryshimin e akuzës fillestare nga “Trafikim i të miturve”, parashikuar nga neni 128/b i Kodit Penal, në “Kalim i paligjshëm i kufirit” dy herë, të parashikuar nga neni 297 i Kodit Penal. Gjykata ka riçelur hetimin dhe ka marrë vendim për vazhdimin e procedimit mbi akuzën e re të komunikuar nga prokurori. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. {***}, datë 26.5.2004⁷¹, ka vendosur deklarinim fajtor të të pandehurit për veprën penale të “Kalimit të paligjshëm të kufirit” dhe dënimin me 6 muaj burgim, në bashkim të dënimeve 15 muaj burgim”.

28.1. Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime për mungesë arsytimi në vendimin e gjykatës, e cila ka pranuar ndryshimin e akuzës nga “trafikim i fëmijëve” në “kalim i paligjshëm i kufirit”, duke u mjaftuar vetëm me përshkrimin e argumenteve të prokurorit të çështjes, pa bërë një arsyetim të qartë e të plotë, në lidhje me rrethanat e faktit dhe provat mbi të cilat pranoi ndryshimin e akuzës. Në përgjigjet e tij, subjekti ka pranuar që arsyetimi i këtij vendimi duhet të kishte analizë më të thelluar dhe të plotë, për arsytet mbi të cilat është bazuar vendimi. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se subjekti nuk ka paraqitur elemente argumentues bindës apo prova që të përmbysin apo ndryshojnë totalisht rezultatet e hetimit për këtë çështje gjyqësore.

28.2. Në ankim, subjekti pretendon në mënyrë të përmbledhur se: (i) vendimi gjyqësor në fjalë i përket vitit 2004 e duke qenë jashtë periudhës objekt rivlerësimi, Komisioni duhej të analizonte indiciet që diktuan nevojën për shtrirjen e hetimit në këtë dosje; (ii) faktet e cilësimit fajtor të të pandehurit kanë qenë të lidhura me vlerësimin e themelit, i cili lidhet me bindjen e brendshme të trupës gjykuese e, si të tilla, këto fakte nuk mund të ndikojnë në vlerësimin e aftësive të tij profesionale.

28.3. Për sa i përket shtrirjes së hetimit mbi një procedim që datonte në vitin 2004, jashtë periudhës objekt rivlerësimi, trupi gjykues i Kolegjit vëren se ndryshe nga sa pretendohet, Komisioni, në pikën 142 të vendimit objekt ankimi, ka arsyetuar se kjo dosje i përket grupit të dosjeve të shqyrtuara në kuadër të verifikimit të indicieve të referuara nga DSIK-ja. Ky fakt është pasqyruar edhe në rezultatet e hetimit [kreu II, pikat i dhe v]. Në këto kushte, kufiri kohor i vendosur për vlerësimin profesional nuk gjen zbatim në rastin konkret që ka pikënisje indicie të ardhura nga organet ligjzbatuese. Për këto arsye, nga analiza e dosjeve të shqyrtuara për shkak të informacioneve të klasifikuara janë konstatuar një sërë rrethanash, të cilat konfirmojnë ose së paku nuk përjashtojnë, që nga njëra anë veprimet apo mosveprimet e subjektit të kenë pasur për qëllim favorizimin e individëve të caktuar dhe nga ana tjetër faktin që këta persona kanë përfituar një trajtim preferencial, në formën e vendimeve më të buta se të tjerë subjekte të ligjit që janë gjendur në të njëjtat kushte apo në rrethana të ngjashme. Për sa më sipër, ky pretendim vlerësohet nga trupi gjykues si i pabazuar në prova.

28.4. Trupi gjykues e vlerëson të pabazuar edhe pretendimin tjetër se Komisioni ka tejkalluar kufijtë e vlerësimit duke kontrolluar themelin e çështjes. Qoftë në analizën e kësaj dosjeje te rezultatet e hetimit, ashtu edhe në vendim, Komisioni ka abstraguuar nga themeli i vendimmarrjes së gjykatës. Sikurse arsyetuar më lart, subjekti është ngarkuar me barrë prove vetëm me aspektin e arsytimit ligjor të vendimit, si një ndër indikatorët e vlerësimit, referuar nenit 72 të ligjit nr. 96/2016. Sipas

⁷¹ Lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit me vendimin nr. {***}, datë 09.09.2004.

përcaktimit të nenit 128/b të Kodit Penal, “trafikimi i të miturve” përbën *krim* dhe për të parashikohet dënimi me burgim nga 10 deri në 20 vjet. Nga ana tjetër, kalimi i paligjshëm i kufiri përbën *kundërvajtje penale* dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet, sipas neni 297 të Kodit Penal. Nisur nga këto përcaktime ligjore, është evidente se ndryshimi i akuzës e ka vendosur të pandehurin në një situatë më të favorshme. Ndryshimi i akuzës nga prokurori nuk është detyrues për gjykatën, e cila, në bazë të nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale, mund t’i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori. Subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të arsyetonte qëndrimin e gjykatës në vijim të ndryshimit të akuzës nga prokurori. Moskryerja e kësaj analize është pranuar edhe nga vetë subjekti pas kalimit të barrës së provës. Lehtësimi i pozitës të të pandehurit, në të njëjtën linjë me prokurorin e çështjes, nuk bie ndesh me të dhënat për dyshime për favorizim të palëve në proces referuar nga organet ligjzbatuese. Për rrjedhojë, edhe trupi gjykues i Kolegjit, njëjtë si Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka paraqitur elemente argumentues bindës apo prova që të përmbysin rezultatet e hetimit për këtë çështje gjyqësore.

*C.3.IV. Analiza e shkaqeve të ankimit në lidhje me dosjen gjyqësore nr. {***}, me vendim nr. {***}/2005, ndaj z. A. C.*

29. Komisioni ka marrë në shqyrtim dosjen gjyqësore në fjalë në të njëjtat rrethana si për çështjen e mësipërme. I pandehuri akuzohej për kryerjen e veprës penale të “Shfrytëzim prostitucioni”, parashikuar nga neni 114/a, paragrafët 4 dhe 5 të Kodit Penal. Në rend kronologjik rezultoi se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. {***}/2003 [në përbërje të trupit gjykues *nuk* ka qenë subjekti i rivlerësimit], ka deklaruar fajtor të pandehurin për veprën penale të sipër referuar. Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur prishjen e këtij vendimi dhe kthimin e çështjes për rigjykim. Rigjykimi i kësaj çështje është bërë nga një trup gjykues në përbërje të të cilit ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit. Gjatë rigjykimit të çështjes, prokurori ka tërhequr akuzën. Gjykata, më datë 25.05.2004, ka vendosur kalimin e akteve prokurorisë me arsyetimin se në gjendjen që janë aktet është e pamundur vazhdimi i këtij gjykimi dhe dhënia e një vendimi pushimi apo pafajësie. Në vijim, prokuroria ka sjellë përsëri në gjykim të pandehurin për akuzën e shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese, parashikuar nga neni 114/a, pikat 4, 5 të Kodit Penal⁷². Gjykimi është zhvilluar nga një trup gjykues, *pjesë* e të cilit ishte përsëri *subjekti*. Me vendimin nr. {***}, datë 08.07.2005, gjykata ka vendosur *deklarimin e pafajshëm* të të pandehurit dhe heqjen e masës së sigurimit duke urdhëruar lirimin e tij. Vendimi i mësipërm është prishur nga Gjykata e Apelit, e cila më datë 06.02.2006 ka vendosur kthimin për rigjykim me tjetër trup gjykues, pasi ka konstatuar se vendimi është pasojë e shkeljeve procedurale meqenëse dy nga anëtarët e trupit gjykues, subjekti njëri prej tyre, kanë pasur pengesë ligjore për marrjen pjesë në gjykimin e kësaj çështjeje, pasi në vendimin nr. {***}, datë 25.05.2004, ata kishin shfaqur mendim për objektin e procedimit, duke ia kaluar aktet prokurorit. Gjykata e Apelit, po ashtu, ka arsyetuar

⁷² Neni 114/a “Shfrytëzimi prostitucionit në rrethana rënduese” [shtuar me ligjin nr. 8175, datë 23.12.1996 dhe ndryshuar me ligjet nr. 8279, datë 15.01.1998 e nr. 8733, datë 24.01.2001] parashikonte: “Shfrytëzimi i prostitucionit i kryer: [...] 4. me mashtrim, shtrëngim, dhunë ose duke përfutur nga paaftësia fizike ose mendore e personit; 5. ndaj një personi që shtyhet ose shtrëngohet për të ushtruar prostitucionin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë [...], dënohet nga 7 deri në 15 vjet burgim dhe me konfiskim të mjeteve dhe përfitimeve”.

se aktet janë absolutisht të pavlefshme⁷³, për shkak të një shkeljeje procedurale serioze që përjashton mundësinë e shqyrtimit të kërtimeve të palëve⁷⁴. Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime për shkeljen e parimit kushtetues për zhvillimin e një procesi të rregullt nga një gjykatë e paanshme. Me prapësimet kundër rezultateve të hetimit, të cilave u qëndron edhe në ankim, subjekti ka pretenduar se pjesëmarrja e tij në gjykimin e vitit 2005, pavarësisht se i përket të njëjtës çështje penale të gjykuar në vitin 2004, nuk ka cenuar procesin e rregullt ligjor dhe nuk përbën arsye serioze njëanshmërie në kuptim të neneve 15 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale, pasi, sipas tij, vendimi i marrë një vit më parë për kalimin e akteve prokurorit nuk është vendim përfundimtar e nuk duhet të konsiderohet si shprehje mendimi nga ana e tij. Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon, po ashtu, se vendimi gjyqësor objekt kontrolli është jashtë periudhës ligjore objekt rivlerësimi dhe se konstatimet e Komisionit lidhen me vlerësimin e themelit, i cili mund të kryhej vetëm nga Gjykata e Apelit dhe jo nga organet e rivlerësimit.

29.1. Për sa i përket argumentit të kufizimit në kohë të kontrollit, trupi gjykues i Kolegjit rikonfirmon sa është arsyetuar në çështjen tjetër më sipër. Për argumentin tjetër, nëse subjekti duhet të mos ishte pjesë e trupit gjykues, rezulton se ai ka marrë pjesë në dy trupa gjyqësorë, duke shprehur mendim për të njëjtën çështje. Në vendimin nr. {***}, datë 25.5.2004, trupi gjykues i kishte kaluar aktet Prokurorisë së Rrethit Elbasan, ndërsa në vendimin e dytë nr. {***}, datë 08.07.2005, për të pandehurin ishte shpallur pafajësia. Pretendimi i subjektit rezulton i pambështetur në normat procedurale penale. Konkretisht, në kohën e dhënies së vendimit të pafajësisë të të pandehurit [vendimi datë 08.07.2005], ishte në fuqi neni 17, pika 1, shkronja “c” të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikonte detyrimin e gjyqtarit për heqje dorë nga gjykimi i çështjes konkrete, *kur ai ka shfaqur mendim mbi objektin e procedimit*. Për të vlerësuar nëse vendimi i vitit 2004 për kalimin e akteve prokurorit konsiderohet shfaqje mendimi, është e nevojshme marrja në analizë e dispozitës ligjore që referon këtë moment procedural. Kalimi i akteve prokurorit parashikohet nga neni 377 i Kodit të Procedurës Penale, i cili në vitin 2004 të dhënies së këtij vendimi, përcaktonte: *“1. Kur prokurori e tërheq akuzën dhe në gjendjen që janë provat vërtetohet se i pandehuri nuk ka faj ose del që ekziston një nga rastet e pushimit të çështjes, gjykata vendos pafajësinë e të pandehurit ose pushimin e çështjes. Në rast të kundërt, gjykata vendos kalimin e akteve prokurorit”*.

29.2. Në interpretim të kësaj dispozite, gjykata kishte detyrimin të analizonte e vlerësonte të gjitha rrethanat e çështjes e provat e administruara dhe vetëm nëse gjendja e tyre nuk e lejonte të dispononte me një vendim pafajësie apo pushimi, ajo dispononte me kalimin e akteve prokurorit. Pavarësisht se kalimi i akteve prokurorit nuk përbente vendim themeli, detyra që ka gjykata në zbatim të kësaj dispozite përfshin edhe shfaqje mendimi, në ndryshim nga sa pretendon subjekti, pasi kalimi i akteve vendosej vetëm pas një analize dhe vlerësimi të të gjithë rrethanave të çështjes

⁷³ Neni 128, pika 1, shkronja “a” i Kodit të Procedurës Penale përcakton që: *“Aktet procedurale janë absolutisht të pavlefshme kur nuk respektohen dispozitat që lidhen me: a) kushtet për të qenë gjyqtar në çështjen konkrete dhe numrin e gjyqtarëve që janë të domosdoshëm për formimin e trupave gjyqësorë, sipas parashikimeve të këtij Kodi; [...]”*.

⁷⁴ Në përfundim të rigjyqimit të kësaj çështjeje, trupi tjetër gjykues më datë 27.06.2006 ka vendosur deklarinimin e pafajshëm të të pandehurit për kryerjen e veprës penale, heqjen e masës së sigurimit etj. Pas ankimit të këtij vendimi nga prokuroria, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 27.06.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

dhe provave të administruara. Edhe me ndryshimet që pësoi kjo dispozitë, në vitin 2017⁷⁵ gjykata nuk mund të disponojë më me kalim aktesh prokurorit, por vetëm me vendim themeli [pafajësi ose pushim]. Nga këto ndryshime mund të deduktohet se ligjvënësi ka diktuar tashmë shprehimisht që gjykata është e detyruar të disponojë me vendim përfundimtar, pikërisht për shkak të angazhimit në analizën dhe vlerësimin e provave, duke shfaqur mendim.

29.3. Edhe pretendimi se shkaqet e prishjes së vendimit nga gjykata më e lartë nuk janë serioze dhe se qëndrimi i ndryshëm i Gjykatës së Apelit nuk përbën shkelje procedurale për subjektin është i pabazuar. Përkundër çfarë pretendon subjekti, trupi gjykues i Kolegjit vëren se Gjkata e Apelit Durrës, jo vetëm që i ka gjetur shkeljet serioze, por ka arsyetuar edhe për pasojat ligjore që ka prodhuar një shkelje e tillë procedurale, duke pamundësuar marrjen parasysh të pretendimeve të palëve, pasi aktet janë absolutisht të *pavlefshme*. Nga ana tjetër, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje që shkeljet disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit si magjistrat janë në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjellja e magjistratit, ndër të tjera, edhe *mosrespektimi i rëndë ose i përsëritur i legjislacionit procedural dhe material ose zbatimi i gabuar i legjislacionit procedural dhe material, kur konstatohet nga një gjykatë më e lartë*⁷⁶. Në kushtet ku rezulton e provuar që një gjykatë më e lartë ka bërë konstatim të një shkeljeje të kësaj natyre nga subjekti, rrethanë e cila përbën shkelje disiplinore për subjektin në kuptim të dispozitës ligjore të sipërcituar, pretendimi i subjektit, i cili relativizon situatën ligjore apo përdor argumente që bien ndesh me gjuhën e ligjit, është tregues i standardit të tij të mungesës së përgjegjësisë për të respektuar ligjin.

29.4. *Së fundmi*, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se vendimmarrjet e subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë çështje penale paraqiten në një dinamikë të tillë që i bën të besueshme indiciet e referuara për favorizim të palëve në proces. Kështu, ndërsa në vitin 2003 i pandehuri është deklaruar *fajtor* nga Gjkata e Rrethit Gjyqësor Elbasan [në përbërje të trupit gjykues nuk ka qenë subjekti i rivlerësimit], i njëjti i pandehur *nuk* është gjetur më i tillë në dy rigjykimet e viteve 2004 dhe 2005 [të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit], ku në të parin është vendosur kalimi i akteve prokurorit ndërsa në vitin 2005 i pandehuri deklarohet i pafajshëm. Nga sa më lartarsyetuar dhe nga dinamika e gjykimit të kësaj çështje penale, duket se shpjegimi i subjektit nuk përmbys bindshëm indiciet e referuara nga organe ligjzbatuese për favorizim palësh, të cilat mbeten versioni më i besueshëm.

C.3.V. Analiza e shkaqeve të ankimit në lidhje me dosjen që i përket vendimit të vitit 2008, ndaj të pandehurit S. Ç.

- 30.** Duke vijuar me dosjet e administruara nga Komisioni për shkak të informacionit nga organet ligjzbatuese, subjekti i rivlerësimit ka kryesuar trupin gjykues të kësaj çështjeje në ngarkim të të pandehurit, të akuzuar për “Vrasje me paramendim” dhe “Prodhim e mbajtje pa leje të armëve luftarake”. Prokuroria ka kërkuar deklarimin fajtor të të pandehurit S. Ç. për të dy veprat penale dhe dënimin e tij me 25 vjet burg dhe 3 vjet burg përkatësisht. Për dy të pandehurit e tjerë, prokuroria ka kërkuar deklarimin fajtorë dhe dënime me gjoba të ndryshme për “përkrahje e autorit

⁷⁵ Ky nen është ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, i cili ka hequr fjalinë e dytë duke e formuluar në këtë mënyrë: “[1.] Kur prokurori e tërheq akuzën dhe në gjendjen që janë provat vërtetohet se i pandehuri nuk ka faj ose del që ekziston një nga rastet e pushimit të çështjes, gjykata vendos pafajësinë e të pandehurit ose pushimin e çështjes. [...]”.

⁷⁶ Sipas ligjit nr. 96/2016, neni 102, pika 2, germa “a”.

të krimit”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, kryesuar nga subjekti, më datë 22.01.2008, ka vendosur deklarin e *pafajshëm* të tre të pandehurve. Ky vendim është prishur nga Gjykata e Apelit Durrës në datën 14.04.2009. Gjykata e Lartë, më datë 08.07.2009, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës dhe kthimin për rigjykim me një tjetër trup gjykues. Në rigjykim, Gjykata e Apelit Durrës, më datë 31.05.2010, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 22.01.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Gjykata e Lartë, më datë 17.09.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga prokurori, duke lënë në fuqi përfundimisht vendimin e pafajësisë të marrë, ndër të tjerë, edhe nga subjekti.

30.1. Në vitin 2009, kjo çështje gjyqësore është bërë objekt kontrolli nga ana e Ministrisë së Drejtësisë. Nga dokumentacioni i përcjellë nga KLGj-ja, Komisioni ka konstatuar se në raportin e Drejtorisë së Inspektimit të Gjyqësorit në Ministrinë e Drejtësisë ishin evidentuar shkelje lidhur me zbatimin e kërkesave të Kodit të Procedurës Penale me *dashje* nga subjekti i një numër dispozitash procedurale penale⁷⁷. Sipas këtij raporti, shkeljet tregojnë *pamjaftueshmëri të dukshme* profesionale, me pasojë dhënien e vendimeve *në kundërshtim* me ligjin e me pasoja të rënda. Shkeljet kanë sjellë si pasojë *favorizimin* e të pandehurve, duke *cenuar* besueshmërinë e publikut në pavarësinë dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor dhe pozitën dhe figurën e gjyqtarit, në kuptim të nenit 147, pika 6 e Kushtetutës, sipas raportit në fjalë. Ministri i Drejtësisë ka kërkuar shkarkimin nga detyra të gjyqtarit Bujar Musta. Kjo kërkesë është rrëzuar nga KLD-ja.

30.2. Pasi subjekti ka dhënë shpjegime për sa më sipër, Komisioni ka konkluduar se ato janë jobindëse dhe përbëjnë një interpretim *alternativ*, i bazuar në bindjen e subjektit dhe jo në dokumentacion. Edhe pretendimi se masat disiplinore të propozuara (ose të dhëna) ndaj tij kanë qenë tendencioze dhe të pabazuara, u konsiderua jobindës, për sa kohë të gjitha zvarritjet e proceseve gjyqësore ose vonesat për zbardhjet e vendimeve, pjesë e procedimit disiplinor dhe shkeljeve të tjera të konstatuara nga Ministria e Drejtësisë, ishin bazuar në të dhëna konkrete.

30.3. Në ankim, subjekti i rivlerësimit përsërit të njëjtat shpjegime si edhe në rezultatet e hetimit, duke kundërshtuar edhe sa është analizuar më sipër për përdorimin e këtyre akteve në procesin e rivlerësimit dhe që konkluzionet e Komisionit përbëjnë ndërhyrje në themelin e vendimmarrjes dhe bindjes së brendshme të gjyqtarit, që mund të kontrollohet vetëm nga një gjykatë më e lartë dhe jo nga organet e rivlerësimit.

30.4. Pretendimi i parë për mosdhënie peshë konkluzioneve të Ministrisë së Drejtësisë dhe mosngarkimin e subjektit me përgjegjësi lidhur me to, është trajtuar gjerësisht në pikën 25.6 dhe nën-pikat e këtij vendimi të Kolegjit. Pretendimi për tejkallim kompetence nga Komisioni është, gjithashtu, i pambështetur në akte. Konkretisht, raporti i Ministrisë së Drejtësisë, përthithur nga Komisioni, ka konstatuar probleme në lidhje me zbatimin e kërkesave procedurale penale, me

⁷⁷Sipas relacionit të mbajtur, janë shkelur me dashje urdhërimet e neneve 131/2, 149, 152, 357, pikat 1 e 2, 362/4, 366, 367, 383, pika 1, germa “c” e Kodit të Procedurës Penale. Moszbatimi i këtyre dispozitave është kryer me dashje, pasi në tërësinë e provave shkresore të administruara në dosjet gjyqësore vërtetohet ekzistenca e rrethanave të cilat kanë qenë evidente dhe shumë të qarta për gjykatësin, por qëllimisht nuk janë analizuar nga ana e gjyqtarit Bujar Musta. Moszbatimi nga ana e tij, i dispozitave procedurale penale ka sjellë pasoja të rënda në veprimtarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, duke cenuar dhe ulur autoritetin e organeve të drejtësisë.

pasojë favorizimin e të pandehurve dhe efektin mbi besimin e publikut në pavarësinë dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor. Edhe observacionet e subjektit të rivlerësimit drejtuar KLD-së janë fokusuar në drejtim të dispozitave procedurale lidhur me marrjen dhe çmuarjen e provave. Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se inspektimi i kryer nga KLD-ja është në përputhje edhe me qëndrimin e mbajtur nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 29, datë 30.04.2001⁷⁸, e cila nuk e ka gjetur antikushtetuese veprimtarinë e KLD-së në rastet e inspektimit të vendimeve gjyqësore qofshin këto edhe të formës së prerë, kur vendimet e dhëna janë shoqëruar me shkelje që diskreditojnë rëndë pozitën ose figurën e gjyqtarit dhe që cenojnë në përgjithësi prestigjin dhe autoritetin e pushtetit gjyqësor.

*C.3.V. Analiza e shkaqeve të ankimit në lidhje me dosjen nr. {***} – çështja civile me palë ndërgjyqëse G. M. dhe N. M.*

31. Për këtë dosje të shqyrtuar në kuadër të indicieve të referuara nga DSIK-ja, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka marrë më datë 29.08.2018 vendimin për “Lënien pa veprim të padisë” me argumentin se pala nuk ka përcaktuar saktë vendndodhjen/vendbanimin për vete dhe të paditurën. Me vendimin nr. {***}, datë 01.02.2019, subjekti i rivlerësimit ka vendosur kthimin e padisë. Referuar dëftesës së komunikimit, ky vendim nuk i është njoftuar palëve. Në vijim, me vendimin nr. {***}, datë 25.04.2019, subjekti i rivlerësimit ka vendosur përsëri “Kthimin e padisë”, vendim i cili ka marrë formë të prerë pa u ankimuar nga palët. Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës, duke konstatuar se ai nuk ka marrë masat për njoftimin e palëve në adresën e dhënë nga paditësi në kërkesën e datës 05.04.2019 [që administrohej në dosjen gjyqësore], nëpërmjet të cilës ka referuar një adresë në Itali, duke shkelur dispozitat e neneve 154, 154/a dhe 156 të Kodit të Procedurës Civile.⁷⁹

31.1. Subjekti ka shpjeguar se padia u la pa veprime për shkak të të metave dhe u përcaktua një afat për plotësimin e tyre. Pavarësisht pasjes dijeni që nga data 25.01.2019, paditësi nuk e zbatoi këtë detyrim, pasi nuk paraqiti në gjykatë adresën e plotë të vendbanimit për vete e për të paditurën dhe as certifikatat e kërkuara nga gjykata. Për këtë shkak, në zbatim të neneve 154/a, 306 - 310 dhe 102 - 106 të Kodit të Procedurës Civile, subjekti vendosi më datë 01.02.2019 kthimin e padisë, vendim të cilin ia ka komunikuar paditësit me dëftesën e komunikimit datë 04.02.2019⁸⁰. Në ankim, subjekti i rivlerësimit ka rikonfirmuar shpjegimet e mësipërme, ngre pretendime që lidhen

⁷⁸ Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 29, datë 30.04.2001, me kërkesues A. K., ndër të tjera, ka arsyetuar se: “[...] Vendimet gjyqësore të formës së prerë, për çështjen konkrete që zgjidhin, kanë fuqinë e ligjit. Kjo do të thotë se për sa kohë ato nuk janë prishur ose ndryshuar nga një gjykatë më e lartë, asnjë organ tjetër shtetëror nuk mund të mos përfillë përmbajtjen e tyre dhe të ngarkojë me përgjegjësi gjyqtarin e çështjes. Megjithatë, problemi ndryshon në rastet kur këto vendime janë shoqëruar me shkelje që diskreditojnë rëndë pozitën ose figurën e gjyqtarit dhe që cenojnë në përgjithësi prestigjin dhe autoritetin e pushtetit gjyqësor. Në raste të tilla, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, ka kompetenca të plota të marrë çdo lloj mase disiplinore ndaj gjyqtarëve, pa e kondicionuar atë, me faktin nëse kjo kategori vendimesh kanë marrë formë të prerë dhe kanë fituar kështu autoritetin e gjësë së gjykuar. Madje, ndaj akteve të kësaj natyre të kryera gjatë ushtrimit të detyrës, ai mund të reagojë në çdo kohë edhe kur nuk ka përfunduar shqyrtimi i çështjes. [...]”.

⁷⁹ Ku ka bërë me dije gjykatën për adresën e të paditurës “{***}, Sardegnia, Italia.”

⁸⁰ Dëftesa e komunikimit, e datës 04.02.2019, që administrohet në dosjen e përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me shkresën nr. {***} prot., datë 25.11.2020, është e panënshkruar, ndërsa ajo e përcjellë nga subjekti me prapësimet kundër rezultateve të hetimit rezulton e nënshkruar nga komunikuesi me shënimin se marrësi i aktit refuzon të firmosë.

me barrën e provës dhe kompetencën lëndore të Komisionit për të gjykuar bindjen e brendshme. Sipas subjektit, nuk kuptohet konkluzioni i Komisionit për këtë çështje.

31.2. Trupi gjykues i Kolegjit e gjen të pambështetur në ligj pretendimin e subjektit. Sikurse analizuar gjerësisht më sipër dhe për të evituar përsëritjen, barra e provës i takon subjektit dhe Komisioni i ka mundësuar dhënien e shpjegimeve me shkrim e me gojë dhe kohën shtesë. Shpjegimet e dhëna në kuadër të barrës së provës janë pjesë e vlerësimit që kryhet në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, përpara marrjes së vendimit përfundimtar. Institucionet e rivlerësimit nuk ngarkohen me detyrimin për të dalë me konkluzion për çdo shpjegim të dhënë në kuadër të barrës së provës e për t'i ngarkuar sërish barrë prove subjekteve të rivlerësimit. Nga ana tjetër, trupi gjykues vëren se ndonëse në vendimin e Komisionit mungon një vlerësim i veçantë për këtë dosje, ai e ka përfshirë në vlerësimin tërësor të dosjeve të shqyrtuara, të shprehur në pikën 196 të vendimit objekt ankimi, sipas së cilës subjekti nuk ka paraqitur elemente argumentues bindës apo prova që të përmbysin apo ndryshojnë totalisht rezultatet e hetimit. Në faqen nr. 46 të rezultateve të hetimit, Komisioni ka relatuar qartë konstatimet për të cilat subjekti i kaloi barra e provës, që konsistojnë në mosrespektimin e neneve 154, 156 dhe 154/a të Kodit të Procedurës Civile, për shkak të mosmarrjes së masave për njoftimin e palëve në adresën e dhënë nga paditësi në kërkesën e datës 05.04.2019, ndonëse kjo kërkesë administrohej në dosjen gjyqësore.

31.3. Trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson jobindës shpjegimin e dhënë pas kalimit të barrës së provës se kërkesa e depozituar më datë 05.04.2019 nuk provohet të jetë paraqitur nga paditësi apo përfaqësuesi i tij. Ndryshe nga sa shpjegon subjekti, kjo kërkesë *rezulton e nënshkruar nga vetë paditësi*, i cili ka vënë në dispozicion adresën e palës së paditur. Nga ana tjetër, trupi gjykues vëren se shpjegimet e dhëna në ankim janë në terma të përgjithshëm e subjektivë, pa sqaruar të vetmen rrethanë të kërkuar, mbi arsyen e mosmarrjes parasysh të adresës të të paditurës, vënë në dispozicion nga paditësi G. M. në kërkesën e datës 05.04.2019. Pretendimet e tjera, për tejkalim të kompetencës lëndore të Komisionit, të cilat lidhen me konceptin e subjektit për bindjen e brendshme të gjyqtarit janë ezauruar më sipër e gjejnë zbatim edhe në këtë rast në kushtet që sërish janë në analizë dispozita procedurale.

C.3.VII. Analiza e shkaqeve të ankimit në lidhje me denoncimet e publikut

- 32.** Komisioni ka administruar 28 denoncime bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, si dhe ka administruar disa akte/dosje hetimore dhe gjyqësore. Subjekti i rivlerësimit i ankimon⁸¹, duke parashtruar se u qëndron të njëjtave pretendime të parashtruara në prapësimet e dërguara për kundërshtimin e rezultateve të hetimit, të cilat, sipas tij, përmbysin rezultatet e Komisionit për kriterin e aftësive profesionale. Ankimi paraqitet konfuz dhe voluminoz për shkak të përsëritjes së shpeshtë të të njëjtave pretendime. Disa dosje subjekti i ka ankimuar në mënyrë të veçantë, ndërsa disa të tjera i ka ankimuar në grup, duke pretenduar në mënyrë të përmbledhur se:

⁸¹ K. T., B. I. [për 5 denoncimet e tij], T. Z. e I. B., R. A., Studio ligjore “{***}”, A. D., T. M., Z. T., Gj. Gj., “{***}” dhe E. K.; dosjet e inceneratorëve të vitit 2017 për dhënien e vendimeve të vecanta penale me numrat {***}, {***}, {***}, {***}, {***}, {***}, {***}, {***}, {***}, {***}, {***} dhe {***} te vitit 2017; për çështjet civile nr. {***} Akti/viti 2020 dhe nr. {***} Akti /viti 2020, që u përkasin të njëjtave palë M. D. e T. D..

- Komisioni ka analizuar vendimet e subjektit të rivlerësimit, sipas kriterit të aftësive profesionale, pa bërë një vlerësim objektiv të rrethanave konkrete që përbënin shkelje e që cenonin njëkohësisht besimin e publikut.
- Komisioni nuk i ka njoftuar as në rezultatet e hetimit dhe as në seancë dëgjimore shkeljet përkatëse që do të përbënin cenimin e besimit të publikut. Pas dhënies së shpjegimeve për secilën dosje, Komisioni nuk është shprehur as në seancë dëgjimore dhe as në vendimin përfundimtar se cili pretendim qëndronte dhe cili jo.
- Subjekti ka treguar aftësi të pranueshme organizative, profesionale e ligjore. Seancat përgatitore e gjyqësore janë planifikuar dhe zhvilluar në efikasitet të plotë. Dispozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe Kodit të Procedurës Penale në fuqi janë zbatuar drejt dhe në funksion të produktivitetit të zhvillimit të seancave.
- Vonesat dhe zvarritjet në gjykime kanë ardhur si rezultat i ngarkesës së lartë në punë, nuk kanë qenë të qëllimshme dhe kanë qenë në dobi të cilësisë së gjykimit.
- Denoncimet nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova kundër tij në lidhje me kriterin e vlerësimit profesional.
- Mund të ketë bërë gabime me vendime që kanë ndikuar në jetën e njerëzve, por përbëjnë përjashtime dhe nuk janë bërë me qëllim apo me paragjykim.
- Komisioni ka dalë jashtë kompetencës lëndore kur ka vlerësuar se subjekti ka shkelur dispozitat materiale e procedurale, të cilat, sipas tij, mund të vlerësohen vetëm nga gjykatat më të larta, për shkak se ato qëndrojnë të lidhura ngushtë me bindjen e brendshme të gjyqtarit.

32.1. Të gjitha pretendimet e mësipërme janë trajtuar gjerësisht në këtë vendim e përmbledhen si vijon:

32.1.1. Në kundërshtim me sa pretendon subjekti, Komisioni te rezultatet e hetimit, edhe pse jo në mënyrë të shprehur, ia ka bërë prezent problematikat, të cilat mund të çonin në një vlerësim të mundshëm për cenim të besimit të publikut. Kjo vërtetohet nga fakti që subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me cenimin e besimit, gjë që nënkupton që subjekti e ka perceptuar qartë që në fazën e hetimit se problematikat e evidentuara mund të çonin në një konkluzion të tillë.

32.1.2. Në kundërshtim me sa pretendon subjekti, barra e provës është një dhe e vetme dhe vlerësimi i shpjegimeve dhe provave bëhet në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

32.1.3. Në kundërshtim me sa pretendon subjekti, Komisioni, në vendim, ka bërë prezent konkluzionin përfundimtar, lidhur me vlerësimin e kryer mbi dosjet gjyqësore. Vlerësimi i Komisionit ndaj shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit rezulton i shprehur në pikën 196 të vendimit objekt ankimi.

32.1.4. Në kundërshtim me sa pretendon subjekti i rivlerësimit, Komisioni gjetjet dhe konstatimet nuk i ka vlerësuar në drejtim të nivelit kualifikues të aftësive profesionale dhe as e ka ngarkuar subjektin me përgjegjësi disiplinore për këtë kriter.

32.1.5. Në kundërshtim me sa pretendon subjekti i rivlerësimit, Komisioni nuk ka dalë tej kompetencës së tij lëndore, pasi nuk ka vlerësuar mbi themelin e gjykimit të çështjes. Vlerësimi i

Komisionit është fokusuar vetëm në evidentimin e sjelljeve dhe qasjeve të subjektit në mënyrën e administrimit të drejtësisë dhe të shërbimeve gjyqësore që konsistojnë në mosrespektim të dispozitave procedurale e konkretisht:

- cenim të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm [denoncimi nr. {***} prot., datë 04.02.2020, i z. B. I., lidhur me çështjen gjyqësore që i përket shtetasit Y. M., trajtuar në pikën 169/5.1, të vendimit];
- disponime nga subjekti për “kthim padie” pa marrë në konsideratë dokumentacionin e dërguar për plotësimin e të metave të padisë, dokumentacion që administrohej në dosje [denoncimi i z. B. I., lidhur me çështjen gjyqësore që i përket shtetases R. K., trajtuar në pikën 169/5.2 të vendimit];
- shkelje të procedurave ligjore dhe dispozitave procedurale, pasi ka vendosur lënien për rritje dhe edukim të fëmijës së mitur, pa e dëgjuar dhe pa marrë mendim nga psikologu [denoncimi i z. B. I., lidhur me çështjen gjyqësore që i përket shtetasit A. Ç., trajtuar në pikën 170/c të vendimit];
- mosrespektimin e dispozitave procedurale që lidhen me kushtet e të qenit gjyqtar. Subjekti ka marrë pjesë në gjykimin e një çështje në të cilën kishte detyrimin e heqjes dorë, pasi më herët kishte dhënë vendim në gjykimin e kësaj çështje, duke shkelur kështu parimin për zhvillimin e procesit të rregullt nga një gjykatë e paanshme [denoncimi i z. B. I., lidhur me çështjen gjyqësore që i përket shtetasit S. Z., trajtuar në pikën 171/e-172 të vendimit];
- disponime nga subjekti për “kthim padie” me argumentin se pala nuk ka plotësuar të metat e padisë [denoncimi i individëve T. Z. dhe I. B., trajtuar në pikën 169/9 të vendimit];
- dhënie vendimi pa formuar drejt ndërgjyqësinë [denoncimi i z. A. D., trajtuar në pikën 169/17 të vendimit];
- shkelje të parimit të kontradiktoritetit nga subjekti, i cili, në cilësinë e gjyqtarit, ka marrë vendim pa dëgjuar palët ndërgjyqëse, konkretisht të paditurin kundrapaditës, duke mos i dhënë atij mundësinë të parashtrijë pretendimet e konkluzionet përfundimtare në kundërshtim me nenet 18 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile [denoncimi i shtetasit T. M., trajtuar në pikën 169/19 të vendimit];
- disponim për “kthim padie”, me argumentin se mungonin ekstraktet e shoqërisë, duke mosmarrë në konsideratë faktin se ato rezultonin të depozituara bashkëlidhur kërkesës për lëshim urdhri ekzekutimi depozituar nga “Raiffeisen Leasing”, administruar si provë më datë 06.11.2018 [denoncimi i “Raiffeisen Leasing” trajtuar në pikën 169/23 të vendimit].

*C.3.VIII. A. Analiza e shkaqeve të ankimit në lidhje me denoncimin e z. B. I., për çështjen gjyqësore që i përket vendimit nr. {***}, datë 31.01.2019, me palë ndërgjyqëse A. Ç. dhe N. Ç.*

33. Denoncuesi B. I. ka depozituar pesë (5) denoncime, një ndër të cilët lidhet me çështjen gjyqësore civile me palë ndërgjyqëse A. Ç. dhe i paditur N. Ç., me objekt “Zgjidhje martese dhe lënie të fëmijës për rritje e edukim nënës”. Sipas denoncuesit, subjekti i rivlerësimit ka shkelur procedurat ligjore lidhur me njoftimin e palëve, si dhe ka dhënë një vendim në kundërshtim me ligjin. Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të dhënë shpjegime dhe prova në lidhje me rezultatin e hetimit se vendimi i tij i datës 31.01.2019, me palë ndërgjyqëse si sipër referuar [i cili

ka marrë formë të prerë pa u ankimuar nga palët], është dhënë nga subjekti i rivlerësimit në kundërshtim me nenin 6, paragrafi 4 dhe nenet 155 e 267 të Kodit të Familjes. Subjekti ka vendosur lënien për edukim dhe rritje të fëmijës së mitur, pa dëgjuar këtë të fundit në prani të psikologut dhe pa marrë një mendim të psikologut, kërkesë e parashikuar nga neni 273 i Kodit të Familjes.

33.1. Në përgjigjet e dhëna pas kalimit të barrës së provës, rikonfirmuar edhe në ankim e parashtrimet shtesë në Kolegj, subjekti ka pretenduar se palët kanë shprehur në seancë gjyqësore dakordësinë që fëmija t'i lihej për rritje dhe edukim paditëses dhe se kanë qenë dakord të mos kryej ekspertimi psikologjik. Subjekti nuk caktoi ekspert për një sërë arsyesh. Ai ka shpjeguar se nuk ka vepruar në kundërshtim me nenet 6 paragrafi 4, 155, 267 dhe 273 të Kodit të Familjes dhe as me nenin 224/a të Kodit të Procedurës Civile, pasi thirrja e psikologut, kur nuk paraqitet kërkesa e përbashkët sipas nenit 125 të Kodit të Familjes, zbatohet nëse palët kanë mosmarrëveshje për mbajtjen ose për elemente të tjerë që lidhen me interesin e fëmijës. Në ankim, subjekti i rivlerësimit përsërit të njëjtat shpjegime të dhëna kundër rezultateve të hetimit, duke shtuar se Komisioni ka tejkaluar kompetencën e lëndore, sepse ka kryer vlerësimin e kësaj çështje në drejtim të vendimmarrjes së themelit, që lidhet me logjikën dhe bindjen e brendshme të magjistratit, vlerësim i cili mund të kryej vetëm nga një gjykatë më e lartë dhe jo nga organet e rivlerësimit.

33.2. Trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të pambështetur në ligj pretendimin e subjektit se thirrja e psikologut ishte e panevojshme për shkak të dakordësisë së prindërve për lënien e fëmijës nënës. Konkretisht, nisur nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës, Kodi i Familjes, në nenin 6, paragrafi 4⁸², nenin 155, paragrafi i parë⁸³ dhe nenin 157 shkronja “c”⁸⁴ ka bërë rregullime të qarta lidhur me thirrjen e psikologut, *prania e të cilit sipas këtyre dispozitave, është e detyrueshme në çdo procedurë që i përket të miturit*. Parimi i interesit më të lartë të fëmijës është parimi që ka përparësi në vendimmarrjen e gjykatës për zgjidhjen e mundshme të kujdestarit tjetër për fëmijën. Vlerësimin e alternativës më të mirë të mirëqenies së fëmijës, gjykata nuk e bën në bazë të vlerësimit të saj subjektiv, sikundër subjekti pretendon se ka çmuar, por ka detyrimin të thërrasë psikologun, i cili jep mendimin pas kontaktit me fëmijën dhe prindërit⁸⁵. Jo vetëm që bashkëshortët

⁸² “Në çdo procedurë që i përket të miturit, prania e psikologut është e detyrueshme për të vlerësuar thëniet e të miturit, në përputhje me zhvillimin mendor dhe situatën e tij sociale”.

⁸³ Para se gjykata të marrë një vendim të përkohshëm ose përfundimtar lidhur me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, të drejtës së vizitës ose të besuarit të fëmijës nënë ish-bashkëshort, duhet të thërrasë një psikolog ose punonjës social, i cili, para se të japë mendimin, duhet të marrë të dhëna për gjendjen materiale dhe morale të familjes, kushtet në të cilat jetojnë dhe ku është më e përshtatshme të jetojë fëmija.

⁸⁴ Gjyqtari, në këtë rast, merr në konsideratë: a) marrëveshjen e bërë ndërmjet ish-bashkëshortëve; b) mendimin dhe ndjenjat e shprehura nga fëmija i mitur, duke vlerësuar moshën dhe zhvillimin e tij; c) mendimin e psikologut ose të sektorit të shërbimeve sociale pranë bashkisë, pasi këta të kenë dëgjuar fëmijën.

⁸⁵ Shih vendimin nr. 148, datë 21.04.2009, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë: “[...] Në tërësinë e përmbajtjes së vendimit të saj, gjykata është bazuar në arsyetimin se “koha e qëndrimit të nënës me fëmijën e saj, ka qenë shumë e pakët dhe se fëmija për gjithë këtë periudhë është rritur nën kujdesin e të paditurit”, (i ati), duke mos analizuar asnjë provë a pretendim tjetër [...]. Në arsyetimin e vendimit të gjykatës nuk gjen pasqyrim zbatimi i parimeve të Konventës për të Drejtat e Fëmijës (miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, nëntor 1999, si dhe “Deklarata për të drejtat e fëmijës. [...] Parimi i interesit më të lartë të fëmijës është parimi që ka përparësi në vendimmarrjen e gjykatës për zgjidhjen e mundshme të kujdestarit tjetër për fëmijën, duke argumentuar se cila është alternativa më e mirë e mirëqenies dhe e mirëmbajtjes që prindi ka mundësi t'i sigurojë fëmijës, që i shërben interesit më të lartë të fëmijës për rritjen dhe edukimin e tij [...]. Në rishqyrtimin e çështjes, gjykata duhet të marrë mendimin e një grupi ekspertësh psikologë për të dhënë mendimin e tyre me shkrim, pas kontaktit me fëmijën

nuk kanë paraqitur asnjë projekt marrëveshje, sipas përcaktimeve të nenit 125 të Kodit të Familjes, por edhe nëse do të kishin paraqitur një të tillë, gjykata përsëri para se të vendoste mbi mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, kishte detyrim, në bazë të nenit 157 paragrafi “c” të këtij kodi, të merrte në konsideratë edhe mendimin e psikologut.

33.3. Nga ana tjetër, argumentet e subjektit të rivlerësimit se ka vepruar sipas bindjes së tij të brendshme nuk justifikojnë mosrespektimin e detyrimit ligjor për thirrjen e psikologut, sipas përcaktimeve në nenet 6, 155 dhe 157, pasi këto dispozita janë taksative. Mosrespektimi i dispozitave ligjore për thirrjen e ekspertit dhe qasja e subjektit në raport me këtë detyrim ligjor ka rrezikuar interesin më të lartë të fëmijës nga njëra anë dhe nga ana tjetër mund të ketë favorizuar palët, të cilët, sipas tij, nuk kanë dashur të thirret ekspert. Kjo sjellje [e parë edhe në kontekstin e indicieve për favorizim të palëve në proces] ndikon në besueshmërinë e publikut te drejtësia e u pa nga trupi gjykues i Kolegjit e lidhur ngushtë me perceptimin që ka publiku për rëndësinë që i jep subjekti normës ligjore ose me fjalë të tjera, si cenim i besimit të publikut. Nëpërmjet veprimeve të subjektit, i cili relativizon dispozita taksative procedurale, duke u bazuar “në çmuarjen” e tij apo atë që subjekti cilëson bindje të brendshme, është e pamundur të potencohet respekti për normat e detyrueshme ligjore, më së paku.

C.3.VIII.B. Analiza e shkaqeve të ankimit në lidhje me denoncimin e z. B. I., për dy çështje gjyqësore

- 34.** Z. B.I. ka denoncuar edhe dy çështje të tjera të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit. E para i përket palëve R. K. dhe A. Xh. me objekt ndryshimin e *vendbanimit* të fëmijës së mitur nga Shqipëria në Gjermani. Çështja tjetër, me objekt zgjidhje martese, u përket palëve H. K. dhe F. K.. Denoncuesi pretendon se një avokat [O. J.] ka referuar shkelje procedurale të kryera nga subjekti në dhënien e këtyre vendimeve. Sipas denoncimit, subjekti ka dhënë këtë vendim pa njoftuar palët ndërgjyqëse për zhvillimin e procesit gjyqësor. Nga aktet e dosjes së parë rezulton se subjekti më datë 25.10.2019 ka vendosur në mungesë të palëve kthimin e padisë, me argumentin se pala paditëse edhe pas njoftimit nga gjykata, nuk kishte plotësuar të metat e padisë. Komisioni ka konstatuar se në datën 22.10.2019 avokati ka dërguar shkresën në të cilën plotësoheshin të metat. Ky dokument i datës 22.10.2019 rezulton të jetë brenda afatit 5-ditor dhe i është sigluar për veprime gjyqarite Bujar Musta. Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për gjetjen se subjekti i rivlerësimit nuk ka marrë në konsideratë dokumentacionin për plotësimin e të metave të padisë, të depozituar më 22.10.2019 nga përfaqësuesi me prokurë.

34.1. Ndërsa për dosjen tjetër, me palë H. dhe F. K., Komisioni ka konstatuar se subjekti ka dhënë vendimin në mungesë të palëve ndërgjyqëse. Me vendimin e datës 19.11.2019, subjekti ka pushuar gjykimin e çështjes për shkak se palët ishin në mungesë në këtë seancë. Në vendimin e pushimit argumentohet se palët kishin qenë prezent në seancën paraardhëse, duke ardhur në dijeni për seancën vijuese të planifikuar për më datë 19.11.2019. Në vendimin e pushimit specifikohet se palët janë në mungesë, por nuk ka të dhëna për avokatin, i cili përfaqësonte paditësen në prani dhe në mungesë të saj. Nga procesverbalet nuk konstatohet njoftimi i tij. I padituri ka qenë prezent në

dhe prindërit dhe detyrimit të alternativave që ato ngarkojnë për rritjen e fëmijës, duhet pasur parasysh edhe moshën [...]”.

disa seanca gjyqësore të zhvilluara, por nuk ka mundur të japë shpjegime, pasi gjykata nuk kishte verifikuar gjendjen e tij nëpërmjet mjekëve, të cilët ndonëse të njoftuar disa herë, nuk ishin paraqitur dhe as kishin njoftuar për shkakun e ligjshëm të mungesës. Nga mënyra se si është hartuar raporti i rezultateve të hetimit, duket se Komisioni ka prezantuar konstatimet, por *nuk* duket t'i ketë kaluar subjektit barrë prove për këtë çështje.

34.2. Subjekti ka argumentuar për çështjen e parë se padia ishte me të meta në kohën e paraqitjes së saj. Me vendim të ndërmjetëm, kjo çështje u la pa veprim, duke caktuar afatin për plotësimin e tyre. Pasja dijeni prezumohej që nga data 18.10.2019 (nëpërmjet avokatit të saj) dhe, në këto kushte, plotësimi i të metave ishte detyrimi i saj/avokatit. Rezultoi se paditësja/avokati i saj nuk paraqiti në gjykatë një kopje të akteve të përkthyer të kartës së saj të identitetit (që ajo ka aktualisht në Gjermani), që t'i njoftohej palës tjetër. Edhe pse iu dha afat i mjaftueshëm dhe i arsyeshëm për plotësimin e të metave të sipërcituar, këto të meta nuk u plotësuan dhe paditësja nuk provoi shkaqe të përligjura që justifikonin mosplotësimin e kësaj të mete. Për këto shkaqe, subjekti disponoi më datë 25.10.2019, për kthimin e padisë. Ky vendim jopërfundimtar civil ka marrë formë të prerë, pa ankim prej palëve. Subjekti ka bashkëlidhur prapësimeve vendimin e sipër referuar. Ndërsa për çështjen tjetër [palët K.], edhe pse në dukje nuk i është kaluar barrë prove, subjekti ka dhënë shpjegime, të cilat janë të njëjtat me ato të referuara në vendimin e pushimit të dhënë prej tij.

34.3. Në ankim, subjekti nuk ka parashtruar pretendime dedikuar posaçërisht këtyre dosjeve, por i ankimon ato me një grup dosjesh⁸⁶. Subjekti shpjegon në mënyrë të përgjithshme se palët në gjykimet në çështjet e grupuara nuk kanë pësuar dëmtim të interesave procedurale dhe as janë ankuar. Seancat janë planifikuar e zhvilluar me efikasitet dhe në përputhje me dispozitat procedurale. Subjekti i konsideron hipotetike problematikat e referuara, joserioze e as të përsëritura dhe, si të tilla, ato, sipas tij, nuk janë të mjaftueshme për t'u çmuar si cilësi të papranueshme apo për t'i konsideruar si shkelje të të drejtave të palëve.

34.4. Nga sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se shpjegimet e subjektit nuk duket të kenë hedhur dritë apo provuar të kundërtën e gjetjeve konkrete që kishin të bënin me mosmarrjen në konsideratë të dokumentacionit për plotësimin e të metave të padisë, të depozituar nga përfaqësuesi me prokurë më datë 22.10.2019 [në çështjen e parë, R. K.] ndonëse akti i plotësimit ishte sigluar dhe, për rrjedhojë, konfirmuar për marrjen në dorëzim nga subjekti. Për rrjedhojë, ndonëse në këtë rast subjekti është përpjekur të japë disa detaje, ai rezulton të mos ketë përmbysur barrën e provës për zvarritjen e procedurave gjyqësore për detyrimet që palët i kishin përmbushur.

C.3.VIII. C. Analiza e shkaqeve të ankimit në lidhje me denoncimin e z. B. I., për çështjen gjyqësore me palë z. S. Z.

- 35.** Denoncuesi ka referuar në Komision se subjekti i rivlerësimit ka dhënë dy vendime gjyqësore, përkatësisht në datat 03.11.2017 dhe 13.05.2019, duke vendosur “Pranimin e kërkesës”, pa prova dhe dokumentacion ligjor, dhe se me iniciativën e tij subjekti ka ndërruar objektin e padisë.

⁸⁶ E. M. , G. M. , R. K. , H. K. , A. C., S. Z., T. Z., A. D., T. M. , S. T., “{***}” ShA, “{***}” ShPK.

35.1. Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të dhënë shpjegime dhe prova në lidhje me rezultatet e mëposhtme të hetimit administrativ:

- Në çështjen gjyqësore me kërkues S. Z. dhe objekt “Lëshimin e urdhrin të ekzekutimit të debitorit B.D., për detyrimin e tij monetar”, subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. {***}, datë 03.11.2017, ka vendosur rrëzimin e kërkesës me argumentin se akti noterial në atë fazë të shqyrtimit nuk përbënte titull ekzekutiv.
- Objekti i vendimit nr. {***}, datë 13.05.2019, është “Sqarim dhe interpretim të vendimin civil nr. {***}/2017 (L/U Ekzekutimit)”, me bazë ligjore nenin 314 të Kodit të Procedurës Civile, por bashkëlidhur tij është vendimi me të njëjtin numër e datë me të parin nr. {***}, datë 13.05.2019, por objekti i gjykimit këtu nuk është më “Sqarim dhe interpretim të vendimin civil nr. {***}/2017 (L/U Ekzekutimit)”, por është “Lëshimin e urdhrin të ekzekutimit për detyrimin monetar në shumën 700.000 lekë kundër debitorit sipas deklaratës noteriale”, në bazë të neneve 510 e 511 të Kodit të Procedurës Civile. Referuar dispozitivit rezulton se subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin e kërkesës me argumentin se akti noterial në këtë fazë të shqyrtimit përbën titull ekzekutiv.
- Sa më sipër, konstatohet se këto dy vendime, edhe pse mbajnë të njëjtin numër, janë të ndryshëm në objekt kërkimi, bazë ligjore dhe dispozitiv. Fakti që edhe pse të ndryshëm mbajnë të njëjtin numër e datë dhe janë të bashkëlidhur me njëri-tjetrin, duket sikur e vërteton pretendimin e denoncuesit se gjyqtari ka ndërruar me iniciativën e tij objektin e padisë. Subjekti i rivlerësimit duhet të kishte hequr dorë nga shqyrtimi i çështjes të përfunduar me vendimin nr. {***}, datë 13.05.2019, pasi kishte gjykuar më parë çështjen nr. {***} akti, me të njëjtin kërkues e të njëjtin objekt, për të cilën me vendimin nr. {***} datës 03.11.2017, kishte disponuar, duke vendosur “Rrëzimin e padisë”.

35.2. Në përgjigjet e dhëna pas kalimit të barrës së provës, të rikonfirmuara edhe në ankim, subjekti i rivlerësimit ka kontestuar vërtetësinë e pretendimit që ka ndërruar objektin e kërkesës. Shqyrtimi i kërkesës me objekt “Sqarimi dhe interpretimi i vendimit të veçantë civil nr. {***} të vitit 2017”, proceduralisht duhej bërë po nga ai, në cilësinë e gjyqtarit që kishte disponuar me vendimin nr. {***} të vitit 2017, për të cilin kërkohej sqarim dhe interpretim. Gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë për interpretimin e vendimit, ai konstatoi se objekti i kërkimit në thelb ishte lëshimi i urdhrin të ekzekutimit. Subjekti ka pranuar se pas konstatimit të objektit real të kërkimit, *ai nuk duhet të vijonte gjykimin* në kushtet që kishte disponuar me vendimin nr. {***} të vitit 2017, por kjo do të përbënte pengesë ligjore, nëse “Lëshimi i urdhrin të ekzekutimit” do të ishte regjistruar në gjykatë si kërkim më vete. Në kushtet që kjo kërkesë në gjykatë ishte regjistruar me objektin “Sqarim dhe interpretim i vendimit gjyqësor nr. {***} të vitit 2017” dhe jo lëshim urdhri ekzekutimi, subjekti i rivlerësimit shpjegon se nuk legjitimohej për heqje dorë, pasi edhe sikur të hiqte dorë, kjo kërkesë nuk do të pranohej.

35.3. Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon në mënyrë të përmbledhur se: (i) vendimi i vitit 2019 nuk ka qenë përcaktues në zgjidhjen në themel të mosmarrëveshjes midis palëve; (ii) zgjidhja e çështjes ka qenë e drejtë, vendimi i dhënë prej tij nuk ka sjellë pasoja të pariparueshme për palët dhe as ka cenuar të drejtat e ligjshme të palëve; (iii) subjekti nuk ka qenë në rrethanat e konfliktit

të interesit në gjykimin e kësaj çështje; (iv) kjo rrethanë nuk duhej konsideruar si shkelje e parimit të paanësisë në gjykim, pasi gjykimi i çështjes në bindjen e brendshme të tij nuk cenonte parimin e paanësisë dhe, gjithashtu, subjekti ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në lidhje me paanshmërinë e tij; (v) asnjë prej palëve nuk kërkoi përjashtimin e tij nga gjykimi i kësaj çështje; (vi) edhe nëse interpretimi i dispozitave procedurale mbi dorëheqjen ka qenë i gabuar, kjo lidhet me bindjen e tij të brendshme, e cila në asnjë rrethanë nuk ka qenë e qëllimshme; (vii) kjo gjetje e Komisionit nuk duhet konsideruar e atij niveli që të ndikojë në vlerësimin e tij.

35.4. Nga analiza e akteve të mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të pambështetura në akte dhe në ligj. Pretendimi i denoncuesit rezultoi i bazuar. Nga aktet në fashikull konstatohet se çështja gjyqësore konkrete, me kërkues S. Z., ka për objekt “Sqarim dhe interpretim të vendimit civil nr. {***}/2017(L/U Ekzekutimit)”, me bazë ligjore neni 314⁸⁷ të Kodit të Procedurës Civile. Ndërsa, referuar vendimit bashkëlidhur tij⁸⁸, marrë nga subjekti në përfundim të gjykimit të kësaj çështje, objekti i kërkimit i specifikuar në pjesën hyrëse të këtij vendimi nuk është më “Sqarim dhe interpretim të vendimit civil [...] (L/U Ekzekutimit)”, sikundër regjistruar në gjykatë, por “Lëshimi i urdhrin të ekzekutimit për detyrimin monetar në shumën 700.000 lekë kundër debitorit sipas deklaratës noteriale”, në bazë të neneve 510 e 511 të Kodit të Procedurës Civile. Gjyqtari/subjekti ka vendosur pranimin e kësaj kërkesë, jo sipas objektit të kërkuar, por sipas atij të vlerësuar nga vetë gjyqtari.

35.4.1. Duke ndryshuar objektin në “Lëshim urdhri ekzekutimi”, subjekti i rivlerësimit ka marrë iniciativën për të zgjidhur mosmarrëveshje të tjera nga ato për të cilat palët i janë drejtuar gjykatës, duke vepruar kështu në kundërshtim me:

- nenin 6 të Kodit të Procedurës Civile, sipas së cilit: *Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet;*
- nenin 5 të Kodit të Procedurës Civile, sipas së cilit: *Objekti i mosmarrëveshjes përcaktohet në pretendimet e palëve;*
- nenin 185, pika 1 të Kodit të Procedurës Civile, sipas së cilit: *Paditësi, gjatë veprimeve përgatitore, ka të drejtë të paraqesë kërkesë me shkrim për ndryshimin e shkakut të padisë.*
- si edhe në kundërshtim me vendimin unifikues nr. 3, datë 29.03.2012, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, e cila është shprehur qartë mbi rolin e gjykatës në identifikimin e objektit të mosmarrëveshjes, duke vlerësuar se: “[...] përcaktimi i objektit të mosmarrëveshjes që i paraqitet gjykatës për zgjidhje është në disponibilitetin ekskluziv të palëve dhe gjykata nuk mund të ndërhyjë në formulimin e tij. Gjykata nuk ka të drejtë të dalë tej kërkimeve të palëve, që përbëjnë objektin e mosmarrëveshjes, pasi ajo zgjidh mosmarrëveshjen që i paraqitet për gjykim dhe nuk e zgjeron ex officio fushën e gjykimit. [...]”.

⁸⁷ Neni 314 përcakton që: “Sqarimi dhe interpretimi i vendimit”: Gjykata ka të drejtë të japë sqarime ose të bëjë interpretimin e vendimit që ajo ka dhënë kur ky është i errët dhe e kërkojnë palët. Kërkesa për sqarimin dhe interpretimin e vendimit mund të paraqitet në çdo kohë, gjersa vendimi nuk është ekzekutuar. Kundër vendimeve të mësipërme mund të bëhet ankim i veçantë sipas rregullave të përgjithshme”.

⁸⁸ Me nr. {***} akti, datë 13.05.2019.

35.4.2. Nga ana tjetër, edhe sikur për një moment të konsiderohet i mirëqenë pretendimi i subjektit se nga shqyrtimi i kërkesës identifikoi tjetër objekt kërkimi, askund në vendimin nr. {***}, datë 13.05.2019, ai nuk rezulton të ketë kryer arsyetim lidhur me këtë identifikim apo t'i ketë bërë me dije kërkuesit e të jetë marrë mendimi i palëve për kalimin e objektit të kërkimit nga “interpretim vendimi” në “lëshim urdhri ekzekutimi”.

35.4.3. *Së fundmi*, subjekti i rivlerësimit ka shkelur, gjithashtu, kushtet për të gjykuar këtë çështje, pasi edhe sikur në thelb objekti real të kishte qenë lëshimi i urdhrit të ekzekutimit, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin e heqjes dorë për shkak të shfaqjes mendim për çështjen në gjykim më herët në vendimin nr. {***}, datë 03.11.2017 dhënë prej tij, me të cilin ka vendosur rrëzimin e kërkesës me argumentin se akti noterial në atë fazë të shqyrtimit nuk përbënte titull ekzekutiv. Mbi të gjitha, heqja dorë nga gjykimi i çështjes, detyrim ligjor i përcaktuar në mënyrë taksative nga ligji procedural, nuk lidhet me bindjen e brendshme të gjyqtarit, sikundër pretendon subjekti në ankim. Po ashtu, edhe pretendimi se palët nuk kanë kërkuar përjashtimin e tij, nuk përlligj shmangien e subjektit të rivlerësimit nga detyrimi ligjor për heqjen dorë, nëse ndodhet në kushtet e parashikuara nga ligji.

C.3.VIII.D. Analiza e shkaqeve të ankimit në lidhje me denoncimin e z. B. I., për çështjen gjyqësore me palë z. Y. M.

36. Denoncuesi ka referuar në Komision një tjetër çështje të gjykuar nga subjekti i rivlerësimit me palë z. Y. M.⁸⁹. Me rezultatet e hetimit, Komisioni ka bërë me dije subjektin se nga shqyrtimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese, rezulton se kërkuesi/denoncuesi i është drejtuar kësaj gjykate për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Ai ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit e ka zvarritur çështjen gjyqësore duke e vonuar 24 muaj gjykimin e saj. Sipas kërkuesit, edhe KLD-ja ka konstatuar se gjykimi i kësaj çështjeje nuk ka përfunduar brenda afateve të standardizuara në vendimin e saj të vitit 2010 [nr. {***}, datë 14.04.2010]. Gjykata Kushtetuese ka konkluduar se zvarritja e procesit, që ka ardhur për shkak të planifikimit dhe organizimit jo të mirë të punës nga ana e gjyqtarit, ka cenuar të drejtat kushtetuese të palëve për realizimin e procesit brenda një afati të arsyeshëm kohor. Pas rihedhjes së shortit, më datë 09.12.2012, subjekti është përjashtuar nga gjykimi i çështjes në datën 08.07.2014 dhe është zëvendësuar me një gjyqtare tjetër. Gjatë kohës që në Gjykatën Kushtetuese po shqyrtohej kërkesa e të njëjtës palë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka marrë vendim në lidhje me çështjen e themelit, duke vendosur më datë 27.03.2015, rrëzimin e kërkesëpadisë. Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se: “[...] pretendimi i kërkuesit është i bazuar dhe duhet pranuar, pasi si rrjedhojë e mosgjykimit brenda afatit të arsyeshëm atij i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, e parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i KEDNj-së. [...]”. Në përfundim, kjo gjykatë, me vendimin e sipërcituar, ka vendosur pranimin e kërkesës. Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e këtyre konstatimeve. Në prapësimet kundër rezultateve të hetimit, subjekti

⁸⁹ Denoncuesi ka përcjellë në Komision edhe vendimin nr. 56/2015, të Gjykatës Kushtetuese, që i përket çështjes me kërkues këtë palë.

në mënyrë të përmbledhur ka potencuar se ka mendim të ndryshëm nga ai i shprehur në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, dhe në thelb është dakord me mendimin e pakicës në këtë vendimmarrje. Sipas subjektit, gjykimi mund të jetë zhvilluar tej afateve, por jo për shkaqe që lidhen me kryerjen e detyrës prej tij. Shkaqet që kanë diktuar shtyrjen e seancave lidheshin me rrethana përtej kontrollit të tij: palët ndodheshin jashtë shtetit e duheshin njoftuar me shpallje, përfaqësimi i palës përkatëse kishte të meta, palët e pranishme përfshirë edhe paditësi, duhet të paraqisnin provat e pretenduara dhe duheshin thirrur palët e interesuara. Një tjetër faktor që ka ndikuar ishte edhe ngarkesa e madhe e çështjeve që kishte në gjykim.

36.1. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se ndërsa në pikën 33 të ankimit subjekti ka listuar dosjet civile⁹⁰, për të cilat rikonfirmon se u qëndron të njëjtave shkaqe ankimi të parashtruara kundër rezultateve të hetimit, në përmbajtje të ankimit e të parashtrimeve shtesë të depozituara në Kolegj nuk evidentohen të shprehura kundërshti apo pretendime konkrete në lidhje me këtë çështje gjyqësore. Sidoqoftë, trupi gjykues mori në analizë pretendimet e ngritura pas kalimit të barrës së provës, të cilat përveçse subjektive e të pabazuara në prova i vlerëson edhe të pambështetura në vendimin e sipërcituar të Gjykatës Kushtetuese. Konkretisht, nga shqyrtimi i vendimit të sipërcituar, rezulton se Gjykata Kushtetuese ka evidentuar rrethanat vijuese:

36.1.1. Fakti i zvarritjes së gjykimit është vënë në dukje edhe nga KLD-ja, e cila kishte nisur një hetim, bazuar në kërkesën ankimore të kërkuesit Y. M. ndaj veprimeve të subjektit të rivlerësimit. Sipas ankuesit, ky institucion ka konkluduar se nga subjekti i rivlerësimit është shkelur e drejta për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

36.1.2. Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se çështja që po gjykonte subjekti i rivlerësimit nuk paraqet kompleksitet nga pikëpamja faktike e juridike dhe as volum të konsiderueshëm shkresor dhe se nuk jemi në kushtet e rrethanave të veçanta që mund të justifikojnë vonesën në zhvillimin e gjykimit. Ky konstatim i Gjykatës Kushtetuese i jep përgjigje dhe rrëzon të gjitha pretendimet e subjektit se çështja paraqitej komplekse e voluminoze.

36.1.3. Pasi mori në vlerësim edhe sjelljen e kërkuesit Y. M. e atë të subjektit të rivlerësimit, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale dhe nuk rezulton që ai të jetë bërë pengesë për zhvillimin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Sipas saj, ka qenë pikërisht sjellja e autoriteteve shtetërore që ka shkaktuar zvarritjen e procesit në dëm të kërkuesit.

36.1.4. Në përfundim, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se pretendimi i kërkuesit është i bazuar, atij i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor e parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i KEDNj-së, si rrjedhojë e mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

36.2. Për sa më sipëranalizuar, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se rasti në fjalë evidenton shkelje, të cilat nga pikëpamja e vlerësimit profesional [nëse do të ishte kryer] do të përbënin problematika

⁹⁰ K. T.; B. I. (për 5 denoncimet e tij); T. Z. e I. B.; R. A.; Studio ligjore “{***}”; A. D.; T. M.; Z. T.; Gj. Gj.; “{***}” dhe E. K.; për dosjet e veçanta penale të vitit 2017 me numra ai {***}, {***}, {***}, {***}, {***}, {***}, {***}; për çështjet civile nr. {***} akti/viti 2020 dhe nr. {***} akti /viti 2020, që u përkasin palëve M. D. e T. D., me objekt zgjidhje martesë etj.

serioze. Nga ana tjetër, ringritja në ankimin kundër vendimit të Komisionit e të njëjtave pretendime, për të cilat subjekti ka marrë përgjigje në mënyrë shteruese nga Gjykata Kushtetuese në vendimin e sipërcituar, vlerësohet nga trupi gjykues se plotëson panoramën e pabesueshmërisë së subjektit dhe u mbajtën në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes, si veprime që cenojnë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

C.3.VIII.E. Analiza e shkaqeve të ankimit në lidhje me denoncimin e z. E. K.

37. Denoncuesi ngre pretendime në lidhje me disa çështje gjyqësore të gjykuara nga ana e subjektit të rivlerësimit. Sipas denoncuesit: (i) subjekti ka kryer shkelje procedurale në çështjen me palë K. H. dhe “{***}”; (ii) zvarritje të procesit gjyqësor me palë M. D. dhe T. D.; (iii) ka treguar njëanshmëri në zgjidhjen e konflikteve gjyqësore në çështjet e inceneratorëve të Elbasanit, duke vendosur heqjen e sekuestrove të llogarive bankare për shoqëritë tregtare të përfshira në këto çështje; (iv) subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të vazhdueshme e të padrejtë, u kthen paditësve padinë pa e zgjidhur çështjen në themel, sikurse ka vepruar edhe në çështjen gjyqësore me palë M. L..

37.1. Në pikën 33 të ankimit, subjekti i rivlerësimit, për denoncimet e depozituara në Komision [ndër të cilët rendit edhe dosjet e denoncuesit E. K.], shprehet se u qëndron pretendimeve e argumenteve të parashtruara në prapësimet kundër rezultateve të hetimit. Subjekti pretendon tejkalim kompetence nga ana e Komisionit, sepse ka bërë vlerësim mbi bindjen e brendshme të gjyqtarit, si edhe për vendim të paarsyetuar, pasi nuk kuptohet cili ka qenë konkluzioni i Komisionit për secilën dosje pas dhënies së shpjegimeve nga ana e subjektit.

37.2. Në verifikim të këtyre pretendimeve, trupi gjykues i Kolegjit, pasi mori në shqyrtim vendimin e Komisionit, raportin e rezultateve të hetimit dhe parashtrimet e depozituara nga subjekti kundër rezultateve të hetimit, konstatoi si vijon.

37.2.1. Në lidhje me dosjet e inceneratorëve, subjekti në mënyrë të përmbledhur ka shpjeguar se: (i) denoncuesi nuk ka asnjë interes të drejtpërdrejtë në këto çështje; (ii) këto dosje i janë kaluar për veprim nga kryetari i gjykatës dhe kancelari; (iii) asnjëra prej palëve kërkuese nuk është favorizuar prej tij, pasi vendimi i dhënë për secilën prej dosjeve ka lidhje vetëm me objektin e kërkimit për heqjen e sekuestros mbi llogaritë bankare dhe, si të tilla, nuk janë vendime që i zgjidhin çështjet në themel. Referuar vendimit objekt ankimi⁹¹, vërehet se Komisioni nuk ka bërë analizë në lidhje me pretendimin e denoncuesit për njëanshmëri të subjektit, por është mjaftuar vetëm me relatimin e rrethanave të konstatuara në lidhje me procedurat e shortit. Nga mënyra se si është shprehur Komisioni, vetëm në drejtim të shortit dhe në konsideratë të faktit që shqyrtimi i këtyre dosjeve është bërë në verifikim të pretendimeve të denoncuesit për njëanshmëri të subjektit dhe jo në lidhje me shpërndarjen ose jo me short të çështjeve gjyqësore, trupit gjykues të Kolegjit nuk i rezulton që subjekti i rivlerësimit të jetë ngarkuar me përgjegjësi e pasoja ligjore për këto dosje.

⁹¹ Në kreun e denoncimeve nga publiku, pika 24, Komisioni ka arsyetuar se nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, rezultoi se kryetari i kësaj gjykate i ka kaluar manualisht për gjykim subjektit të rivlerësimit, shtatë çështjet gjyqësore me objekt: “Kundërshtimi i vendimit të sekuestros të Prokurorisë të Rrethit Gjyqësor Elbasan”.

37.2.2. Në lidhje me çështjen gjyqësore civile me palë K. H. dhe personin juridik privat “{***}”, administratori i së cilës [sipas subjektit] është vëllai i denoncuesit, subjekti ka prapësuar se kjo çështje është marrë pa short, seancat janë shtyrë për shkaqe të domosdoshme të pavarura prej tij të tilla si: sjellja e organeve shtetërore vendore, objekti voluminoz i kërkimeve dhe volumi i madh i akteve për administrim. Sipas subjektit, palët kanë marrë dijeni për vendimet e ndërmjetme, duke pasur mundësinë e ankimit. Ai është kujdesur të zhvillojë një proces të rregullt gjyqësor dhe të kryejë një hetim të plotë e të gjithanshëm, në përputhje me ligjin dhe interesin e palëve. Trupi gjykues i Kolegjit, njëjtë si Komisioni, vlerëson se këto shpjegime janë dhënë në mënyrë të përgjithshme pa argumentuar e provuar me dokumentacion cilat ishin veprimet ose mosveprimet konkrete të institucioneve shtetërore apo rrethanat e tjera që diktuan nevojën për shtyrjen e seancave gjyqësore.

37.2.3. Për çështjen gjyqësore me paditës M. D. e paditur T. D. dhe objekt padie “Zgjidhje martese”, Komisioni ka veçuar si problematikë konstatimin se në vendimet e marra në vitet 2020 dhe 2021, subjekti ka vendosur kthimin e padisë me argumentimin se në momentin e depozitimit, padia ka pasur të meta. Ndërsa për dosjen me palë ndërgjyqëse, paditëse M. L. e paditur Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe objekt “Njohje e vërtetësisë së aktit etj.”, Komisioni ka evidentuar faktin se vendimet i janë dërguar palës paditëse në mungesë, por së paku jo në adresën e përshkruar në vendim. Subjekti ka prapësuar se denoncuesi E. K. nuk ka asnjë interes të drejtpërdrejtë dhe se u qëndron të njëjtave veprime procedurale e të njëjtave vlerësime mbi të cilat ka disponuar në këto vendime gjyqësore civile. Në parashtrimet shtesë të datës 23.12.2022, subjekti i rivlerësimit, në lidhje me konstatimin për dosjen me palë M. L., pretendon se nuk është gjyqtari ai që njofton vendimet e gjykatës, por Kryesekretaria e gjykatës, ndërsa për gjetjet në lidhje me dosjen me palë M. dhe T. D., pretendon se ankesa e shtetasit M. D. është shqyrtuar edhe nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i cili me vendimin nr. {***} prot., datë 28.07.2022, ka vendosur arkivimin e kësaj ankese.

37.2.4. Në verifikim të këtyre pretendimeve, trupi gjykues vëren:

- Sipas Komisionit, vendimet për kthimin e padisë nuk i janë komunikuar palëve në adresën e përshkruar në vendim. Trupi gjykues konstaton se në këto vendime adresat e palëve nuk janë specifikuar të plota, por vetëm si qytet, në njërin çështje [me palë M. dhe T. D.], ndërsa në tjetrën, paditësja M. L. është në mungesë dhe nuk specifikohet asnjë adresë. Mosspecifikimi i adresave nga palët ka qenë një ndër argumentet e arsyetuara nga subjekti në këto vendime, si shkak ligjor për kthimin e padisë.
- Nga ana tjetër, referuar dëftesave të komunikimit, vërehet se vendimet nr. {***}, datë 22.09.2020 dhe nr. {***}, datë 19.01.2021, “Për kthimin e padisë”, i janë komunikuar përfaqësuesit ligjor të paditësit M. D.. Po kështu, edhe vendimi tjetër nr. {***}, datë 14.07.2020, është komunikuar në adresë të mbrojtësit ligjor të paditëses M. L.. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të pambështetur në akte konstatimin e Komisionit se vendimet i janë dërguar palës paditëse në mungesë, por së paku jo në adresën e përshkruar në vendim. Në kushtet që palët kanë qenë të përfaqësuara me avokat, njoftimi i kryer në adresë të këtyre të fundit vlerësohet nga trupi gjykues se nuk përbën shkelje të procedurave gjyqësore, në kuptim të nenit 316 të Kodit të Procedurës Civile. Megjithatë trupi gjykues nënvizon si jo

serioz shpjegimin e subjektit se njoftimi i vendimit nuk është detyrë e gjyqtarit por e kryesekretarisë. Në mungesë të specifikimit të adresave të palëve në vendim, e vetmja adresë që i mundësonte sekretarisë njoftimin e vendimit ka qenë ajo e mbrojtësit ligjor, dhe, në këto kushte, nuk ka gabuar kryesekretaria, sikundër përpiqet subjekti ta trajtojë. Për më tepër, ky pretendim është i pabazuar edhe në nenin 128 të Kodit të Procedurës Civile, sipas së cilit është gjyqtari ose kryetari i trupit gjykues të çështjes ai që kujdeset dhe kontrollon procesin e njoftimit, që kryhet nga punonjësit e gjykatës të caktuar për realizimin e tij. Ky përcaktim ligjor rrëzon pretendimin e subjektit se njoftimi nuk është përgjegjësi e tij. Ky pretendim i ngritur edhe për çështje të tjera gjyqësore që kanë rezultuar me të tillë problematikë, jo vetëm që nuk përbën argument ligjor bindës dhe nuk e justifikon subjektin e rivlerësimit, por në të kundërt, evidenton qëndrimin dhe qasjen e tij ndaj procesit të njoftimit, të cilin, duke e konsideruar si përgjegjësi të punonjësve të gjykatës, e përjashton nga përgjegjësia e gjyqtarit, ndërkohë që në bazë të nenit 128 të Kodit të Procedurës Civile, kontrolli i këtij procesi është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e gjyqtarit të çështjes.

37.2.5. Së fundmi, me parashtrimet shtesë të datës 23.12.2022, subjekti i rivlerësimit potencon se ankesa e z. M. D. është shqyrtuar edhe nga ana e ILD-së, e cila, në përfundim të shqyrtimit, e ka gjetur këtë ankesë në kushtet e papranueshmërisë dhe, për këtë arsye, e ka arkivuar me vendimin nr. {***} prot., datë 28.07.2022. Me pretendimin se është provë e re, e disponuar pas vitit 2021 të dhënies nga Komisioni të vendimit përfundimtar dhe ekzistenca e kësaj prove ka lidhje me faktet e shqyrtuara prej Komisionit për këtë çështje civile, subjekti i rivlerësimit i kërkon Kolegjit të lejojë marrjen e kësaj prove. Në përgjigje të kësaj kërkesë, trupi gjykues vlerësoi si vijon:

- *Së pari*, vendimi nr. {***} prot., datë 28.07.2022, i ILD-së, u vlerësua se ndonëse duket që plotëson kërkesat e provave të reja në ankim, në kuptim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, ai është pa peshë për të ndryshuar zgjidhjen e çështjes në tërësi dhe në vlerësimin tërësor veçmas në kuptim të nenit 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.
- *Së dyti*, nga shqyrtimi i vendimit të ILD-së, vërehet se problematikat e referuara nga ankuesi R. R./përfaqësuesi ligjor i M. D., konsistojnë në mënyrë të përmbledhur në: (i) vendimmarrje abuzive në shkelje të flagrante të ligjit, pasi kërkesëpadia është kthyer për plotësim të metash, në një kohë që padisë nuk i mungonte asnjë nga kriteret e parashikuara në nenin 154/a të Kodit të Procedurës Civile; (ii) zvarritje e gjyqit dhe se marrja e vendimit për “kthim padie” ka shkaktuar për paditësin pasoja kohore [zgjatje kohe] dhe shpenzime të tjera [shkaktim dëmi].
- *Së treti*, vendimi i ILD-së për arkivimin e ankesës vlerësohet nga trupi gjykues pa relevancë për rastin e ankimit në Kolegj. Arkivimi i ankesës është bazuar në arsyetimin se nuk evidentohen të dhëna, të cilat përbëjnë shkelje disiplinore, sipas parashikimeve të bëra nga nenet 101,102,103 dhe 104 të ligjit nr. 96/2016 dhe që ankesa nuk përmbush kriteret e pranueshmërisë referuar nenit 120, pika 1, shkronjat “d” dhe “dh” të ligjit nr. 96/2016. Ndërkohë, referuar rezultateve të hetimit dhe pikës nr. 24 të vendimit objekt ankimi, rezulton se Komisioni e ka vënë theksin e konstatimeve jo te disponimi i subjektit për kthimin e padisë, por te mënyra e njoftimit të vendimit. Për këtë të fundit, duket se ka kërkuar shpjegime nga subjekti, konstatim i cili, si më lartreferuar, duket i pambështetur në dokumentacion, pasi rezulton t’i jetë komunikuar në adresë të mbrojtësit të tij. Megjithatë

edhe sikur të provohej kjo gjetje, përsëri do të mbetej në nivelin e një konstatimi modest që nuk do të sillte si pasojë penalizimin e subjektit edhe për shkak se është në drejtim të aftësive profesionale, kriter ky i pavlerësuar.

C.3.VIII. F. Analiza e shkaqeve të ankimit në lidhje me denoncimin e z. Gj. Gj.

38. Referuar paragrafit 22 të vendimit, në verifikim të pretendimeve të denoncuesit për zvarritje të procesit gjyqësor nga ana e subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka marrë në shqyrtim denoncimin në fjalë, shkresën⁹² e KLD-së për fillimin e hetimit disiplinor për zvarritje të çështjes penale nr. {***} akti, datë 06.06.2017, si edhe dokumentacionin e përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Nga shqyrtimi i këtyre akteve, Komisioni ka konstatuar se: (i) subjekti i rivlerësimit ka pasur për gjykim një çështje gjyqësore me kërkues Gj. Gj. dhe me objekt kundërshtimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal. Për këtë çështje gjyqësore të zhvilluar në mungesë të kërkuesit Gj. Gj., subjekti i rivlerësimit ka disponuar me vendimin nr. {***}, datë 19.01.2011, duke vendosur mosshqyrtimin e kërkesës. Ky vendim është prishur nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. {***}, datë 21.06.2012. Gjykata e Apelit ka vlerësuar se gjykata e faktit, pa asnjë bazë ligjore ka vendosur mosshqyrtimin e kërkesës, me arsyetimin se kërkuesi Gj. Gj., ndonëse ka pasur dijeni për zhvillimin e seancës, nuk është paraqitur pa ndonjë shkak të arsyeshem. Gjykata e Apelit ka arsyetuar, në këtë vendim, pas konstatimit të mosparaqitjes së kërkuesit, se subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin ligjor të vazhdonte gjykimin e çështjes e të shprehej me një vendim përfundimtar për zgjidhjen në themel të kërkesës; (ii) ndërsa në një tjetër gjykim me të njëjtin kërkues, por me objekt kundërshtimin e vendimit të prokurorisë për pushimin e çështjes penale në procedimet penale nr. {***}, të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit ka disponuar me vendimin nr. {***}, datë 08.05.2014, duke vendosur rrëzimin e kërkesës, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. {***}, datë 18.01.2016.

38.1. Me raportin e rezultateve të hetimit, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të dhënë shpjegime e provuar të kundërtën e konstatimeve, përmbledhur si vijon: (i) çështja gjyqësore është mbajtur për gjykim për një interval kohor prej 7 muaj e 10 ditë, deri në datën 17.01.2018, në të cilën subjekti ka paraqitur kërkesën për dorëheqje. Mbajtja e çështjes pa u përfunduar nga gjyqtari, për një periudhë të tillë kohore, është në kundërshtim me afatin 2-mujor të përcaktuar në aktet e KLD-së për çështje të kësaj natyre; (ii) subjekti ka rrëzuar kërkesën e palës [denoncuesit] për heqjen dorë të gjyqtarit nga gjykimi i kësaj çështje dhe më pas [thujse pas 4 muajsh apo 9 seancash gjyqësore] vetë gjyqtari ka kërkuar heqjen dorë nga gjykimi i çështjes edhe pse kohë më parë ka qenë i njohur me shkaqet e parashtruara nga ankuesi.

38.2. Në ankim, subjekti shprehet se u qëndron parashtrimeve kundër rezultateve të hetimit se ndonjë zvarritje që ka ndodhur lidhej me shtyrje për shkaqe të përligjura e të domosdoshme dhe jo me sjellje të subjektit, e cila ka qenë korrekte dhe në përputhje me dispozitat procedurale; afatet e gjykimit të përcaktuara në aktet e miratuara nga KLD-ja nuk ishin detyruese, por orientuese dhe, në këtë kuptim, në rastin e mosrespektimit të tyre duhej mbajtur në konsideratë edhe rrethana të tjera si specifika e çështjes konkrete apo ngarkesa e punës, e cila pretendohet të ketë qenë tejet e

⁹² Shkresë nr. {***} prot., datë 13.12.2018, bashkëlidhur denoncimit.

lartë në rastin e tij. Subjekti shprehet në lidhje me heqjen dorë se u qëndron deklarimeve të dërguara në KLD, në të cilat ka shpjeguar se nuk e ka dhënë dorëheqjen në momentin e kërimit nga pala, në konsideratë të faktit se në vendimin nr. {***}, datë 08.05.2014, ai nuk kishte shprehur mendim për nenin 199/a/1 të Kodit Penal, e cila, sipas tij, ishte akuzë e re e pretenduar nga kërkuesi. Më pas, në janar të vitit 2018, kur erdhi në dijeni të ndryshimit të praktikës së KLD-së për trajtimin e çështjeve të kësaj natyre, ai kërkoi heqjen dorë.

38.3. Fillimisht trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje faktin se ILD-ja ka përcjellë⁹³ në Kolegji, vendimin nr. {***} prot., datë 12.01.2023 *“Për pezullimin e hetimit disiplinor me nismë të ankuesit Gj. Gj., ndaj magjistratit Bujar Musta, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan”*. Përmes këtij vendimi, është vendosur pezullimi i hetimit disiplinor deri në dhënien e vendimit nga Kolegji mbi ankimin e subjektit të rivlerësimit. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se ankesa e depozituar nga denoncuesi, për të cilën është vendosur pezullimi, nuk përbën pengesë ligjore për trajtimin në Kolegji, të pretendimeve të paraqitura në Komision nga i njëjti denoncues.

38.4. Në verifikim të pretendimeve të potencuara nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson si vijon:

38.4.1. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, në lidhje me pretendimin e denoncuesit për zvarritjen e procesit të gjyqimit, bazohen në argumente të përdorura në mënyrë të përgjithshme e të përsëritur për të gjitha çështjet e ankimuara. Edhe duke abstraguuar nga mosrespektimi i afatit dymujor për shqyrtimin e çështjeve gjyqësore të kësaj natyre, të cilin subjekti e pretendon si afat orientues dhe jo detyrues, subjekti nuk argumenton, e aq më pak provon, se cilat ishin rrethanat konkrete apo shkaqet e përlligjura e të domosdoshme, që përbënin pengesë ligjore për vijimin e rregullt të seancave gjyqësore të kësaj çështjeje. Në këto kushte, pretendimet e subjektit u vlerësuan nga trupi gjykues si subjektive e të pambështetura në ligj e akte.

38.4.2. Shpjegimet në lidhje me konstatimin për mos heqjen dorë që në momentin që është kërkuar nga pala [në çështjen gjyqësore nr. {***} akti, datë 06.06.2017], përveçse konfuze, duken edhe të pambështetura në dokumentacion. Nga aktet rezulton se subjekti i rivlerësimit, përveç kësaj dosje, ka pasur në shqyrtim edhe çështjen penale me kërkues Gj. Gj. kundër Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, e znj. N. P., me objekt *“Ankim kundër vendimit, datë 22.05.2013, për pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2012”*. Në përfundim të shqyrtimit të kësaj çështjeje, subjekti i rivlerësimit ka disponuar me vendimin nr. {***}, datë 08.05.2014, duke vendosur rrëzimin e kërkesës. Nga analiza e këtij vendimi konstatohet se procedimi penal nr. {***} i vitit 2012, është regjistruar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 150, 277 dhe 199/a të Kodit Penal. Sipas arsytimit të gjyqtarit/subjektit në këtë vendim, rezulton se gjatë kryerjes së hetimeve në lidhje me procedimin penal nr. {***} të vitit 2012, prokurori i çështjes ka çmuar kryesisht se është kryer edhe vepra penale *“Ndërtim i paligjshëm”*, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal. Kjo rrethanë e arsytuar nga vetë subjekti në vendim hedh poshtë pretendimin se është akuzë e re

⁹³ Me shkresën nr. {***} prot., datë 12.01.2023, *“Njoftim për pezullimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit Bujar Musta, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan”*.

për të cilën nuk ka paraqitur mendim. Në konsideratë të këtyre rrethanave, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të drejtë konstatimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka qenë në shkelje të nenit 17, pika 1, germa “c” dhe nenit 18, pika 1, germat “a” dhe “b” të Kodit të Procedurës Penale, në bazë të të cilave ka pasur detyrimin për heqje dorë për shkak se ekzistojnë arsye njëanësie, për shkak të dhënies mendim më herët, në vendimin nr. {***}, datë 08.05.2014.

C.3.VIII.G. Analiza e shkaqeve të ankimit në lidhje me denoncimin e z. E. B.

39. Komisioni ka marrë në shqyrtim rastin e denoncuar nga E. B, i cili pretendonte se subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës 24.01.2014, ka vendosur kthimin e padisë së denoncuesit padrejtësisht. Në parashtrimet shtesë të datës 20.01.2025, subjekti i rivlerësimit i kërkon Kolegjit që shqyrtimi i këtij rasti të bëhet në seancë gjyqësore publike, për shkak të një prove të re shkrese të administruar pas dhënies së vendimit të Komisionit, e konkretisht, shkresa e ILD-së nr. {***} prot., datë 22.05.2023, “Për arkivimin e ankesës së z. E. B.”.

39.1. Në verifikim të kërkesave të mësipërme, trupi gjykues, pasi shqyrtoi vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi, raportin e rezultateve të hetimit dhe shkresën e sipërcituar të ILD-së, vlerëson si vijon:

39.1.1. Në raportin e rezultateve të hetimit, për këtë dosje është pasqyruar vetëm si rrethanë fakti që pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, është regjistruar kallëzimi penal nr. {***}, i datës 06.02.2019, i denoncuesit E. B., për të cilën kjo prokurori ka vendosur “*Mosfillimin e procedimit penal nr. {***}, datë 06.02.2019, pasi fakti nuk ekziston*”. Përveç rrethanës së kallëzimit penal, Komisioni nuk e ka ngarkuar me barrë prove subjektin e rivlerësimit. Edhe në faqen 56, Komisioni ka njoftuar subjektin e rivlerësimit se është depozituar një denoncim nga z. E. B. dhe pretendimin e tij. Komisioni shprehet po ashtu se, pasi kreu verifikimet përkatëse, *nuk pa indicie për thellimin e hetimit* dhe, për rrjedhojë, nuk e ka ngarkuar subjektin me barrë prove. Për rrjedhojë, trupi gjykues e vlerëson të panevojshme të ndalet më tej në këtë denoncim, në pretendimet e subjektit apo në rezultatin e ankimit të denoncuesit në ILD.

39.2. Sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se ndonëse vendimi i sipërcituar i ILD-së, në dukje i plotëson kërkesat e provave të reja me ankimin, në kuptim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, në një lexim harmonik edhe me nenin 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 e nenin 49, pika 6 të ligjit nr. 84/2016, marrja e këtij dokumenti nuk ka asnjë peshë në zgjidhjen e çështjes.

40. Në përfundim të verifikimeve të kryera, në lidhje me kriterin e vlerësimit profesional dhe atë tërësor të çështjes, trupi gjykues i Kolegjit vëren se konkluzioni i Komisionit, kryer në vijim të analizës për kriterin e vlerësimit tërësor, është i bazuar. Subjekti i rivlerësimit me veprimet e tij ka cenuar besimin e publikut në një mënyrë që është i papërshtatshëm për të vijuar me ushtrimin e detyrës. Nga ana tjetër, mangësitë e vërejtura tregojnë se subjekti paraqet problematika, të cilat nuk mund të korrigjohen nëpërmjet trajnimit në Shkollën e Magjistraturës. Ky konkluzion mbështetet në konstatimet e shtjelluara në vijim.

40.1. Subjekti ka treguar mangësi në kryerjen e procedurave gjyqësore dhe arsyetimin e vendimeve, ka treguar mangësi organizative dhe ka cenuar të drejtat e palëve në proces. Këto mangësi nuk rezultojnë të jenë pasojë e mungesës së njohurive, pasi problematikat e konstatuara dhe mënyra sesi subjekti ka zgjedhur të shpjegojë veprimet e tij tregojnë veprime e mosveprime, të cilat pasqyrojnë zgjedhje të tij. Ndërsa mangësitë e konstatuara në dosjet gjyqësore të shqyrtuara në Komision, edhe në analizën e kryer në Kolegj, u konsideruan të qenësishme, trupi gjykues mban në vëmendje edhe rrethanat vijuese:

40.1.1. Vlerësimi i këtyre aspekteve të aftësisë profesionale, me fokus qasjen e subjektit të rivlerësimit në mënyrën sesi ai ka administruar drejtësinë, edhe nga analiza e kryer në Kolegj, tregon problematika që konsistojnë në mosrespektim të dispozitave procedurale për efikasitetin në gjykim, në formën e zvarritjeve, mosgjykim brenda një afati të arsyeshëm me pasojë cenim të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, disponime për kthim padie, pa marrë në konsideratë dokumentacionin e dërguar për plotësimin e të metave të padisë, shkelje të procedurave ligjore dhe dispozitave procedurale të detyrueshme për zbatim për të garantuar mbrojtjen e interesit të të miturit, mosrespektimin e dispozitave procedurale që lidhen me mbrojtjen në procesin penal, ndër të tjera. Analizuar në harmoni, veprimet e subjektit kanë treguar problematika që bien ndesh me pritshmërinë e publikut për paanësinë e integritetin e një gjyqtari.

40.1.2. Përpos sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë edhe që në shpjegimet e dhëna në hetimin administrativ apo përgjatë ankimit, subjekti i rivlerësimit paraqet argumente që janë në mospërputhje me standardin e përgjegjësisë për të respektuar ligjin që pritet nga një magjistrat karriere, qoftë në drejtim të mungesës së vlerësimit të rëndësisë kyçe që kanë garancitë procedurale të palëve në gjykim apo në peshën e pabazuar që shpjegimet e prapësimet e tij i atribuojnë aspekteve të cilësuar prej tij si “bindje e brendshme”. Konkretisht, në shpjegimet e tij, subjekti paraqet një panoramë, sipas së cilës bindja e tij përkon me një standard “paprëshmërie” e mungesë llogaridhënieje në bazë të ligjit që i lejon edhe anashkalimin e detyrimeve me natyrë procedurale që ndjek gjykata. Reduktimi i detyrës së gjyqtarit për të respektuar dispozitat procedurale *ne alternative* apo si diskrecion, në varësi të bindjes së tij “të brendshme”, në terma praktikë cenon të drejtat e palëve për një proces të rregullt gjyqësor dhe dëmton interesat e tyre.

40.2. Kontestimi i detyrimit për të zbatuar dispozitat procedurale apo vendosja e tyre në nivel zgjedhjeje, duke i dhënë përparësi vullnetit të tij, sipas rastit nga subjekti, u vlerësua nga trupi gjykues i Kolegjit si një vijë sjelljeje e papranueshme për një gjyqtar. Për rrjedhojë, sjellja e subjektit ndikon në besueshmërinë te figura e magjistratit dhe në pikë fundore cenon besimin e publikut te drejtësia.

40.3. Për sa më sipër, në vlerësimin e sjelljes së subjektit gjatë kryerjes së detyrës, sikurse ka rezultuar nga hetimi i dosjeve të gjetura me problematika, por edhe qasjen e tij në dhënien e shpjegimeve në konsideratë të vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë e, për rrjedhojë, vlerëson se ndaj tij duhet të aplikohet neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

41. Bazuar në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues vlerëson se mbështetur në nenin D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i rivlerësimit Bujar Musta *nuk arrin* nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe ka *cenuar besimin e publikut* te sistemi i drejtësisë. Në përfundim, trupi gjykues çmon se vendimi nr. 447, datë 17.09.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është i drejtë, i bazuar në fakte dhe në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 447, datë 17.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Bujar Musta.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 06.02.2025.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi